

Dhjetor 2019
Numri: 141
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

ISLAMI ËSHTË VETËM PAQE




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër
qëndrimi indiferent,
pandjenja dhe injorant përballë
mrekullive të pafundme
madhështore, që prej
grimcës më të vogël, e deri tek
trupi më i madh, prej botës
mikro, e deri në atë makro,
të cilat ndriçojnë më së miri
mendjen dhe zemrën,
përveçse një çoroditje
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar
pasurinë e tij dhe se ku e ka
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që
është drejtuar kah e mira dhe ka
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



Paqja, selami, mëshira, virtyti dhe humanizmi i vërtetë gjendej te i Dërguari i Allahut (a.s.), sepse ai pati ardhur për të përsosur virtytet etike para së gjithash. Ai pati ardhur i pajisur me një moral të lartë. Ai pati ardhur vetëm si “mëshirë” dhe jo me ndonjë cilësi tjetër për të gjitha fushat që përfshin fjala “botët”. “Të qenët besnik” ishte një cilësim të cilin ia pati dhënë shoqëria. Pejgamberi (a.s.), erdhi dhe ndërtoi një shoqëri të virtytshme nga një shoqëri barbare.

Allahu i ka caktuar Vetes mëshirën. Ai nuk i do të padrejtët dhe padrejtësinë. Këtë fe është Allahu (xh.xh.), Ai që e ka quajtur “Islam”. Allahu është edhe Ai që ia parashtroi njerëzimit si një “shembull i bukur” të “Dërguarin e mëshirës”.

Allahu është Ai që ia dha në dorë të Dërguarit të Tij (a.s.), Kurani Fisnik, i cili gjithmonë lexohet duke filluar me “Bismi’l-lahi’rr-Rahmani’rr-Rahim/me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotit” dhe që i kërkoi atij të ndërtonte një sistem të ri njerëzor.

Në shoqëritë myslimane çdo punë fillohet me “Bismi’l-lahi’rr-Rahmani’rr-Rahim”. Në këtë mënyrë, zemrat lidhen me Atë që është i Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë. Allahu është Ai që e ka cilësuar edhe “Kisasin” si “jetë”.

Atij që nuk e ndan dot xhihadin nga krimi nuk i thuhet “muxhahid” sipas bazave kryesore të Islamit. Shprehja: “Unë jam mysliman.”, është shprehja më e bukur në botë brenda kornizës që ka shpallur Allahu Teala. Të thuash “unë jam mysliman” do të thotë të shprehësh përkufizimin më të bukur, të shprehësh se ndjek atë që është më e bukur dhe të shprehësh se përpiqesh të arrish cilësitë më të larta. Për një fe që kujdeset edhe ndaj maceve të uritura, që nuk e pranon kurrë torturimin e kafshëve dhe që e konsideron vrasjen e njeriut me padrejtësi si vrasjen e të gjithë njerëzimit, nuk është e vështirë ta kuptosh se çfarë njeriu dhe shoqërie mund të ndërtojë. Por ja që kjo fe madhështore në ditët e sotme po përjeton sulme si “prishje të imazhit”.

Sot një njeri i zakonshëm i kësaj bote gjendet ballë për ballë me një pengesë të madh pothuajse si mal të cilën duhet ta kalojë, në mënyrë që të arrijë te feja e dëlirë islame, e cila i ka themelet në Kuranin Fisnik dhe është shëmbëllyer në jetën madhështore të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Kalimi i kësaj pengese sa një mal do të thotë të kalosh ISIS-in, të kalosh Boko Haramin, të kalosh Esh-shebabin... Të kalosh përbindëshat që therin në fyt njerëzit para kamerave... Të kalosh median e cila është fokusuar për ta përlyer Islamin me gjak...

Tirania universale kundrejt Islamit është një realitet. Atëherë, çfarë duhet të bëjmë në këtë situatë? Nga njëra anë duhet të përpiqemi fort për të shpëtuar nga kjo tirani dhe nga ana tjetër për t’i njohur njerëzit me Islamin, Kuranin dhe zërin e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Madje këtë duhet të bëjmë në këtë kohë kur myslimanët nuk kanë vullnet për të planifikuar asgjë, madje, në këtë kohë kur vullnetet e ndryshme të myslimanëve luftojnë kundër njëri-tjetrit.

Dhjetor 2019

VITI: XIII

NUMRI: 141

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardan Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t’i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja




12

Ujërllë, armiku s'fle
Idris Arpat



Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash

34



16

20

Sahabi nga Medina
Muadh ibni Enes Xhuheni (r.a.)
Mustafa Erish



5 Islami është vetëm Islam
Ahmet Tashgetiren

8 Kjo është çështje feje,
jo lojë dhe argëtim
Doç. dr. Adem Ergyl

10 Ata që e shfrytëzojnë fenë
për interesat e kësaj bote
Ali Riza Temel

16 Kibla fizike dhe shpirtërore
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

19 Smira, çelësi i së keqes
Sadik Dana

22 Kremtimet e Krishtlindjeve dhe Vitit të ri
Kemal Ball

24 Dy plagët e shoqërisë, alkooli dhe droga
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

27 Solidariteti mes besimtarëve
M. Sami Ramazanollu



46

Bazat e një shoqërie të shëndetshme 28

Doç. dr. Kerim Bulladë

Udhëtimi shpirtëror 30

Hasan Tahsin Karaman

Një Ajet - Një Hadith 32

El-Mukit 40

Ilir Hoxha

Çelësi i suksesit, vëllazëria Islame 42

Doç. dr. Mustafa Karabaxhak

Kurani, udhëzuesi hyjnor 46

Duran Ekizer

Sheuqet Muka dhe "Romani"
epistolar i jetës së tij 48

Gëzim Puka

Sjellja e myslimanit 50

Ferit Piku

Nuk ka dashuri pa dëlirësi 57

Aishe Gyndyz

44



Ndjenja e përgjegjësisë
Nuredin Jëlldëz

Mos u mendo kot,
zemrës nuk i vendos dot kufij
Fatma Hale Liman

54



ISLAMI ËSHTË VETËM ISLAM

— Ahmet Tashgetiren —

Paqja, selami, mëshira, virtyti dhe humanizmi i vërtetë gjendej te i Dërguari i Allahut (a.s.), sepse ai pati ardhur për të përsosur virtytet etike para së gjithash. Ai pati ardhur i pajisur me një moral të lartë. Ai pati ardhur vetëm si “mëshirë” dhe jo me ndonjë cilësi tjetër për të gjitha fushat që përfshin fjala “botët”. “Të qenët besnik” ishte një cilësim të cilin ia pati dhënë shoqëria. Pejgamberi (a.s.), erdhi dhe ndërtoi një shoqëri të virtytshme nga një shoqëri barbare.

Allahu i ka caktuar Vetes mëshirën. Ai nuk i do të padrejtët dhe padrejtësinë. Këtë fe është Allahu (xh.xh.), Ai që e ka quajtur “Islam”. Allahu është edhe Ai që ia parashtrroi njerëzimit si një “shembull i bukur” të “Dërguarin e mëshirës”.

Allahu është Ai që ia dha në dorë të Dërguarit të Tij (a.s.), Kurani Fisnik, i cili gjithmonë lexohet duke filluar me “Bismi’l-lahi’rr-Rrahmani’rr-Rrahim/me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotit” dhe që i kërkoi atij të ndërtonte një sistem të ri njerëzor.

Në shoqëritë myslimane çdo punë fillohet me “Bismi’l-lahi’rr-Rrahmani’rr-Rrahim”. Në këtë mënyrë, zemrat lidhen me Atë që është i Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë. Allahu është Ai që e ka cilësuar edhe “Kisasin” si “jetë”.

Atij që nuk e ndan dot xhihadin nga krimi nuk i thuhet “muhahid” sipas bazave kryesore të Islamit. Shprehja: “Unë jam mysliman.”, është shprehja më e bukur në botë brenda kornizës që ka shpallur Allahu Teala. Të thuash “unë jam mysliman” do të thotë të shprehësh përkufizimin më të bukur, të shprehësh se ndjek atë që është më e bukur dhe të shprehësh se përpiqesh të arrish cilësitë më të larta.

Mëkati është papastërti dhe ndyrje. Mëkati është barrë për zemrën. Ndërsa Islami kërkon njeri të pastër. Pra, kërkon një njeri që është i ndjeshëm për të mos mbartur papastërti mëkati në zemër. Pastërtia e zemrës është prej cilësive jetike të myslimanit. Nëse në zemrën e myslimanit fillon të ndjehet papastërtia e mëkatit, ai menjëherë fillon të pastrohet. Për këtë arsye, ekziston institucioni i pendimit. Ky institucion e shoqëron ritmin e zemrës

së myslimanit. Ndotja përgjatë jetës mund të jetë e paevitueshme, por ja që myslimani nuk dëshiron të dalë në audiencën e Allahut me atë zemër, sepse ai e di se zemra është vendi ku shikon Zoti (xh.xh.).

Për një fe që kujdeset edhe ndaj maceve të uritura, që nuk e pranon kurrë torturimin e kafshëve dhe që e konsideron vrasjen e njeriut me padrejtësi si vrasjen e të gjithë njerëzimit, nuk është e vështirë ta kuptosh se çfarë njeriu dhe shoqërie mund të ndërtojë. Por ja që kjo fe madhështore në ditët e sotme po përjeton sulme si “prishje të imazhit”.

Krimi më i madh është që t’i konsiderosh njëjtë Islamin dhe krimin. Nëse Islami konsiderohet i njëjtë me terrorin, do të thotë që të këputet litari që Allahu Teala e ka dërguar për njerëzimin. Ky është terrorizmi i vërtetë. Pra, ta shkëpusësh njeriun nga mesazhi i Krijuesit. Për fat të keq, bota është zvarritur drejt një atmosfere kriminale të tillë.

Sot një njeri i zakonshëm i kësaj bote gjendet ballë për ballë me një pengesë të madh pothuajse si mal të cilën duhet ta kalojë, në mënyrë që të arrijë te feja e dëlirë islame, e cila i ka themelet në Kuranin Fisnik dhe është shëmbëllyer në jetën madhështore të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Kalimi i kësaj pengese sa një mal do të thotë të kalosh ISIS-in, të kalosh Boko Haramin, të kalosh Esh-shebabin... Të kalosh përbindëshat që therin në fyt njerëzit para kamerave... Të kalosh median e cila është fokusuar për ta përlyer Islamin me gjak...

Tirania universale kundrejt Islamit është një realitet. Atëherë, çfarë duhet të bëjmë në këtë situatë? Nga njëra anë duhet të përpiqemi fort për të shpëtuar nga kjo tirani dhe nga ana tjetër për t’i njohur njerëzit me Islamin, Kuranin dhe zërin e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Madje këtë duhet të bëjmë në këtë kohë kur myslimanët nuk kanë vullnet për të planifikuar asgjë, madje, në këtë kohë kur vullnetet e ndryshme të myslimanëve luftojnë kundër njëri-tjetrit.

Nga duhet t’ia fillojmë vallë kësaj pune? Mos vallë duhet ta fillojmë nga humbja e vetes që pati përjetuar për shkak të emocionit të madh të xhihadit personi që e vrau në luftë atë që tha “la ilahe illall-llah” duke menduar se e tha prej frikës, apo duhet t’ia fillojmë nga paralajmërimi i të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, i cili e tronditi këtë sahab duke i thënë: “Mos vallë ia hape zemrën dhe ia pe?”

Mos vallë duhet të fillojmë nga zëri i zemrës që dridhej i të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili pasi mori “detyrën e profecisë” në shpellën Hira shkoi



në shtëpi dhe i tha bashkëshortes së tij që e priti te dera: “Kush do të më besojë mua tani?”

Islami ishte një thirrje kur iu paraqit njeriut për herë të parë nëpërmjet të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ai vazhdoi të ishte një “thirrje” edhe pasi fitoi fuqinë e shtetit në Medinë. Po, një thirrje. Mbi të gjitha, një thirrje gjallëruese dhe jo një thirrje vdekjeprurëse. Pra ishte pikërisht ajo që thotë shkrimtari: “Ai që vjen për të të vlarë, le të gjejë jetë te ti.” Allahu Teala na bën thirrje në Kuranin Fisnik: **“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë!..”** (Enfal, 24.)

Gjëja në të cilën ftonte Allahu dhe i Dërguari i Tij, pra Islami i ngjallte zemrat te të cilat arrinte. Kjo thirrje ishte për t’i ngjallur zemrat dhe për ta shpëtuar njerëzimin nga zemrat e vdekura. Pikërisht për këtë është edhe ibadeti, predikimi, politika dhe xhihadi i Islamit. Pra, Islami nuk është shkatërrues, por gjallërues.

Atëherë, klasifikimi i Islamit si “radikal”, “politik”, “fundamentalist”, apo “i moderuar”, nuk është prej Islamit. Këto klasifikime janë krejtësisht përkufizime të bëra nga jashtë Islamit. Të gjitha këto përkufizime mbartin qëllimin për t’u pozicionuar kundër Islamit. Këto janë përkufizimet e atyre që e shohin Islamin si “problem” dhe që synojnë ta mbajnë nën rrethim çdo gjendje të kësaj feje.



Gjëja në të cilën ftonte Allahu dhe i Dërguari i Tij, pra Islami i ngjallte zemrat te të cilat arrinte. Kjo thirrje ishte për t'i ngjallur zemrat dhe për ta shpëtuar njerëzimin nga zemrat e vdekura. Pikërisht për këtë është edhe ibadeti, predikimi, politika dhe xhihadi i Islamit. Pra, Islami nuk është shkatërrues, por gjallërues.

Përkufizimi “Islam i moderuar” qoftë nga ana e atyre që deklarojnë se e përvetësojnë Islamin apo qoftë nga ana e atyre që marrin pozicion kundër Islamit nga jashtë, mbart cilësinë “formula e Islamit që e ul problemin në masën maksimale”. Domethënë, ata që shprehen: “Ne jemi me Islamin e moderuar.”, atyre që duan ta mbajnë Islamin nën rrethim u japin mesazhin: “Ne nuk jemi problem për ju.”

Libri i Shenjtë i Islamit gjendet në duart e të gjithëve. Edhe rruga në të cilën ka ecur i Dërguari i Allahut (a.s.), njihet nga të gjithë. Islami ka një mesazh universal. Ai dëshiron të arrijë te të gjithë njerëzit.

Qëllimi që Islami dëshiron të arrijë te të gjithë njerëzit është i lidhur me misionin e ekzistencës së njeriut. Edhe fetë që kanë pasur si burim shpalljen hyjnore si krishterimi dhe judaizmi, po të mbeteshin në natyrën e tyre të vërtetë do të kishin lidhje me misionin e ekzistencës së njeriut. Edhe në ditët e sotme bëhet fjalë që të kenë lidhje me këtë mision vetëm se pohojnë se janë fe.

Përderisa të ekzistojë njeriu, edhe Islami do të vazhdojë të arrijë te njerëzit. Që kur ka ardhur shpallja e parë, pra thirrja e Kuranit dhe shëmbëlltyra e të Dërguarit të Allahut (a.s.), dhe që kur Hazreti Muhamedi është vënë para njerëzimit si Prijës dhe shembull, ka pasur probleme për njerë-

zit në forma të ndryshme për ta futur Islamin në jetën e tyre. Nëse do ta shohim Kuranin Fisnik dhe përpjekjen e të Dërguarit të Allahut (a.s.), për të ndërtuar shoqërinë e parë islame, do të na dalin përpara paralajmërimet kundrejt prirjeve të gabuara të njerëzve dhe shoqërive. Domethënë, Islami jep format e vërteta të modelit të njeriut që dëshiron të ndërtojë.

Meqë situata është e tillë, atëherë ne si myslimanë qoftë një nga një si individë apo qoftë të gjithë së bashku si shoqëri, duhet t'i hedhim një shikim vetes sonë dhe ta shohim e ta rregullojmë nëse kemi ndonjë gjë ndryshe nga Kurani Fisnik dhe i Dërguari i Allahut (a.s.). Sidoqoftë, ne jemi të detyruar të dalim në udhëtimin e përhershëm duke shkruar librin e jetës prej së cilës është i kënaqur Allahu (xh.xh.).

Ne nuk e kemi për detyrë që ta bëjmë Islamin të pëlqyeshëm ndaj ndonjë fuqie të madhe botërore. Por nëse e shfaqim si Islam ndonjë model jete prej të cilit nuk është i kënaqur Allahu dhe i bëhemi pengesë thirrjes islame, kjo gjë absolutisht ka një mëkat të madh. Ne kemi përgjegjësinë për ta bërë këtë disiplinë të jetës: Krenarisë islame nuk duhet t'i thuhet asnjë fjalë e keqe për shkak të gabimeve tona. Domethënë, ne nuk duhet të bëjmë gabime të tilla, në mënyrë që njerëzit të mos flasin keq për Islamin.

Kjo është çështje feje, jo lojë dhe argëtim!

— Doç. dr. Adem Ergyl —

Feja prej të cilës është i kënaqur Allahu (xh.xh.), është Islami që do të thotë nënshtrim i plotë ndaj asaj që vjen prej Zotit. Atij që kërkon ndonjë fe tjetër përveç Islamit, domethënë, atij që ndjek jo atë që vjen prej Zotit por atë që i thotë mendja apo më saktë, atë që i thotë nefs, ky fetarizëm nuk do t'i pranohet asnjëherë te Allahu i Lartësuar.

Përgjatë gjithë historisë kanë dalë shumë njerëz mashtrues dhe interesaxhinj që shpesh herë kanë bërë operacione/sulme të tilla ndaj feve të vërteta. Pastaj me fetë që formonin vetë bëheshin robër të nefseve të tyre duke thënë: “Kjo është feja e vërtetë.” Degradimet e tyre nuk mbeteshin të kufizuar vetëm me ata. Kështu që ata i ftonin edhe të tjerët në një nënshtrim të tillë. Në Kuranin Fisnik thuhet:

“Mjerë ata që me duart e tyre shkruajnë Librin, e pastaj thonë: “Kjo është prej Allahut” që për këtë të kenë ndonjë dobi të vogël (materiale). Mjerë ata për çfarë kanë shkruar me duart e tyre dhe mjerë ata për çfarë kanë fituar!” (Bakara, 79)

Shpesh herë nisetet e atyre që ua paraqesin autoriteteve administrative, politike dhe financiare fenë e Allahut jo ashtu siç është, por duke e modernizuar me komentime të reja gjoja për ta shfaqur më të butë, siç është thënë edhe në ajetin fisnik, janë për të arritur interesat e përkohshëm të kësaj bote si mundësitë financiare, pozita, etj.

Njëra prej metodave themelore që e përdorin kur e bëjnë këtë punë është keqinterpretimi me vetëdije i ajeteve të Allahut Teala. Njerëzit e tillë që në aparençë hiqen si dijetarë bëjnë lojëra mbi kuptimet e fjalëve si e si për të nxjerrë nga ajetet kuptimet që u leverdisin dëshirave vetjake të tyre. Si rezultat, devijojnë vetë dhe shumë njerëz të tjerë nga feja dhe e vërteta. Zoti (xh.sh.), i deshifron në këtë mënyrë ata që i devijojnë njerëzit:

“Vërtet shpresoni ju (besimtarë) se ata (hebrenjtë) do t’ju besonin ju, ndërkohë që disa prej tyre i dëgjonin fjalët e Allahut dhe, pasi i kuptonin, me vetëdije i shtrembëronin ato!?” (Bakara, 75)

Feja e Allahut Teala nuk është mjet i askujt për lojë dhe argëtim. Tekstet e Kuranit Fisnik dhe të Sunetit nuk janë tekste të zakonshme rreth të cilave të gjithë mund të japin mendimet e tyre. Por për fat të keq, shumë njerëz po gjykojnë lehtësisht në fushën e fesë me një trimëri prej injoranti dhe në një mënyrë vulgare pa marrë parasysh metodat, rregullat dhe bazat, pa poseduar bazën që e kërkon dija dhe pa pasur moralin e virtytin e nevojshëm. Përveç të tjerash, këta njerëz po sulmojnë pa aspak turp akumulimin e dijes që ka umeti. Ndërkohë, të mos harrojmë se të flasësh në emër të fesë së Allahut është sikur të flasësh në emër të Allahut. Kjo fushë nga një aspekt

i ngjason ecjes në një vend të minuar. Umeti ka kërkuar një pjekuri të madhe te ata persona që do të flasin në lidhje me këtë fushë dhe këtë pjekuri të tillë e ka quajtur “pozita i ixhtihadit”. Allahu (xh.xh.), i paralajmëron siç vijon ata që flasin pa u menduar në këtë çështje:

“Prandaj, mos thoni me gjuhët tua të rreme: “Kjo është e lejueshme e kjo e ndaluar”, që kështu të trilloni gënjeshtër për Allahun. Me siguri, ata që trillojnë gënjeshtër ndaj Allahut, nuk do të shpëtojnë.” (Nahl, 116)

Ata të cilën e nënvlerësojnë këtë sistem hyjnor që Allahu Teala ia ka dërguar njerëzimit si një e vërtetë e madhe dhe që e shndërrojnë këtë mirësi sublime në një lojë për t’u argëtuar e dëfryer, janë kundërshtuar ashpër dhe janë njoftuar se i pret një fatkeqësi e madhe:

“Largohuni nga ata që fenë e tyre e marrin si lojë dhe dëfrim e që janë mashtruar nga jeta e kësaj bote. Këshilloji ata me Kuranin, me qëllim që të mos i humbasin shpirtat e tyre për shkak të veprave të veta. Përveç Allahut, ata nuk do të kenë as ndihmës, as ndërmjetës. Edhe sikur të ofrojnë çdo lloj shpagimi, nuk do t’u pranohet. Këta janë ata që do të lihen në humbje për shkak të veprave që kanë bërë. Ata do të pinë ujë të valuar dhe do të kenë dënim të dhimbshëm për shkak të mosbesimit të tyre.” (En’am, 70)

Sa mendjelehtësi e madhe është të shndërruarit e fesë së Allahut në lojë dhe argëtim. Sa fatkeqësi e dhimbshme është të perceptuarit e saj sikur të ishte një informacion i zakonshëm apo një përrallë. Ndërkohë, a nuk duhet që t’i kërkojmë mbrojtje Allahut (xh.sh.), nga çdo lloj pëshpëritjeje dhe devijimi të shejtanit e nefsit dhe ta pranojmë fenë e Zotit me një respekt e nderim të madh e me një zemër të dëlirë, në mënyrë që të bëjmë një jetë të pastër dhe të lartësohemi në horizontet e përhershme?

Për shkak se dijetarët e devotshëm, të sinqertë dhe të përkushtuar të këtij umeti e kanë konceptuar shumë mirë domosdoshmërinë e kësaj përpikërie ndaj fesë, kanë dhënë gjykime që arrijnë deri në kufër për ata që i nënvlerësojnë, i tallin dhe i bëjnë objekt dëfrimi shenjat e fesë si “Kuranin”, “Pejgamberin”, “Qabenë”, “ezanin”, “namazin”, etj. dhe janë shprehur se për njerëzit e tillë duhen zbatuar ndëshkime juridike. Këta dijetarë asnjëherë nuk i kanë toleruar veprimet e pabaza në lidhje me këtë çështje. Nisur nga këto që thamë, dëshirojmë t’ju kujtojmë se është shumë e rrezikshme që t’i bëjmë objekt gazmoresh çështjet fetare me qëllim që të qeshin njerëzit. Heshtja ndaj këtyre maskarallëqeve apo dëgjimi i tyre në mënyrë pasive, do të thotë që

të ndajmë të njëjtin fund të dhimbshëm me ata që veprojnë kështu.

Edhe një shenjë tjetër e mosnënshtrimit me gjithë zemër ndaj fesë së Allahut në ditët e sotme është kjo: “Shumë njerëz i konsiderojnë si të pazbatueshme në kohët e sotme dispozitat e qarta dhe të caktuara nga tekstet hyjnore të fesë. Andaj këta njerëz i shohim këto dispozita si historike apo specifike për ndonjë vend të veçantë.” Një këndvështrim i tillë nuk është gjë tjetër përveçse mendim i ndyrë i mentaliteteve që u janë nënshtruar kushteve aktuale. Njerëzve të tillë dëshirojmë t’u kujtojmë këtë të vërtetë të madhe:

Në periudhën kur Kurani Fisnik i është zbritur të Dërguarit të Allahut, (a.s.), kishin kaluar afërsisht dy mijë vjet nga Teurati që i është zbritur Musait. Allahu i Lartësuar u shpreh si më poshtë për hebrenjtë e periudhës së Pejgamberit që nuk gjykonin me disa dispozita të Teuratit dhe sidomos me dispozitat që urdhëronin ndëshkimin e njëjtë me krimin:

“Ne kemi dërguar Teuratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita. Sipas tij, profetët që ia kishin dorëzuar veten Allahut, i gjykonin hebrenjtë; por edhe të diturit dhe rabinët kështu vepronin, sepse atyre iu qe besuar mbrojtja e Librit të Allahut, për të cilin ata dëshmonin. Prandaj, mos kini frikë nga njerëzit, por kini frikë vetëm prej Meje! Dhe mos i ndërroni Fjalët e Mia me ndonjë vlerë të vogël! Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur Allahu, ai është mohues i vërtetë. Ne u caktuam atyre në Teurat: jeta me jetë, syri me sy, hunda me hundë, veshi me vesh, dhëmbi me dhëmb dhe plaga me plagë (të njëjtë me të). Por kushdo që fal shpagimin si lëmoshë, ka bërë një vepër që është shlyerje për gjynahet e veta. Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka zbritur Allahu, ai është shkelës i vërtetë.” (Maide, 44-45)

Emri mysliman është një emër që e mbart një njeri që i dorëzohet Allahut dhe asaj që vjen nga Ai. Si mund të mbetet mysliman me një gjendje të tillë një person që përpiket të gjejë pretekste në emër për t’u larguar nga Zoti në vend që të kërkojë rrugët, mënyrat dhe mundësitë për t’ju dorëzuar fesë sublime, Islamit prej të cilit është i kënaqur Allahu (xh.xh.)? Andaj, ajo që na takon të bëjmë nuk është që ta derdhim Islamin në kallëpin e mashtruesve modernë të kohës duke e krasitur dhe gdhendur atë, por për ta bërë sërish sundues Islamit sipas kallëpit universal të tij në të gjithë tokën duke filluar nga vetja jonë.

Feja nuk është mall që tregtohet. Në shërbim ndaj fesë nuk mund të bëhet fjalë për pazarllëqe. Në suren Jasin thuhet: **“Ndiqni ata, që nuk kërkojnë prej jush kurrfarë shpërblimi e që janë në rrugë të drejtë!”** (Jasin, 21)

ATA QË E SHFRYTËZOJNË FENË PËR INTERESAT E KËSAJ BOTE

— Ali Riza Temel —

Esenca e gjithë çështjes është që të përdoren kjo botë dhe mundësitë e saj për t'u fituar bota e përtejme e cila është e përhershme. Për fat të keq, shumë njerëz preferojnë të paktën e përkohshme në vend të së shumtës së përhershme. Në Kuranin Fisnik thuhet: **“Vërtet që jobesimtarët e duan jetën e këtushme dhe nuk e përfillin një Ditë të vështirë, që do t'u vijë.”** (Insan, 27)

Ata që e përdorin fenë për interesat e kësaj bote në përgjithësi janë mistikët e rremë dhe klerikët interesaxhinj. Allahu i Lartësuar e shpreh kështu këtë çështje: **“O ju që keni besuar! Në të vërtetë, shumë priftërinj dhe murgj përllajnë pasurinë e njerëzve pa të drejtë dhe i largojnë ata nga rruga e Allahut...”** (Teube, 34)

Pejgamberët të cilët janë predikuesit e feve të vërteta, dhe trashëgimtarët e tyre të vërtetë, nuk e kanë bërë predikimin e fesë për ndonjë interes të kësaj bote. Mbi të gjitha, ata kanë sakrifikuar çdo gjë materiale dhe shpirtërore në këtë rrugë. Madje kanë sakrifikuar edhe jetën e tyre. Kur Pejgamberit të fundit, Muhamedit (a.s.), i propozuan pasuri, gra dhe pozitë, në mënyrë që të hiqte dorë nga kauza e tij, ai u përgjigj: “Edhe nëse ma vendosin diellin në dorën e djathtë dhe hënën në dorën e majtë, prapë se prapë nuk heq dorë nga kjo kauzë.” Në këtë mënyrë, e vazhdoi predikimin e fesë edhe pse gjendej në kushtet më të vështira.

Hudi (a.s.) që iu dërgua popullit të Adit, Salihu (a.s.) që iu dërgua popullit të Themudit, Luti (a.s.) që iu dërgua popullit të Lutit dhe Shuajbi (a.s.) që iu dërgua Medjenit, përgjatë predikimit gjithmonë u thanë këtë popujve të tyre: **“Për këtë, nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërblimi, mua do të më shpërblejë vetëm Zoti i botëve.”** (Shuara, 127, 145, 164, 180.)

Vlera më e shenjtë në jetë është feja. Ata që e shfrytëzojnë vlerën më të shenjtë për interesat e tyre, janë njerëzit më të pavlefshëm. Edhe pse në ajetin fisnik flitet për priftërinjtë dhe murgjit, këtu përfshin edhe pseudodijetarët myslimanë. Muhamed Ikbali thotë për këta lloj njerëzish: “Myftiu i fesë është bërë shitës i fetvave. Brenda çdo xhybeje gjendet i fshehur një tregtar.” Kur e themi këtë, nuk dëshirojmë t'i përgjithësojmë krejt klerikët. Në fakt, edhe në ajetin fisnik thuhet: **“...Shumë priftërinj dhe murgj...”** Në këtë mënyrë, tregohet qartë se ka edhe klerikë që nuk janë të përfshirë në këto gjëra.

Kur mufesiri dhe shkrimtari i njohur Reshit Rizai e komenton këtë ajet, i ka përmbledhur në këtë mënyrë metodat për ngrënien

e pasurisë së njerëzve me padrejtësi:

1- Shumë njerëz u japin para atyre personave që u besojnë se janë asketë dhe mistikë, në mënyrë që këta të ndërmjetësojnë te Allahut ashtu që t'u plotësohen nevojat dhe t'u shërohen të sëmurët... Nëse dikush bën ndonjë lutje pa marrë diçka materiale dhe personi që e merr këtë shpreson për realizimin e saj, kjo është diçka e bukur. Por të besosh se Allahu Teala u ka dhënë disa njerëzve autoritet të veçantë dhe të shpresosh se ata bëjnë dobi dhe dëm në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk është gjë tjetër përveçse injorancë.

2- Paratë, lëmoshat, etj. që u jepen atyre që i kanë shndërruar në burim të ardhurash varret dhe tyrbet e bëra në emër të pejgamberëve dhe njerëzve të devotshëm.

3- Paratë që marrin priftërinjtë e krishterë dhe sidomos ata katolikë e ortodoksë në emër për të falur gjynahet. Një burrë apo një grua shkon te prifti që ka marrë autoritetin nga kryepriifti për faljen e mëkateve. Njerëzit i tregojnë mëkatet e tyre. Edhe prifti apo murgu i fal ata në këmbim të një pagese të caktuar. Sipas kishës, atë që e fal prifti, e fal edhe Zoti. Në kohën e mesjetës pagesat për faljen e mëkateve ndryshonin sipas klientëve. Pagesat e mbretërve, princave, të zgjedhurve, të pasurve dhe të shtresës së ulët ndryshonin nga njëra-tjetra. Priftërinjtë u jepnin rrëfyesve dokumentet e faljes. Edhe ata i mbanin këto dokumente dhe i vendosnin në arkivolet e tyre. Protestantizmi nga një aspekt është kryengritje kundër këtij lloji shfrytëzimi.

4- Paratë që merren në këmbim të fetvave që jepen për ta bërë haramin hallall dhe hallallin haram. Disa klerikë të fesë i manipulojnë tekstet fetare me komentime që u leverdisin, në mënyrë që t'u japin legjitimitet disa veprave të padrejta që i bëjnë të fuqishmit dhe pushtetarët. Në këtë mënyrë, bëhen bashkëpunues të të padrejtëve në padrejtësitë e tyre për interesat e kësaj bote. Allahu Teala thotë: **"Mos anoni nga ata që bëjnë të këqija, përndryshe do t'ju përcëllojë Zjarri..."** (Hud, 113)

5- Marrja e ryshfetit duke përdorur fenë. Në këtë çështje disa klerikë po ndjekin gjurmët e priftërinjve dhe murgjve për të cilët bëhet fjalë në ajet.

6- Lejimi i çdo lloji të kamatës duke e manipuluar fenë. Kjo është një çështje e përhapur ndërmjet dijetarëve të krishterë dhe çifutë. Ata i kanë lejuar disa lloje të kamatës dhe i kanë ndaluar disa lloje të tjera me anë të fetvave të pabaza. Për shembull, çifutët e kanë të lejuar kamatën përveçse me vëllëzërit e tyre. Ndërkohë që kamata është e ndaluar kategorikisht edhe për ata. Edhe priftërinjtë i kanë konsideruar të lejuara disa lloje të kamatës. Ata kanë

vepruar pikërisht si rabinët e çifutëve. Ka shumë fondacione që kanë formuar priftërinjtë. Shumica e të ardhurave të këtyre janë prej kamatës. Njëri prej këtyre fondacioneve ka formuar një bankë në Francë. Pastaj paratë u zhdukën duke shpallur falimentimin e bankës. Gjithashtu dihet nga të gjithë se priftërinjtë në kohën e mesjetës kanë pas shitur tokën e xhenetit në këmbim të parave. Për këtë arsye, mund të themi se nuk ka shumë ndryshim ndërmjet atyre që i falin mëkatet dhe shesin tokën e xhenetit, atyre që shesin qefinë që nuk digjen nga zjarri dhe atyre që thonë se do të hyjnë direkt në xhenet ata që i përkasin filan dege të filan tarikati.

Mufesiri i madh, Fahredin Razi thotë kur komenton ajetin që e kemi dhënë në krye: "Ata që e shohin me kujdes gjendjen e mashtrulesve të kësaj kohe, do të vënë re se ky ajet pothuajse ka zbritur për këta lloji njerëzish. Në të vërtetë, mashtrulesit e tillë që thonë se nuk janë të pasionuar pas kësaj bote, se nuk interesohen me pasurinë e njerëzve dhe se bëjnë një jetë të dëlirë sikur të ishin engjëj, pothuajse dërmohen për interesat e tyre kur bëhet fjalë për diçka të tillë. Ata i pranojnë edhe poshtërsitë më të mëdha vetëm e vetëm që të mos humbasin interesat e veta.

Xhordano Bruno (v. 1600), i cili u dënua me vdekje duke u djegur nga Inkuizicioni për shkak se u doli kundër dogmave të kishës, thotë: "Zoti përdor njerëzit e mirë për ta bërë sundues vullnetin e Tij. Ndërsa njerëzit e këqij shfrytëzojnë moralin për të bërë sundues vullnetin e tyre."

Të gjithë prijësit fetarë, pa marrë parasysh se cilës fe i përkasin, së pari duhet t'i zbatojnë vetë rregullat e fesë që e predikojnë. Në ajetin fisnik thuhet: **"Vallë, a i urdhëroni njerëzit që të bëjnë të mira e veten po e harroni, ju që lexoni Shkrimet?! A nuk arsyetoni?"** (Bakara, 44)

Feja nuk është mall që tregtohet. Në shërbim ndaj fesë nuk mund të bëhet fjalë për pazarllëqe. Në suren Jasin thuhet: **"Ndiqni ata, që nuk kërkojnë prej jush kurrfarë shpërblimi e që janë në rrugë të drejtë!"** (Jasin, 21)

Fetarizmi kërkon që njeriu të ecë në rrugë të drejtë. Esenca e Islamit është besim i drejtë dhe vepër e mirë. Ata që fitojnë në mënyrë të padrejtë, janë mbartës të druve të xhehenemit. Fitimi më i shëmtuar është ai që arrihet duke shfrytëzuar fenë dhe ndjeshmëritë fetare. Siç është shprehur edhe në ajetin fisnik që gjendet në fillim, ata që e ulin veten deri në këtë masë përgjithësisht janë pseudoklerikët që hiqen si asketë dhe të devotshëm. Andaj, fenë duhet ta mësojmë nga burime të sakta dhe nga dijetarë të ndershëm e të drejtë, në mënyrë që të mos biem në kurrthet e mashtrulesve të tillë.

UJI FLE, ARMIKU S'FLE

— Idris Arpat —

Njerëzit, veçanërisht myslimanët jetojnë me besimin, vullnetin, ndërgjegjen dhe idealet e tyre. Shpallja hyjnore të cilës i besojmë na jep rregullat dhe parimet që duhet t'i zbatojmë përgjatë gjithë jetës sonë. Ajo dëshiron të na japë “një disiplinë jetese të kontrolluar dhe me rregull”. Ndërsa vullneti dhe ndërgjegjja na mundëson të bëhemi të vendosur dhe të qëndrueshëm për të jetuar sipas atyre rregullave e parimeve. Idealet gjithmonë na tregojnë qëllimet më të larta dhe na urdhërojnë të synojmë gjërat që janë sublime.

Kështu formohet jeta e një myslimani serioz. Tani le ta shtjellojmë këtë çështje me detaje. Bazat që përmban besimi ynë i cakton Kurani Fisnik. Suneti i të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe hadithet fisnike janë zbatimi dhe të shprehurit e asaj që Pejgamberi ynë i nderuar ka kuptuar nga Kurani. Ja, këto janë rregullat dhe parimet e vetme që duhet t'i ndjekë me gjithë zemër një mysliman.

Aq sa Allahu Teala është më i lartë se njerëzit, edhe rregullat që ka dërguar janë më të larta se rregullat e njerëzve. Për këtë nuk kemi aspak dyshim. Rregullat e atij që ka dije, fuqi dhe mundësi të pafundme natyrisht se janë rregulla më të larta, më të qëlluara dhe më të përshtatshme për natyrshmërinë e njeriut. Meqë e vërteta është kjo, atëherë si mund të shpjegohet gjendja e mjerueshme në të cilën gjenden besimtarët dhe umeti i Muhamedit (a.s.)? Pa shikoni! Edhe armiq të po qajnë për gjendjen tonë të mjerueshme. (Nëse ju kujtohet, Kryeministria angleze Margaret Thatcher ka thënë në lidhje me torturat që u janë bërë grave boshnjake: “Kjo është një njollë e zezë në fytyrën e Evropës.”

Pa e zgjatur fjalën, le ta shprehim se stilin e jetës së myslimanit e cakton Kurani Fisnik. Myslmani as nuk mund t'i heqë, as nuk mund t'i shtojë gjë. Të kuptuarit e drejtë të Kuranit dhe Sunetit në këtë pikë, na del përballë si një çështje shumë e rëndësishme. Umeti i Muhamedit në këtë çështje është i detyruar që të japë maksimumin e vet. Myslmanët

janë të detyruar për t'u informuar se çfarë flitet dhe debatohet në universitetet kryesore të botës dhe në institucionet e mendimit e të shkencës. Si thotë populli: “Njeriu i mençur përdor mendjen e tij. Ndërsa njeriun më i mençur përdor edhe mendjen e të tjerëve.” Një mentalitet i pa informuar në lidhje me botën dhe një kulturë e mbyllur nuk mund t'u japin asgjë myslimanëve. Myslmani mendon: **“Për ta bërë të Vërtetën (Islamit) ngadhënjese dhe për ta zhdukur të pavërtetën edhe pse keqbërësit e pafe e urrejnë këtë.”** (Enfal, 8)

Në këtë pikë do të hyjnë në funksion trinjakët e shpirtit të cilët janë mendja, vullneti dhe ndërgjegjja. Mendja është një dhuratë hyjnore prej të cilës nuk mund të heqim dorë, nuk mund t'ia lëmë në dorë dikujt tjetër dhe nuk mund ta anulojmë funksionin e saj, sepse atë e përdorim për të



kuptuar shpalljen hyjnore dhe për të parë kush-tet e botës së sotme. Domethënë se “mendja, syri dhe shpallja hyjnore janë dritë”. Ai që i mbyll sytë, mbetet në errësirë. Myslimani nuk mund të heqë dorë as nga sytë, as nga drita. Nëse jemi të detyruar të jetojmë në këto kushte të vështira dhe brenda armiqve të djallëzuar në këtë mënyrë, atëherë do të thotë se jemi të detyruar t'i hapim katërsh edhe sytë, edhe zemrën. Ata që ecin duke fjetur, që jetojnë me ndihmën e të tjerëve dhe që nuk dinë asgjë se çfarë ndodh në këtë botë, nuk mund t'i mbrojnë shtëpitë dhe nuk mund t'i ushqejnë fëmijët e tyre. Më e keqja është se ata e humbasin personalitetin dhe shndërrohen në fuqi prej skllavi. Një njëri që punon vetëm për të tjerët, nuk ka ndonjë vlerë tjetër përveçse të punojë dhe të kënaqë veten. Vlerat e tij (moralit) tashmë i kanë vdekur.

Çfarë duhet të bëjmë pasi ta kuptojmë saktë shpalljen hyjnore? Pas kësaj faze duhet të përpiqemi seriozisht për t'i zbatuar në jetë ato që i kemi kuptuar. Vullneti është aftësia për të zgjedhur të drejtën dhe vendosmëria që na mundëson të përparojmë në rrugën e drejtësisë. “Njeri me vullnet të fortë” do të thotë njeri i vendosur dhe i qëndrueshëm për ta realizuar qëllimin e tij.

Këtu hyn në funksion ndërgjegjja. Nëse jetojmë me drejtësi, ajo na vlerëson. Nëse nuk jetojmë me drejtësi, na thotë që jemi në gabim. Kjo vazhdon kështu përgjatë gjithë jetës. Ndërgjegjja nga një aspekt është gjykatësi i gjykatës në botën tonë të brendshme. Ky gjykatës është i pam manipulueshëm. Ndërgjegjja shprehet edhe në këtë mënyrë: “Ajo është zëri i Allahut që jehon brenda nesh.”

Nëse njeriu e dëgjon zërin e ndërgjegjes, ky zë e bën atë me personalitet dhe mysliman në kuptim të vërtetë. Por nëse njeriu nuk e dëgjon zërin e ndërgjegjes, atëherë ai shndërrohet në vampir. Nëse njerëzit nuk e dëgjojnë zërin e ndërgjegjes, atëherë ky veprim është faktori numër një i shkatërrimit shoqëror. Si thonë zezakët amerikanë: “Nëse nuk ka drejtësi, nuk ka as paqe.”

Bazuar në këto që thamë, nëse bëhemi njerëz me këto rregulla dhe me këtë përjasje, atëherë, moszbatimi i këtyre dhe prishja e vullnetit na bëjnë njerëz të pashpirt.

Nëse besimi është dobësuar, apo nëse nuk njihen rregullat të cilave u besojmë, nëse nuk kemi siguri ndaj Allahut që i besojmë, nëse themi se ka ahiret

por jetojmë sikur nuk ka, do të thotë se kemi hyrë në fillim e fazës së shkatërrimit. Kur njerëzit të bien në këtë gjendje, atëherë nuk mund të parandalohen dot rëniet në depresion, mbetjet në vetmi, dëshpërimet dhe krimet.

Mendja është një mekanizëm që i mban nën kontroll ndjenjat dhe një aftësi që e ndan të vërtetën nga e gabuara. Kur mendja të mos përdoret, përjetohen ngjarje të dhimbshme që nuk mund të rregullohen më.

Çfarë do të thotë të lidhesh pa asnjë kusht ndaj një të përkohshmi? A ka kuptim që të marrim për zot gjëra të tjera përveç Allahut? Përse e ka krijuar Allahu Teala mendjen nëse ajo nuk do të përdoret? Mos vallë ka thënë kështu: “Unë po e krijoj, por ti vepro si të dëshirosh me të.”

Andaj, le t'i shohim nga ky këndvështrim njerëzit

që i kemi përreth dhe larg. Nëse e bëjmë këtë, menjëherë do ta kuptojmë se përse zvarritet dhe poshtërohet një masë e gjerë njerëzish që përbëhet nga 1 miliard e 700 milion myslimanë.

Nëse myslimanët nuk e dinë se një kundërshtim i mbështetur në mendje, shkencë dhe ndërgjegje është ibadet, atëherë shndërrimi i njerëzve në idhuj është i pashmangshëm. Ata që nuk dëgjojnë zërin e ndërgjegjes, dëgjojnë zërin e shejtanit dhe të interesave. Ata që nuk kanë vullnet, kurrë nuk do të bëhen njerëz të aftë për detyrë. Këta janë njerëz barrë për shoqërinë. Të mos harrojmë se i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Mos iu bëni barrë njerëzve!”

Ku po shkon o Umeti i Muhamedit me këta njerëz që nuk e dinë se çfarë po ndodh, që janë të privuar nga vetëdija për kohën dhe që nuk i kanë të zhvilluara ndjenjat e përgjegjësisë?

Unë mendoj se mbi ne po zbatohen projekte afatgjata. Këto janë projekte shkatërruese që po ua shkulin edhe rrënjët myslimanëve. Andaj, ngjarjet që po ndodhin duhet t'i shohim me mendjemprehësinë e besimtarit.

Menjëherë duhet të fillojmë dhe të mobilizohemi. Duhet të mobilizohemi, në mënyrë që njerëzve tanë t'u japim dije të saktë, ndjenjën për mbajtjen e përgjegjësisë dhe vlera. Në këtë mobilizim duhet të marrë pjesë çdo individ i umetit të Muhamedit. Unë mendoj se kjo çështje nuk pret që ta lëmë për më vonë.

Ku po shkon o Umeti i Muhamedit me këta njerëz që nuk e dinë se çfarë po ndodh, që janë të privuar nga vetëdija për kohën dhe që nuk i kanë të zhvilluara ndjenjat e përgjegjësisë?





Vepra më e mirë në këtë botë

— Xhafer Durmush —

Në suren Fussilet thuhet: ***“Kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: “Unë, me të vërtetë jam mysliman.” Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë. Ky virtyt u dhurohet vetëm atyre që durojnë dhe vetëm atyre që kanë një fat të madh. Nëse djalli fillon të të joshë, kërko mbështetje te Allahu. Me të vërtetë, Ai i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha.”***¹

Siç thuhet në tefsir, personi për cilësitë e të cilat flitet në këtë ajet fisnik është vetë i Dërguari i Allahut (a.s.). Disa kanë thënë se ky ajet ka zbritur në lidhje me myezinët. Po, këto ajete kanë zbritur përgjatë atyre ditëve kur ishte shumë vështirë për ta shpallur myslimanizmin. Ata që i thirrën njerëzit te Allahu, gjithmonë janë përballur me vështirësi. Nisur nga këto që thamë, ajetet që po përpiqemi t'i shpjegojmë i përfshijnë të gjithë ata që i ftojnë njerëzit te feja e Allahut, bëjnë vepra të mira dhe e deklarojnë myslimanizmin në kohë të vështirë.²

Prej ajeteve që përbëjnë temën tonë kuptojmë se thirrja e njerëzve për te feja e Allahut është vepra më e mirë në këtë botë. Vetëm se kjo nuk e arrin përsosmërinë plotësisht. Pra, ka disa kushte të cilat janë:

Kushti i parë: Të besojmë se kjo vepër që po bëjmë është më e mira dhe më e dobishmja në këtë botë.

Kushti i dytë: Ta ushqejmë këtë thirrje me vepra të mira. Kur t'i ftojmë njerëzit te feja e Allahut Teala duhet të jemi zgjidhje për ata që kanë mbetur në udhëkryq dhe t'i ndihmojmë të vetmuarit. Gjithashtu duhet të përpiqemi për t'ua zgjatur dorën e mirësisë të gjithë atyre që janë në vështirësi pa bërë këtu dallim ngjyre, race, gjuhe apo feje. Kushti i tretë: T'ua deklarojmë qartazi myslimanizmin atyre njerëzve të cilët i ftojmë te feja e Allahut (xh. xh.). Pra, t'u themi atyre: “Shikoni! Unë e ndjej në zemër hallin tuaj ngaqë jam mysliman. Andaj po përpiqem t'ju ngushëlloj sadopak qoftë.” Vetëm pasi të shprehemi kështu, mund të përparojmë një hap më tepër duke ua shprehur qëllimin e vërtetë që kemi: “Shqetësimi im nuk është i kufizuar vetëm me këtë. Unë dëshiroj që të jeni prej të shpëtuarve edhe në botën e përtejme.” Këtë derë me siguri mund ta hapim në sajë të veprave të mira që janë shprehur në krye të këtij materiali.

Siç është bërë e qartë edhe në ajetet fisnike, mirësia nuk është si ligësia. Madje, këto dy gjëra të kundërta as që mund të krahasohen me njëra-tjetrën. Për njeriun thuhet: “insanu abidu'l-ihسان / njeriu është rob i mirësisë.” Mirësitë bëhen shkak për hapjen e shumë deryeve që duken të mbyllura. Megjithëkëtë, mirësive që bëhen më shumë vështirësi e sakrifica nganjëherë nuk u dihet vlera apo nuk vlerësohen siç duhen për shkak të neglizhencës. Më e keqja, ka edhe momente kur të mirës i përgjigjen me të keqe. Ja pra, njerëzit që ftojnë te Allahut Teala, duhet të dinë t'i neutralizojnë me mirësi të gjitha këto.

1. Fussilet, 33-36.

2. Shik. Përkthimi dhe Komentimi i Kuranit Ruhul-Bejan, Ismail Haki Bursevi, Botimet Erkam, vëll. 18, fq. 96.

Ata duhet të bëjnë durim dhe të sillen me mirësi edhe ndaj atij që nuk i përgjigjet mirësisë me mirësi, edhe ndaj atij që nuk e di vlerën e mirësisë, madje edhe ndaj atij që i përgjigjet mirësisë me ligësi. Ata gjithmonë duhet të mendojnë fundin e kësaj pune. Njerëzit që i ftojnë të tjerët në fenë e Allahut duhet t'i kenë parasysh vështirësitë ndaj të cilave ka duruar i Dërguari i Allahut, (a.s.). Në këtë mënyrë shpresohet që mirësitë e vazhdueshme të bëhen shkak për zbutjen e zemrave të ashpra. Mirësia i ka bërë miq me myslimanët edhe të shkujdesurit që nuk ia dinin vlerën mirësisë, edhe armiqtë që i urrenin myslimanët. Vjen një ditë dhe puna për të ftuar në fenë e Allahut duke bërë vepra të mira e arrin përsosmërinë si vepra më e bukur në këtë botë dhe jep frytet e saj. Kjo vepër i shndërron armiqësitë në miqësi të mëdha. Me të vërtetë, ata që i ftojnë njerëzit te Allahu, duhet të flasin duke u besuar fjalëve të veta, sepse një shpresë të tillë na e ka dhënë vetë Allahu i Lartësuar. Siç shprehet edhe në tefsir, të gjitha të këqijat duhet të parandalohen me vepra të mira të cilat janë të kundërtat e të këqijave. Për shembull, zemërimi duhet të parandalohet me durim, injoranca e ashpërsia duhet të parandalohet me butësi e urtësi, ligësia duhet të parandalohet me falje. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Interesohu me atë që e shkëput lidhje me ty. Kontakto dhe komuniko me të. Fale atë që të bën padrejtësi dhe bëji mirë atij që të bën keq.”*³

Allahu i Lartësuar na e kujton edhe këtë se vetëm durimtarët ia dalin mbanë për t'ia kthyer të keqes me të mirë. Këtë mund ta shprehim edhe kështu: Ata që bëjnë shumë mirësi, ia dalin

mbanë për t'ia kthyer të keqes me mirësi. Andaj në këtë çështje veçanërisht duhet të kërkojmë ndihmë nga Allahu (xh.xh.). Kjo ndihmë në përgjithësi u jepet atyre që e përdorin veten në çështjet e thirrjes në fe dhe që e falënderojnë shumë Zotin (xh.sh.).

Të mos harrojmë se ka edhe një të vërtetë tjetër: Shejtani i mallkuar i lufton më shumë se të tjerët ata që i ftojnë njerëzit në fenë e Allahut Teala. Shejtani u bën vesvese këtyre njerëzve apo ua ekzagjeron/zmadhon vështirësitë me të cilat përballen. Ja, pikërisht këtu duhet të kërkojmë mbrojtje nga Allahu Teala prej kurtheve të djallit. Pra, duhet të themi “eudhu besmelenë” për t'iu përveshur përsëri veprës më të bukur në këtë botë me ndihmën e Allahut të Madhëruar i Cili dëgjon dhe di çdo gjë.

Nisur nga këto që thamë më sipër, dëshirojmë ta shprehim haptazi se të gjithë besimtarët janë të obliguar sipas mundësisë në çështjen për të thënë fjalën më të bukur në mënyrën më të bukur.



SALATET DHE SELAMET

Në suren Ahzab thuhet: *“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me “selam!”*”⁴ Në këtë ajet fisnik pasi na kujtohet se Allahu i Lartësuar dhe engjëjt e Tij i çojnë salate dhe selame Muhamedit, (a.s.), pra, pasi na kujtohet se Allahu e bekon atë dhe engjëjt e Tij luten për të, është urdhëruar që edhe besimtarët t'i çojnë salate e selame atij. Mbi të gjitha, ky urdhër nuk është kufizuar me asgjë. Domethënë, sa më shumë që t'i çojmë salavate Pejgamberit, aq më mirë është. I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, na jep këtë sihariq në një hadith fisnik: *“Atë që më çon një herë salavat, Allahu e bekon dhjetë herë për shkak të kësaj.”*⁵ Edhe në një hadith tjetër thotë: *“Njerëzit që do të jenë më afër meje ditën e kiametit, do të jenë ata që më kanë çuar më shumë salavate.”*⁶

Siç shpjegohet në tefsir, salavati i Allahut është që ta mëshirojë robin e Tij, Muhamedin (a.s.) dhe t'ia shtojë famën. Salavati i engjëjve është që Allahu t'ia shtojë famën Pejgamberit dhe t'i falë besimtarët. Ndërsa salavatet e besimtarëve janë lutje. Siç dihet, ka shumë tekste të salavateve të transmetuara nga i Dërguari i Allahut, (a.s.). Dërgimi i ndonjërit prej këtyre salavateve patjetër që e tërheq dashurinë e Profetit tonë të nderuar.

I dashuri gjithmonë duhet ta kujtojë atë që e do dhe duhet ta forcojë lidhjen shpirtërore me të. Atëherë, ajo që na takon neve për të bërë është që t'i çojmë sa më shumë salavate Pejgamberit (a.s.). Pra, të marrim pjesë frymë pas fryme apo pikë pas pike me të cilat do të formohet deti i salavateve deri në kiamet.

4. Ahzab, 56.

5. Muslim, salat, 70.

6. Tirmidhi, Vitri, 21.

3. Ahmed ibn Hanbel, Musned, 16999.



KIBLA FIZIKE DHE SHPIRTËRORE

TA KTHESH TRUPIN
DHE SHPIRTIN NGA ALLAHU

— Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz —

E dukshmja dhe e fshehta, trupi dhe shpirti, janë dy elemente të rëndësishme që mbështetin njëra-tjetrën në orientimin e njeriut nga Allahu. Robi i cili jeton sipas urdhrave hyjnorë, qëndron përpara Allahut, duke marrë si drejtim Qaben dhe ashtu si kompas që ka një këmbë të ngulitur në tokë, edhe ai e drejton trupin e tij në një drejtim të caktuar, ndërsa zemrën e tij e kthen nga Pronari i vërtetë i të gjitha anëve. Për këtë arsye, kibla ka dy dimensione; njëri është fizik dhe tjetri është shpirtëror.

Kibla fizike, është kthimi i robit në drejtim të Qabes gjatë namazit. Pra, drejtimi që marrim kur falim namaz, njihet si kible, sepse ai që fal namaz qëndron ballë përballë me drejtim nga kthehet. Ndërsa kibla shpirtërore, është kthimi i njeriut me gjithë zemër nga Allahu gjatë qëndrimit në namaz, por edhe jashtë namazit, në jetën e përditshme.

Kthimin e vërtetë nga Allahu dhe njohjen e Tij si një të vetëm, na e mëson ajeti fisnik, i cili na është dhënë si dua e Ibrahimit (a.s.): ***“Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!”*** (Enam, 6/79.)

Njeriu, duke e lexuar këtë ajet si një dua/lutje, e kthen trupin nga kibla (Qabja), ndërsa zemrën nga Allahu i Madhëruar, i Cili është pronari i Qabes. E rëndësishme, është të kthesh zemrën nga Allahu. Në këtë kthim, bëhet fjalë për fokusimin në adhurim me frymëzim dhe sinqeritet në të njëjtën pikë, si me trup ashtu edhe me zemër.

Kthimi nga kibla në namaz, për Allahun nuk ka kuptimin e kahut, sepse në namaz, robi është përballë Qenies së Plotfuqishme, i Cili është jashtë kohës dhe hapësirës. Mirëpo, për të përqendruar zemrën e çorientuar dhe për të siguruar bashkimin e xhematit, është e nevojshme një kiblë fizike. Ajo

që pritet prej robrit, është sexhdja dhe devotshmëria. Kur melekëve iu dha urdhër për t'i bërë sexhde Ademit (a.s.), në momentin kur ai u krijua, Ademi (a.s.), luajti rolin e kiblës, sepse sexhdja, i bëhet vetëm Allahut. Ndërsa Ademi (a.s.), u nderua duke u bërë kible për melekët.

Duke i urdhëruar me adhurime dhe bindje robërit që krijoi si halife në tokë, Allahu i Madhëruar, dëshiroi që ata t'i luten Atij dhe u premtoi se do t'ua pranonte lutjet.¹ Pas këtij premtimi hyjnor, sahabët shkuan tek i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe e pyetën se: “Ku duhet të bëjnë dua/të luten?”. Allahu i Madhëruar, pa përcaktuar ndonjë anë për dua dhe adhurime, urdhëroi me fjalën e Tij absolute: **“Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi, pra, ngado që të ktheheni aty është Fytyra (ana) e Allahut. Vërtet, Allahu është Gjithëpërfshirës dhe i Gjithëdijshëm.”** (Bekare, 2/115.) Në bazë të kuptimit të këtij ajeti, drejtimi i Allahut, nuk janë vetëm xhamitë ose vend-adhurimet, por çdo anë e tokës ku nuk gjendet asnjë pengesë për të kryer adhurimet dhe lutjet. Kjo, sepse Allahu nuk është i paarritshëm. Përveç kësaj, në këtë ajet bëhet fjalë edhe për orientimin e zemrës dhe Qaben shpirtërore.

Kthimi nga ana e Qabes, është një kthim fizik. Ndërsa kthimi i zemrës, është nga Fytyra e Allahut dhe kënaqësia e Tij. Allahu i Madhëruar, me Bukurinë dhe Madhësitinë e Tij shfaqet dhe është i gatshëm në çdo vend që dëshiron. Shfaqja e Allahut në zemra me Bukurinë e Tij, do të thotë se robi dëshmon për atë bukuri dhe se vetëm Atë njeh si shkaktarin absolut të çdo gjëje.

Pjesa e parë e sures Fatiha, fillon duke e vënë Allahun në vetën e tretë. Ndërsa në pjesën e dytë, Allahu vendoset në vetën e dytë, pra si bashkëbisedues. Një thirrje dhe një dua e tillë, do të thotë se njeriu po flet ballë përballë me Allahun, i Cili nuk është i kufizuar në hapësirë. Po ashtu, edhe kjo lutje: **“S'ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!”**² të cilën Junusi (a.s.), e bëri në barkun e peshkut, tregon qartë se Allahu është i pakufizuar në hapësirë.

Ai që e nuk orienton botën e tij të brendshme askund tjetër përveç Allahut, pra zemra e të cilit është gjithmonë me Allahun, edhe kibra e zemrës së tij, është Vetë Allahu i Madhëruar. Një njeri i tillë, qoftë edhe jashtë namazit, ngado që të kthehet, ai është gjithmonë me Allahun. Madje, njerëz të tillë, bëhen kible ashtu siç u bë Ademi (a.s.), kible për melekët. Si përfundim, ashtu si dheu që u nderua kur iu fry shpirti, ashtu edhe zemra e tij, kur takohet me Allahun bëhet një pjesë prej Qabes. Të gjitha këto,

janë shprehja e reflektimit të bukurisë së Allahut në pasqyrën e universit. Përpjekja e robrit për të parë bukurinë e Allahut në çdo grimcë të gjithësisë, e takon atë shpirtërisht me Zotin. Të drejtohesh nga Qabja e Qenies së Allahut dhe të arrish të shohësh bukurinë e Tij, është e mundur vetëm nëse zemra shijon eliksirin e teuhidit.

Zgjedhja dhe orientimi në botën e zemrës dhe shpirtit tonë, ka një lidhje me zgjedhjen e kiblës. Kibra e zemrës së atyre që janë të dhënë pas epshëve dhe janë robër të barqeve të veta, është sofra e gostive. Ndërsa kibra e atyre që janë të afërt me Allahun, është sidre-i munteha, që është edhe kati më i epërm. Kibra e të urtëve, është drita e takimit me Allahun, ndërsa kibra e mendjeve të filozofuara, është bota e imagjinatës. Kibra e asketëve, është Allahu Bamirës e Bujar. Ndërsa kibra e tamahqarëve, është qesja me flori. Kibra e njerëzve të pjekur shpirtërisht, është durimi dhe toleranca. Ndërsa kibra e të dhënëve pas formës dhe pamjes së jashtme, janë pikturat, bustet dhe idhujt. Kibra e atyre, vendbanimi i të cilëve është bota e shpirtit, është Allahu. Ndërsa kibra e atyre që nuk mund të zbresin në botën e brendshme, duke qëndruar veç në atë të dukshmen dhe duke adhuruar aparencat, është trupi dhe bukuria e fytyrës së grave.

Ruga për ta shpëtuar zemrën nga kjo botë duke i reduktuar zgjedhjet në një të vetme, është ta kthesh fytyrën dhe shpirtin nga Krijuesi i kiblës. Kush është i pavetëdijshëm ndaj kiblës fizike, drejtohet në kahe të gabuara dhe bëhet kukulla e kiblave të devijuara. Njeriu duhet të falënderojë Allahun, i Cili i ka dhënë aftësinë për të dalluar kiblën e vërtetë nga kibra e devijuar dhe ta përdorë aftësinë e tij në drejtim të kiblës së vërtetë. Në vend që të mbledhë pasuri nga hambari i kësaj bote e të arrijë mirësitë e saj, njeriu duhet të mos ndahet nga ata që ndajnë të njëjtat halle me të. Pra, nuk duhet ta lëshojë kurrë dorën që e mban dhe e ndihmon. Kush e lëshon dorën e mikun, bie në kurthet e shokëve të këqij. Për këtë arsye, njeriu duhet ta shpëtojë syrin dhe zemrën prej kësaj bote dhe trupit të krijuar prej balte, duke u kthyer në thelbin e tij, brenda vetes dhe të shohë vetëm një kible. Ata që e humbasin syrin e teuhidit, devijojnë nga kibra ose shohin dy kibra. Ndërsa ata që devijojnë nga teuhidi, humbasin plotësisht.

Ka prej njerëzve që shkojnë në Qabe duke ecur në këmbë. Ka të tjerë, që lodhen pa arritur në xhami dhe e humbasin veten. Dikush, me plot dëshirë jep jetën për hir të idealit të vet. Ndërsa dikujt tjetër i del shpirti kur jep edhe një kafshatë bukë. Ashtu sikur dëshira e të eturit është të shëtisë buzë kroit, të dëgjojë zërin e ujit dhe të pijë prej tij, ashtu edhe synimi përfundimtar i atij që shkon për haxh, është të bëj tavaf Qaben.

1. shih. Gafir, 40/60.

2. Enbija, 21/87.

Zemra e dashuruar, shkon e vjen çdo moment në Qabe. Në sajë të mirësisë së Allahut, trupi përvetëson zakonet e zemrës. Distancat e largëta apo afërta të rrugëve, vlejnë vetëm për trupin. Ndërsa në botën hyjnore nuk bëhet fjalë për distanca të largëta apo të afërta. Kur dëshiron Allahu, trupi ndryshon dhe distancat afrohen, sepse Bagdadi nuk është larg për të dashuruarin.

Në konceptin e tasavufit, midis kiblës fizike, pra Qabes dhe kiblës shpirtërore, gjithmonë ka ekzistuar një lidhje. Qabja, që është kibla fizike, është shumë e çmuar për besimtarët. Ajo që e bën atë një Faltore kaq të çmuar, nuk janë gurët apo dheut i saj, por për ndërtimi i saj me sineritet për hir të Allahut nga ana e një pejgamberi të madh. Pra, i të qenit **“Faltorja e parë e ngritur për njerëz, si e bekuar dhe udhërrëfyese”**³.

Tek ndërtuesi i saj, Ibrahim (a.s.), nuk kishte ambicie dhe mosbindje. Këto cilësi, i dhanë vlerë të madhe faltores që ai ndërtoi. Kur e përkujton gjendjen e tij, zemra e njeriut dridhet dhe emocionohet. Për këtë arsye, kjo faltore që ngriti ky pejgamber i madh, u bë edhe kibla jonë. Siç shprehet edhe Molla Xhami;

Qabja, është binaja prej guri që ndërtoi Ibrahim i biri i Azerit,

Ndërsa zemra, është vend-shikimi i Allahut.

Edhe pse Qabja fizike njihet si shtëpia e Allahut, Ai nuk ka hyrë asnjëherë aty. Pra, ai nuk është vendi i Allahut. Mirëpo, shtëpia e zemrës së robërve të mirë, nuk ka bujtur mysafir tjetër përveç Atij. Për shkak se Allahu nuk është i kufizuar në hapësirë, nuk mund të bëhet fjalë për futjen e Tij në ndonjë vend. E megjithatë, Ai hyn në

zemrën që është plotësisht e pastër.⁴ Ndërsa Junus Emre, bën një lidhje të tillë midis Qabes, kiblës dhe zemrës:

*Nëse do Allahun, kërkoje Atë në zemrën tënde
E jo në Kuds, Mekke apo Haxh.*⁵

Thënia e Mevlanës në një prej vargjeve të tija: *“O ju që shkoni në haxh! Ku po shkoni? Ejani se i dashuri është këtu!”*⁶, tregon shenjtërinë e shtëpisë së zemrës dhe se ajo (zemra) është Qabja e vërtetë. Kjo, sepse qëllimi i hanxhinjve që shkojnë në Qabe, mund të ngelet në Qabe. Ndërsa qëllimi i atyre që dëshirojnë Fytyrën e Allahut, është Pronari i Qabes. Njerëzit e rëndomtë, shkojnë në Qabe për një haxh të kësaj bote dhe të botës tjetër. Kurse, njerëzit me besim të përkryer, janë gjithmonë atje me zemrat e tyre; dera e Qabes është gjithmonë e hapur për ta, sepse zemra e njerëzve të tillë, është bërë një Qabe më vete.

Haxhilerët që udhëtojnë për në Qabe, bëjnë telbije, duke thënë *“Lebbejke Allahume / urdhëro o Zoti im të përgjigjem”* sa herë që kanë mundësi. Në fakt, ky përgjigjim i tyre nënkupton përgjigjen ndaj ftesës së Allahut të Madhëruar. T’i përgjigjesh zërit që vjen nga Allahu duke thënë *“lebbejk”* me dashuri e pasion, do të thotë t’i përgjigjesh ftesës hyjnore.

Qabja, që është kibla fizike e besimtarëve, është një shtëpi e thjeshtë. Por madhështia e saj, është një cilësi që mund ta shohin vetëm ata që e kanë të hapur syrin e zemrës. Myslimanët që kryejnë detyrimin e haxhit dhe i regjistrojnë këto zëra në shtëpinë e zemrës, edhe kur kthehen nga haxhi, arrijnë të ndërtojnë Qabet e zemrës me ndjenjën e mikpritjes së Allahut në Qaben e zemrës së tyre. Qëllimi i thënies *“lebbejk”* në haxh, i tavafit përreth Qabes dhe i kthimit nga kibla gjatë namazit, është ndërtimi i zemrës dhe shndërrimi i saj në një Qabe shpirtërore. Ose, orientimi i vazhdueshëm me zemër nga Allahu i Madhëruar.

3. shih. Al-i Imran, 3/96.

4. Ibn Arabi, *Kitab al-Hadith*, fq. 413, *Reshida*, 17, Bahar 2006, II, fq. 230, hadith nr. 2256.

5. Yunus Emre *Kallıyan Asik Yunus*, Izmir Mustafa Tarek, IV, 52/

6. *Yunus Emre*, 648.



SMIRA

ÇELËSI I SË KEQES

— Sadik Dana —

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “Kini kujdes prej smirës, sepse smira bëhet shkak për shkatërrimin e sevapeve siç i djeg dhe i shkatërron zjarri drutë.” (Xhamiu’s-Sagîr) “Smira e prish besimin e besimtarit siç e prish uthulla mjaltin.” (Menavi)

Ebu Hurejre (r.a.), transmeton se Resulullahu (a.s.), ka thënë: “Mos e urreni, mos e kini smirë dhe mos e xhelozoni njëri-tjetrin... Bëhuni robër të Allahut si vëllezër.”

Ibn Vefa (k.s.), thotë: “Bëj kujdes dhe mos ki smirë kundrejt dikujt që Allahu i ka dhënë mirësi dhe e ka bërë më të lartë se ty, sepse për shkak të smirës mund të tërheqësh zemërimin e Allahut Teala. Kështu që mund të kesh pasoja të rënda. Edhe Iblisi u mallkua ngaqë nuk i bëri sexhde Ademit, (a.s.), duke e pasur smirë dhe duke u mburrur. O bir i Ademit! Përderisa të kesh cilësi të mira, nuk largohesh nga origjina jote. Nëse cilësitë e mira ua lënë vendin cilësive të këqija, natyra njerëzore që posedon shndërrohet në natyre djallëzore.”

Sipas një transmetimi, Musai, (a.s.), kishte parë një burrë që qëndronte ulur në hijen e Arshit. Atij i pëlqeu gjendje e këtij burri dhe tha: “Ky burrë duhet të jetë një njeri i mirë te Allahu.” Pastaj e pyeti Zotin: “O Zot! Kush është ky burrë? Si e ka emrin?” Allahu Teala nuk ia tregoi emrin, por vetëm i tha: “Po të njoftoj se ai e ka arritur këtë gradë me tri vepra.” - dhe e njoftoi për këto tri vepra të cilat janë:

- Nuk pati smirë kundrejt askujt.
- Nuk i kundërshtoi prindërit.
- Nuk u mor me thashetheme.

Zekerija, (a.s.), na njofton se Allahu Teala ka thënë: “Ai që ka smirë është armik ndaj mirësisë Sime, është i zemëruar ndaj caktimit Tim dhe nuk e pranon ndarjen e rrëskut që kam bërë ndërmjet robërve.”

Hasan Basriu (k.s.), ka thënë: “O njeri! Përse nuk e duron dot vëllain tënd? Çfarë të drejte ke që t’i nxehesh (ta kesh zili) atë që Allahu Teala e ka nderuar, nëse ajo që i është dhënë është e drejtë e

tij? Nëse nuk është e drejtë e tij, atëherë çfarë i ke zili një njeriu që do të hyjë në xhehenem?”

Sheh Reslan ed-Dimeshki (k.s.), ka thënë: “Smira është çelësi i çdo lloji të keqeje. Zemërimi bëhet shkak që njeriu të kërkojë ndjesë dhe t’i rrëshqasin këmbët.”

Në shtresën e Harun Rrashidit gjendej e shkruar kjo shprehje: “Rrësku është ndarë në pafillimësi. Ai që ka smirë gjithmonë është i dëshpëruar, i shqetësuar dhe i brengosur.” (Rijadu’n-Nasihin, Tefsiri Mugni)

Smira është njëra prej sëmundjeve më të rrezikshme që nuk kanë shërim. Njeriu që ka smirë mërzhitet për begatitë dhe mirësitë që i posedon dikush tjetër. Madje, dëshiron që ky i fundit t’i humbasë ato. Këtij njeriu vazhdimisht i shtohet mërzhitja kur të tjerët të mos i humbasin mirësitë. Të urtët kanë thënë: “Smira është një shqetësim i brendshëm që asnjë mjek nuk mund t’i gjejë zgjidhje. Ajo shërohet vetëm me ndihmën hyjnore.”

Një burrë shkoi te Hasan Basriu (k.s.) dhe e pyeti:

“A ka smirë besimtari?” Ai iu përgjigj: “A i harrove bijtë e Jakubit, (a.s.)? Sigurisht që besimtari mund të ketë smirë. Vetëm se nuk dëmtohet aq shumë pasi të mos e shprehë dhe të mos veprojë sipas saj.”

Smira është prej moralit të ulët të nefsit. Andaj, besimtari e ka të nevojshme që ta zhdukë atë duke bërë vazhdimisht dhikër. Të zgjuarit duke bërë kujdes ndaj shenjave e paralajmërimeve të Allahut Teala dhe përpjekja për të shpëtuar nga kjo sëmundje janë detyrë për besimtarin. Këtë duhet ta dimë se ndryshimi që kanë njerëzit në dije, moral, cilësi, pozita dhe grada është mëshirë. Ndryshimi që njerëzit kanë në këto gjëra realizohet sipas caktimit që Allahu (xh.xh.), e ka bërë në pafillimësi.

Allahu Teala të gjithëve u ka dhënë sipas asaj që u ka caktuar. Nëse diçka është caktuar për dikë, ajo nuk mund të shkojë te askush përveç atij. Zoti na faltë, mos vallë nuk po e pranojmë caktimin e Zotit?



Sahabi nga Medina

Muadh ibni Enes Xhuheni

— Mustafa Erish —

Muadh ibni Enes Xhuheni (r.a.), ishte një sahab fatlum që mori pjesë nëpër luftëra së bashku me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Ai ka transmetuar hadithet që na mësojnë të dhënat e duhura për jetën tonë të përditshme si myslimanë. Ai ishte një dijetar që transmetoi hadithet fisnike në lidhje me moralin e lartë Islam si dhënia e selamit, mposhtja e zemërimit, modestia, të veshurit e thjeshtë dhe të jetuarit me falënderim e lavdërim ndaj Zotit (xh. xh.).

Muadh ibni Enes Xhuheni (r.a.), ishte i njohur me llagapin “sahabi nga Medina”. Gjithashtu njihet edhe si “Halifu’l-Ensar/personi që ka bërë marrëveshje me ensarët”. Nuk gjendet asnjë e dhënë e detajuar në lidhje me faktin nëse ka shkuar i vetëm apo me fisin në Medine dhe që pastaj është marrë nën mbrojtje duke bërë marrëveshje me ensarët. (Isabe, VI, 107.)

Meqë atij i thoshin Xhuheni, do të thotë se i përkiste fisit të njohur Xhuhejne. Ky ishte një fis i madh që jetonte në anët e Jenbusë afër Medines në Hixhaz. Edhe në anët e Egjiptit, Shamit dhe Jemenit gjenden fise të tjera që mbajnë emrin Xhuheni.

Muadh ibni Enes Xhuheni (r.a.), ka marrë pjesë në disa luftëra së bashku me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Një kujtim që e ka përjetuar përgjatë këtyre luftërave e transmeton vetë më poshtë.

Në literaturën islame nuk gjenden shumë të dhëna në lidhje me jetën e tij. Andaj nuk dihet se ku ka

lindur dhe ku është rritur. Vetëm thuhet se ai ka transmetuar rreth tridhjetë hadithe nga Pejgamberi ynë i nderuar. Këto hadithe fisnike kanë lidhje me moralin e lartë të Islamit dhe përmbajnë të dhëna që sistemojnë jetën e përditshme të myslimanëve. Disa prej tyre janë si më poshtë:

Muadh ibni Enes Xhuheni, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “Atë njeri që e mposht zemërimin edhe pse ka mundësi për tu vepruar, ditën e kiametit Allahu do ta thërrasë para syve të të gjithëve dhe do ta lërë të lirë të zgjedhë cilën të dëshirojë prej hurive.” (Ebu Davud, Edeb, 3; Tirmidhi, Birr, 74; Kijame 48; Ibn Maxhe, Zuhd, 18.)

Muadh ibni Enes Xhuheni, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “Nëse dikush thotë pasi të hajë ushqimin: ‘Falënderimi qoftë për Allahun i Cili ma dha këtë ushqim për ta ngrënë dhe më furnizoi me të pa përpjekjen dhe fuqinë time!’, i falen mëkatet e kaluara.” (Ebu Davud, Libas 1; Tirmidhi, Daavat 56; Ibn Maxhe, Et’ime 16.)

Në transmetimin e Buharit është shtuar edhe kjo pjesë: “Nëse dikush vesh një rrobë dhe thotë: ‘Falënderimi qoftë për Allahun i Cili ma mundësoi ta vesh këtë rrobë dhe më furnizoi me të pa përpjekjen dhe fuqinë time!’, i falen mëkatet e kaluara dhe të ardhme.” (Buhari, Tarihu’l-Kebir, VII, 360.)

Në Përkthimin dhe Shpjegimin e Rijazu’s-Salihin thuhet:

“Të thuash ‘bismil-lah” kur të fillosh për të ngrënë dhe të mbarosh duke thënë “elhamdulil-lah”, është sunet sipas rregullave të edukatës së Islamit. Ky veprim është një pasuri ahireti për çdo besimtar. Po ashtu është sevap për peshoren dhe pasim i gjurmëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ata që dëshirojnë ta falënderojnë shumë Allahun Teala për shkak të mirësive që u ka dhënë, duhet të bëjnë ndonjërrën prej lutjeve që përmenden në hadithet fisnike. Njëra prej lutjeve të shkurtra që e ka bërë i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, është kjo: “Elhamdulil-lahi’l-ledhi et’amina ve sekana ve xhealene mine’l-muslimin / Falënderimi qoftë për Allahun që na dha për të ngrënë e për të pirë dhe na bëri prej myslimanëve.”

Muadh ibni Enes Xhuheni (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “Nëse dikush nuk vesh rroba luksoze për modesti edhe pse e ka mundësinë, Allahu ditën e kiametit do ta thërrasë atë njeri më në fillim të krijesave për të dalë në audiencën e Tij dhe do ta lërë atë të lirë për të veshur cilën të dëshirojë prej rrobave që do të veshin besimtarët.” (Tirmidhi, Sifetu’l-Kijameh 39. Ahmed ibn Hanbel, Musned, III, 338, 339.)

Muadh ibni Enes Xhuheni (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “Atij që pas namazit të mëngjesit ulet dhe pret në vendin ku ka falur namazin pa thënë gjë përveçse ndonjë fjale të mirë deri kur të falë dy rekatë namaz të paradites, Allahu ia fal mëkatet edhe nëse janë të shumta sa shkuma e detit.” (Ebu Davud, Salat, 301.)

Muadh ibni Enesi (r.a.), ka transmetuar një hadith në lidhje me dhënien e selamit. Ky është një hadith i ngjashëm me dy hadithet që janë dhënë më poshtë. Ndryshimi i këtij hadithi gjendet në vazhdimësinë e tij. Muadhi transmeton se dikush kishte shkuar dhe kishte shtuar fjalën “ve magfiratuhu”. I Dërguari i Allahut (a.s.), kishte thënë: “Dyzet (sevape).” - dhe se “në këtë mënyrë shtohet sevapi (për çdo fjalë).” (Ebu Davud, Edeb, 144.) Hadithet janë transmetuar si më poshtë:

Imran ibn Husajni (r.a.), tregon: Kur ishim pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.), erdhi një burrë dhe na dha selam duke thënë: ‘Es-selamu alejkum!’ I Dërguari i Allahut (a.s.), ia ktheu selamin. Burri u ul. Pejgamberi ynë i nderuar tha: “Fitoi dhjetë sevape!”

Më vonë erdhi dikush tjetër dhe na përshëndeti duke thënë: “Es-selamu alejkum ve rahmetull-llah!” I Dërguari i Allahut (a.s.), ia ktheu selamin. Burri u ul. Resulullahu (a.s.), tha: “Njëzet!”

Pak më vonë erdhi edhe një tjetër dhe na përshëndeti: “Es-selamu alejkum ve rahmetull-llahi ve berekatuh!” Resulullahu (a.s.), ia ktheu selamin. I Dërguari i Allahut (a.s.), këtë herë tha: “Tridhjetë!”

Selman Farisiu (r.a.), të njëjtën ngjarje e transme-

ton kështu: “Një burrë erdhi te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i tha: “Es-selamu alejke!” Pejgamberi ynë i dashur iu përgjigj: “Ve alejke’s-selamu ve rahmetull-llah!” Më vonë erdhi një tjetër dhe dha selam duke thënë: “Es-selamu alejke ve rahmetull-llah!” I Dërguari i Allahut (a.s.), ia ktheu selamin: “Ve alejke’s-selamu ve rahmetull-llahi ve berekatuhu!” Pak më vonë erdhi edhe një tjetër dhe e përshëndeti: “Es-selamu alejke ve rahmetull-llahi ve berekatuhu!” Pejgamberi këtij ia ktheu: “Ve alejke!” Ky burrë e shfaqti habinë e tij dhe tha: “O i Dërguari i Allahut! Të tjerët para meje erdhën dhe të dhanë selam. Edhe ti ua ktheve atyre selamin më gjatë sesa mua.” I Dërguari i Allahut (a.s.), iu përgjigj: “Ti nuk na le gjë për të thënë! Allahu Teala thotë: “**Kur ju përshëndet dikush me respekt, kthejani me një përshëndetje më të mirë ose në të njëjtën mënyrë! Pa dyshim, Allahu llogarit çdo gjë.**” (Nisa, 86)

Muadh ibni Enes, (r.a.), tregon për një kujtim që e ka përjetuar në luftërat që ka marrë pjesë: Unë pata marrë pjesë në një luftë së bashku me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Ushtarët e ngushtuan vendin e bujtjes dhe e bllokuan rrugën. Nisur nga kjo, Pejgamberi (a.s.), dërgoi një tellall të ushtarët. Tellalli u tha ushtarëve se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Ai që e ngushton një vend apo bllokun një rrugë (apo e mundon një besimtar), nuk ka xhihad.” (Ebu Davud, Xhihad, 88/2629; Ahmed, III, 441.)

Ushtarët e ngushtuan vendin e bujtjes duke zënë vend më shumë seç kishin nevojë. Në këtë mënyrë, filluan ta vinin në pozitë të vështirë njëri-tjetrin. Ndërsa bllokimin e rrugës e bënë duke vendosur gjërat e tyre aty ku kalonin njerëzit. Pasi ushtarët vendosën gjërat e tyre, njerëzit nuk kishin ku të kalonin më.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), u tregoi ushtarëve se sa gabim i madh ishte ngushtimi i vendit të bujtjes dhe bllokimi i rrugës pa ndonjë nevojë. Pastaj, për t’i bërë ushtarët që të ishin më të përpiktë dhe të hiqnin dorë nga ky veprim, përdori një metodë të mrekullueshme duke u shprehur se ata që veprojnë në këtë mënyrë nuk do të marrin asnjë sevap nga xhihadi.

Muadh ibni Enes Xhuheni (r.a.), ka transmetuar hadithe edhe nga sahabët e njohur si Ebu’d-Derda (r.a.). Ndërsa prej Muadhit ka transmetuar hadithe biri i tij, Sehl ibn Muadhi (r.a.). Transmetimet e tij gjenden në “Musnedin” e Ahmed ibn Hanbelit (III, 437, IV, 234) dhe në katër “Sunenet” e mëdha. Muadh ibni Enes Xhuheni (r.a.), periudhën e fundit të jetës e ka kaluar në Egjipt. Ai ka ndërruar jetë në periudhën e kalifatit të Abdulmelik ibn Mervanit. (Isabe, VI, 107.)

Allahu qoftë i kënaqur prej tij! Allahu na e mundësoftë që të marrim mësim nga hadithet të cilat i ka transmetuar Muadh ibni Enes Xhuheni (r.a.)! Allahu na bashkoftë me të në xhenet! Amin!



KREMTIMET E KRISHTLINDJEVE DHE VITIT TË RI DHE LLOGARIA QË I BËHET NEFSIT

— Kemal Ball —

Vitit të Ri dhe Krishtlindjes u bëhet një njësim i gabuar, sikur të ishin të njëjta. Në fakt, kjo fjalë e ka burimin nga frëngjishtja “dies natalis”, që do të thotë “ditëlindja e Perëndisë” dhe që në latinisht është përdorur me fjalën “Noel”. Fjala “Noel”, në gjuhë të ndryshme perëndimore është përdorur në forma të ndryshme, fjala vjen; “il natale” (italisht), cristes - maese (anglishtja e vjetër), kerst - misse (danisht) etj. (Islam Ansiklopedisi, T. Diyanet Vakfi, Vol. 33, f: 201)

Zanafilla e festimeve të datës 25 Dhjetor si Krishtlindje në Krishterimin Perëndimor, bazohet në kremtimet që bëheshin me rastin e ditëlindjes së Mithra-s, perëndeshës së diellit (Natalis solis invicti), e cila festohej në Romën e Lashtë. Sipas teologëve të krishterë, kremtimi i Krishtlindjes nuk ishte pjesë e Krishterimit të hershëm, por ajo u shndërrua në një kremtim të krishterë nga festalet idhujtare që karakterizoheshin me elemente argëtuese pagane. Kjo gjë u bë me qëllim që të mbrohej Krishtërimi përballë besimit Mitra me rrënjë indopere në Romën e asaj kohe. Mirëpo, shumë kisha lindore kanë pëlqyer datën 6 janar si ditën e lindjes së Isait/Jezusit, ndërsa kishat perëndimore këtë ditë e kanë pranuar si dita e pagëzimit (Epiphani) e Isait/

Jezusit. Kësisoj, Krishtlindja tek të krishterët perëndimorë kremtohet më 25 Dhjetor dhe bashkohet me festën që bëhet me rastin e 1 janarit, që bazohet në kalendarin gregorian. (Po aty, f. 202.)

Plaku i Vitit të Ri, që në fakt në Perëndim njihet si Plaku i Krishtlindjeve, i cili si rrjedhojë lidhet ngushtësisht me festimet e Krishtlindjeve, natyrshëm dhe me Vitin e Ri, besohet se ka të bëjë me shenjtorin e krishterë me emrin Santa Nicholas, që mendohet të ketë qenë peshkop në zonën Derme të qytetit të Antalias së Turqisë dhe supozohet të ketë vdekur më datë 6 dhjetor 352. Ky njeri, që mendohet të ketë qenë mbrojtësi i marinarëve, tregtarëve, udhëtarëve dhe fëmijëve, më pas është shndërruar në një figurë përrallore me emrin Santa Claus, i cili u shpërndante dhurata fëmijëve natën e Krishtlindjeve. Ideja e veshjes së tij me ngjyrë të kuqe, mjekra e bardhë dhe e gjatë, dhe hyrja në shtëpitë përmes oxhakut, si dhe një sërë veçorish të tjera qesharake, ishin pjellë e imagjinatës së piktorit me emrin Thomas Nast, i cili pati shkruar një libër në vitin 1870. Kështu u përhap legjenda se Santa Clausi kishte shtëpi në vendin e acartë, në Polin Verior, si dhe përdorte një slitë me drerët Ren. Përsa i përket bredhit, i cili përbën një nga elementët kryesorë të festës së Krishtlindjeve,

pranohet se është me prejardhje nga rituali i adhurimit që i bëhej perëndisë Attis, të kulturës pagane greke dhe romake. Krishtlindja, e cila bazohet në besimin dhe filozofinë idhujtare dhe që është bërë më vonë pjesë e festave të krishtera, sot festohet si një festë e krishterë dhe elementet e posaçme të saj, bashkë me përhapjen e kulturës perëndimore në vendet që nuk janë të krishtera janë po ashtu një mundësi konsumi dhe feste, si pjesë e natyrshme e festës së Vitit të Ri. Po ashtu edhe praktika e vitit të ri, që është një pjesë e botëkuptimit kalendarik e formësuar sipas traditës së krishterë, është vazhdimi i një tradite pagane me prejardhje romake, që është shndërruar në një argëtim me konsum të tepruar. Ky fenomen sot kritikohet nga shumë të krishterë. (Po aty, f. 202.)

Ndaj dhe e shoh të arsyeshme të bëj të ditur se kjo datë nuk ka të bëjë fare me vitin e ri islam, i cili fillon me muajin Muharrem, atëherë kur myslimanët hyjnë në një vit të ri kalendarik. Hixhreti që ka bërë Krenaria e Gjithësisë, Pejgamberi (s.a.s.), nga Meka e Bekuar për në Medinen e Përndritur, është bërë si datë zanafillëse e kalendarit islam hixhri, që përkon me fillimmuajin Muharrem. Ky kalendar ka nisur të numërohet që në kohën e Hz. Omerit (r.a.). Përmes festimeve të Vitit të Ri që bëhen sot, dëmtohen imani ynë, vlerat morale dhe kombëtare tona, jeta jonë ekonomike dhe ajo sociale. Dihet mjaft mirë se sa e sabbamirësi mund të bëheshin me para që shpenzohen për pijet alkoolike që konsumohen në një natë të vitit të ri, bixhozet që luhen, argëtimet që bëhen në mënyrë të shfrenuar, shpërdorimet në ushqime, zbukurimet që u bëhen bredhave apo dekoret e tjera dhe paratë që jepen për të prerë gjelat e detit.

Me rastin e Vitit të Ri, ka mbetur mbrapa një vit i tërë (365 ditë, 52 javë, 12 muaj) dhe që nuk mund të rikthehet. Secili mund të ketë përgjigje të ndryshme lidhur me pyetjen: “Si kaloi viti 2013?” Pasi, secili bën jetën e vet, shkruan historinë e vet dhe nga pikëpamja e tij vëren gjithçka ndodh. Kur shohim mbetjet e një viti të tërë që lamë pas, nuk duhet të shikojmë thjesht si një vit “i mirë”, “i keq”, “i dhimbshëm”, “i këndshëm”, “i lehtë” apo “i vështirë”, por si “një vit i gjatë”, që kemi pasur 365 ditë për të shfrytëzuar. Ndërkohë që po hyjmë në vitin e ri, pikësëpari duhet të shohim vitin e kaluar.

Duhet t’i drejtojmë vetes pyetjen: “Çfarë kam bërë unë deri tani?” Nuk përbën ndonjë rëndësi ardhja e fillimvitit. Ajo çfarë ka rëndësi është se si duhet të jetë viti që po hyjmë. Çfarë duhet të bëj? Organet që Allahu na ka dhënë si amanet, a do t’i përdor sipas urdhrave të Allahut dhe sipas dëshirës së Tij. Ku do ta përdor mendjen? Ne duhet t’i drejtojmë vetes sonë pyetjen: “Çfarë do të bëj për njerëzimin, për fenë time?” dhe të jemi të vetëdijshëm që përballë kemi një vit të tërë dhe që na është hapur një faqe e re në jetën tonë. Duhet të pranojmë se urtësia: “Ai që nuk ia di vlerën kohës, me kalimin e kohës bëhet i pavlerë” është e vërtetë. Nuk duhet të harrojmë se orët që tregojnë kohën, janë treguesit e vetëm të rrugës së jetës sonë.

Ne duhet të shfrytëzojmë siç duhet çastin. E shkuara ka mbetur në të shkuarën. Atëherë, dita që duhet pasur vëmendja është dita e sotme dhe çasti është pikërisht ky çast. Kështu që duhet të reflektojmë në çdo pjesëz që e kemi ndarë kohën sipas rëndësisë që ajo ka.

Ne, tani që ende kemi mundësi, duhet t’i bëjmë një llogari të shëndetshme nefsit tonë, para se të takohet trupi me dheun, para se të qefinoset, para se t’u ketë dhënë krahëve shpirti dhe para se të ketë fluturuar në botën Berzah, para se të mbyllen dyert e pendimit. Duhet të shikojmë se me qendër çfarë e kemi jetën. Pas kujt po vrapojmë? Për ç’qëllim përpiqemi? Për çfarë po mendohe- mi? Shkurtimisht, a po e ndjejmë brengën islame në zemrën tonë? A na ikën ndonjëherë gjumi gjatë natës? Kur shohim një fëmijë jetim a ia përkëdhelim kokën dhe a prekemi sa të na mbushen sytë me lot? Si e harxhojmë 24 orëshin që na dhuron Fuqia hyjnore? A mund ta marrim në llogari veten para se të na marrë në llogari Allahu?

Le t’i vëmë veshin thirrjes hyjnore: **“Njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar.”** (Nexhm, 39.) Le të mos e harxhojmë kot jetën tonë. Le të mos bëhemi të sëmurë duke mbushur stomakun deri në mëngjes me idenë se duhet festuar viti i ri. Le ta harxhojmë mirë pasurinë që quhet “jetë”. Të mos e shpërdorojmë atë!

Le t’i hedhim një sy jetës së bashku! Le t’i bëjmë një llogari nefsit tonë! Le t’i japim një drejtim të ri jetës! Le të mos i bëjmë gabimet që kemi bërë në të shkuarën!



DY PLAGËT E SHOQËRISË ALKOOLI DHE DROGA

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

“Emr-i bi'l-ma'ruf vëllazëria islame na ishte,

E pengonte vëllai vëllain kur në të keqe e shihte!”¹

Në shkrimin tonë të radhës në serinë me titull “Dëmtuesit e jetës së umetit”, do të vazhdojmë me trajtimin e temës së varësisë ndaj alkoolit dhe drogës.

Përveç personave dashakeqës dhe injorantëve, nuk bëhet fjalë që dikush tjetër të mund të ketë kundërshtime për sa i përket dëmeve të alkoolit dhe lëndëve narkotike. Më duket sikur ju dëgjoj të thoni se, për të trajtuar një temë të tillë në lidhje me të cilën gjithkush është i vetëdijshëm, duhet të ketë një arsye të rëndësishme. Të them të drejtën, më duhet të pohoj se edhe unë e ndjej një ngurrin të tillë. Mirëpo, për nga aspekti i ruajtjes së tërësisë së serisë “Dëmtuesit e jetës së umetit”, tek unë mbizotëroi më tepër mendimi i domosdoshmërisë së trajtimit të varësisë ndaj alkoolit dhe drogës.

Para së gjithash, Zoti ynë i Madhëruar e ka cilësuar alkoolin si “**vepër e ndytë e shejtanit**”², ndërsa i Dërguari i Tij (a.s.), e ka cilësuar si “nëna e të gjitha të këqijave”³. Fakti që alkooli të jep guxim për të bërë të këqija dhe gjynahe, ambientet që krijohen përreth alkoolit, fenomenet negative që vërehen në sektorët si ato të reklamave dhe të tregtisë etj., janë tregues të mjaftueshëm se alkooli dhe lëndët narkotike janë gjynahe shumë të mëdha dhe nëna e të gjitha të këqijave. Pra, është e qartë se të gjitha këto janë vepra të pista që dëshiron t'i nxisë shejtani.

Këto evidencime që i tejkalojnë shekujt, janë deklarata të hapur se alkooli dhe lëndë të tjera si drogat të cilat ia marrin mendtë njeriut, janë gjithmonë në aktualitetin e jetës së umetit në aspektin e moralit dhe të marrëdhënieve njerëzore dhe gjëra me rrezik dhe dëm shumë të madh.

Përveç kësaj, edhe historiani anglez A. Toynbee, është shprehur se, “Qytetërimi islam, është më superior

1. - Mehmet Akif Ersoj

2. - shih. Maide, 90.

3. - shih. Ibn Hibban, Sahih XII, 170; Darekutni, Sunen IV, 247.

ndaj Qytetërimit Perëndimor në tre aspekte të ndryshme, që janë, ruajtja e besimit monoteist, ndalesa e racizmit/nacionalizmit dhe ndalesa e alkoolit”. Me këtë, ai e tregon umetin e Muhamedit (a.s.), si shembull për perëndimorët. Padyshim se një evidentim i tillë, është një arsye më tepër që e bën të detyrueshme trajtimin e kësaj teme nga aspekti i jetës së umetit. Kjo, sepse në ditët tona, umeti i Muhamedit (a.s.), po vuan probleme shumë të mëdha në aspektin shoqëror për shkak të nacionalizmit/racizmit dhe në aspektin moral për shkak të alkoolit dhe drogës.

Në vitet kur ende nuk kishin filluar transmetimet televizive, një ministër i Doganës, mbajti një fjalim në radion e shtetit, të cilin nuk do ta harroj kurrë. Ndër të tjera, ai tha: “Niveli i zhvillimit të një populli, matet me përqindjen e alkoolit që ai konsumon!” Për mua, ky ishte një pohim i qartë i gjendjes së keqe në të cilën ndodheshim.

Ndërsa kohët e fundit shohim politikanë që në vend që ta përgëzojnë faktin që tashmë në mbledhjet zyrtare nuk ofrohen më pije alkoolike, ata e kundërshtojnë këtë sikur të ketë ndodhur ndonjë krim, duke e konsideruar madje në kundërshtim me filozofinë e themelimit të shtetit dhe si presion apo mungesë respekti ndaj të ftuarve.

Nga ana tjetër, vërehet se përdorimi i duhanit, alkoolit dhe drogës, të cilat janë edhe nxitëse të njëra-tjetrës, ka zbritur deri në moshën e shkollës fillore, fenomen ky që është shtuar mjaft, dhe që në aktualitetin tonë, trajtohet si një arsye e hidhur shoqërore.

Atëherë, pikësëpari le të kujtojmë ajetet fisnike që bëjnë të qartë ndalesën në lidhje me alkoolin:

“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e shejtanit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni!

Vërtet, shejtani me pije alkoolike dhe me bixhoz kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t’ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë? Binduni Allahut dhe binduni të Dërguarit! Kujdes! Nëse nuk ia vini veshin, ta dini se i Dërguari ka për detyrë vetëm të përçojë shpalljen e qartë!” (Maide, 90-92)

MESAZHI I AJETEVE FISNIKE

Në këto ajete, shihet qartë se ndalimi i pijes alkoolike ka ardhur në mënyrë graduale, duke e bërë shoqërinë të mendojë dhe duke e edukuar

atë në këtë çështje. Dhe, në fund, është dhënë vendimi i prerë i ndalesës, duke theksuar se ajo është “një vepër e ndyrë e shejtanit” dhe “një poshtërsi”. Më pas, është urdhëruar se: **“...Me pije alkoolike dhe me bixhoz, shejtani kërkon të fusë armiqësi e urrejtje midis jush dhe t’ju shmangë nga përkujtimi i Allahut dhe kryerja e namazit...”**, duke e shprehur qartë rrezikun që kanë këto për strukturën e umetit. Menjëherë pas saj, shpjegohet se ato pengojnë në kryerjen e detyrave personale dhe thelbësore ndaj Krijuesit

(si përkujtimi i Allahu dhe namazi). Në këtë mënyrë, i është bërë një thirrje vetëdijes së besimtarëve edhe për dëmet individuale, edhe për dëmet shoqërore që shkaktojnë ato. Madje, në një farë kuptimi, duke u shprehur, “...

Prandaj, a po hiqni



ËSHTË SHUMË E QARTË SE NUK KA ASNJË RRUGË TJETËR PËRVEÇ ZBATIMIT TË KËSAJ MASE THELBËSORE QË ËSHTË MARRË NË FUSHËN E MORALIT NGA ANA E FESË SONË MADHËSHTORE PËR SIGURIMIN E NJË JETE TË SHËNDETSHME DHE TË GJALLË TË UMETIT.

dorë?..”, duket sikur zbatimi i kësaj ndalese i është lënë në dorë disi edhe vetë besimtarëve. Kjo ndalesë, synon të parandalojë varësinë ndaj atyre të këqijave të përmendura dhe të veprave apo gjërave të ngjashme si varësia ndaj drogës, etj., të cilat janë një rrezik i madh për identitetin e myslimanit, shëndetin e tij trupor e shpirtëror, për dinamikën e shoqërisë/umetit dhe për lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër. Dëmi më i madh i pijeve alkoolike dhe lëndëve narkotike, është zakoni/varësia që ato krijojnë tek përdoruesit, gjë

e cila është shumë e vështirë të parandalohet qoftë edhe me përpjekje dhe shpenzime të mëdha.

Me çfarëdolloj arsyeje qoftë, nëse nuk u vihet veshi paralajmërimeve në këto ajete fisnike, e vërteta që duhet ditur, është se: ***“i Dërguari ka për detyrë vetëm të përçojë shpalljen e qartë!”*** Pjesa tjetër, i mbetet atyre që nuk janë të bindur. Pra, ky mbetet problemi i tyre.

HADITHET FISNIKE

Profeti (a.s.), i cili është përpjekur vazhdimisht për të ndërtuar një strukturë shoqërore të pastër prej çdolloj të keqeje dhe ndyrësie dhe për ta zbukuruar me virtyte të larta, në lidhje me çështjen e pijes alkoolike, ka shumë thënie, disa prej të cilave është me vend t’i përmendim në këtë shkrim:

Aisheja (r.anha), tregon: “I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: «Çdo pije që të deh është haram!»” (Buhari, Eshribe 4, Udu 71)

Shprehja, “pije që të deh”, e përdorur në këtë hadith, ka kuptim të përgjithshëm, gjë që do të thotë se përfshin edhe çdo lloj lënde narkotike.

Xhabir bin Abdullah (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “Ajo që të deh me të shumtën e saj, është haram edhe e pakta e saj!” (Ebu Daud: 3681, Tirmidhi: 1927, Ibni Maxhe: 3393.)

Rreziku që ka pija alkoolike për shoqërinë/umetin, është shprehur shumë qartë me këto pak fjalë:

“Pija alkoolike është nëna e të gjitha të këqijave.” (Ibn Hibban, Sahih, XII, 170; Darekutni, Sunen IV, 247.)

Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet se Osmani (r.a.), ka thënë:

“Ruhuni prej pijes alkoolike, sepse ajo është nëna e të gjitha të këqijave!” (Nesai, Eshribe, 44.)

Në një transmetim tjetër, kjo shprehje është shpjeguar me këto fjalë:

“Qëndroni larg pijes alkoolike, sepse ajo është çelësi i çdo të keqeje!” (Ibn Maxhe, fiten 23; Bejhaki, Shuabu’l-iman V, 10, 11; Hakim, Mustedrek, IV, 162.)

Fakti që në kohën tonë pijet alkoolike janë emërtuar me emra të ndryshëm si, birrë, alkool, raki, vodkë, shampanjë etj., nuk e ndryshon vendimin për ndalesën e tyre për sa kohë që ato shkaktojnë dehje. Lidhur me këtë, na ka tërhequr vëmendjen edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili ka thënë:

“Disa njerëz prej umetit tim, do të pinë alkool dhe do ta emërtojnë atë me emra të ndryshëm!” (Ahmed b. Hanbel, Musned IV, 237; Bejhaki, es-Sunenu’l-kubra, VIII, 512, 513.)

Shprehja “të pish” e cila përdoret në këto hadithet fisnike, padyshim që përfshin edhe lëndët narkotike që merren në mënyra të ndryshme dhe të cilat bëhen shkak i humbjes së funksioneve normale mendore, qoftë edhe për një kohë të shkurtër.

Është shumë e qartë se nuk ka asnjë rrugë tjetër përveç zbatimit të kësaj mase thelbësore që është marrë në fushën e moralit nga ana e fesë sonë madhështore për sigurimin e një jete të shëndetshme dhe të gjallë të umetit. Kjo duhet të bjerë në vesh të çdo kryetari shteti të vendeve islame!



SOLIDARITETI MES BESIMTARËVE

— M. Sami Ramazanollu —

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që të mëshiroheni.” (Huxhurat, 10)

Pra, për shkak se besimtarët janë të gjithë të mbledhur nën flamurin e teuhidit, ata janë si vëllezër të lindur prej një nëne dhe një babai. Prandaj, nëse midis vëllezërve shfaqen grindje dhe debate, atëherë pajtojini ata.

“...Mos e nënçmoni dhe mos e qesëndisni njëri-tjetrin me nofka (të këqija)! Sa e shëmtuar është të thirresh me emër të keq pas (pranimit të) besimit!..” (Huxhurat, 11) Nisur nga kjo, nëse dikush e shan ose i thërret vëllait të vet me një emër të papëlqyeshëm, ai duhet të nxitojë të bëjë teube, të pendohet tek Allahu.

Pra, o besimtarë, nëse bëni gabim dhe shani njëri-tjetrin me fjalë të këqija, është njësoj sikur keni sharë veten tuaj, sepse besimtarët janë si një person i vetëm në vëllazërinë islame. Për rrjedhojë, nëse një besimtar shahet ose përçmohet me diçka, është njësoj sikur janë sharë dhe përçmuar të gjithë besimtarët.

Shkaku i zbritjes së ajetit fisnik në lidhje me përgojimin, ishin përgojimet ndaj Selman Farisiut (r.a.):

Në disa udhëtime, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e caktonte Selman Farisiun (r.a.), si ndihmës të dy personave që përgatitnin ushqimin. Njëherë, Selman Farisiun (r.a.), e kishte marrë gjumi dhe nuk e kishte përgatitur ushqimin. Dy personat e dërguan Selman Farisiun (r.a.), te Profeti (a.s.), që të merrte ndonjë ushqim që mund të kishte tepruar. Selman Farisiu (r.a.), shkoi tek Usame bin Zejdi (r.a.), i cili përgatiste ushqimin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Kur Usame bin Zejdi (r.a.), i tha se nuk kishte ngelur më ushqim, Selman Farisiu (r.a.), u kthye dhe u tha se nuk kishte ngelur më asgjë për të ngrënë.

Më pas, këta dy persona filluan ta përgojonin Selman Farisiun (r.a.), duke thënë: “Edhe nëse e çon në një pus me ujë, kthehet pa ujë!”. Madje thanë edhe se, gjoja i Dërguari i Allahut, (a.s.), paska pasur ushqim, por Usame bin Zejdit (r.a.), nuk i paska dhënë.

Kur këta dy persona erdhën para të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ai tha:

“Ç’po ndodh me mua, që po shoh copa mishi jeshile në gojën tuaj!?” Ata thanë:

“Ne nuk kemi ngrënë mish o i Dërguar i Allahut!” Mirëpo, Profeti u tha:

“Keni përgojuar Selmanin. Nëse një besimtar përgojon vëllain e tij, është njësoj sikur t’ia ketë ngrënë mishin!”

Ja pra, sipas Haizit dhe Bejdaviut, pas kësaj ngjarjeje u zbrit edhe ai ajet fisnik.

Njëherë, Ebu Dherri (r.a.), i foli rëndë Bilal Habe-shiut (r.a.), duke e thirrur: “O biri i gruas së zezël!” Menjëherë pas kësaj, Bilali (r.a.), u ankua tek i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili tha:

“O Eba Dherr! A po e shan për shkak të nënës së tij? Domethënë, ti paske ende prej moralit të injorancës brenda teje” Më pas vazhdoi e tha:

“Ka nga ata vëllezër që janë nën urdhrat tuaja, të cilët Allahu i Madhëruar ua ka besuar juve!” (Bu-hari) Pra, Profeti (a.s.), ka urdhëruar që edhe pse janë ende robër, me ta duhet të silleni si vëllezër!

Më pas, për t’i fituar përsëri zemrën Bilal Habe-shiut (r.a.), Ebu Dherri (r.a.), e vendosi faqen në tokë dhe tha: “Nuk do të ngrihem nga këtu derisa Bilali të më shkelë me këmbën e vet në fytyrë!”

Ja pra, në këtë hadith fisnik, ka shumë këshilla mësimdhënëse për ne, umetin e Muhammedit (a.s.).



BAZAT E NJË SHOQËRIE *të shëndetshme*

— Doç. dr. Kerim Bulladë —

“O Besimtarë!... Ndhimoheni njëri-tjetrit në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi! Frikësojuni Allahut, sepse Ai dënon ashpër!” (Maide, 2)

Ky mesazh, që përbën një pjesë të ajeti 2 të sures Maide, është një nga përgjegjësitë më të rëndësishme që Kurani u ngarkon atyre që i besojnë atij. Mësimet që përmenden në ajetin e mësipërm, janë kriteret më themelore që Kurani kërkon për formimin e personalitetit të besimtarit dhe për ndërtimin e një shoqërie të pastër. Termat, “birr/mirësi”, “takua/devotshmëri”, “ithm/gjynah” dhe “uduan/armiqësi”, të cilat përdoren në ajet, mbase janë termat më gjithëpërfshirës që e shpjegojnë më mirë qëllimin e shpalljes së fundit hyjnore, Kuranit dhe, se çfarë lloj njerëzimi dhe jete shoqërore kërkon ai. Kurani, kërkon një shoqëri ku boshti kryesor është paqja, ku njerëzit ndihmohen me njëri-tjetrit në mirësi, qëndrojnë larg armiqësisë dhe para së gjithash, kanë përvetësuar vetëdijen e devotshmërisë dhe frikës ndaj Allahut, duke qëndruar larg të këqijave. Me qëllim që kjo çështje të kuptohet më qartë, është me dobi të qëndrohet pak tek këto terma që përdoren në ajet:

1- Birr

“el-Birru”: Ka kuptimet, ndershmëri, fjalë-drejtë, besnikëri, bindje, mirësi, bamirësi, vepër e mirë që të afron tek Allahu, të tregohesh i mirë, të jesh i përlulur, të sillesh me respekt, të gostitësh njerëzit, t’i bindesh prindërve dhe të sillesh mirë me ta, etj.

Nëse nisemi nga kuptimi leksikor i fjalës “el-Birru”, kuptojmë se Allahu i Madhëruar kërkon prej besimtarëve të veprojnë me mirësi, besnikëri dhe të ndihmohen me njëri-tjetrit në punë të mira. Ai i urdhëron ata të jenë besnikë në fjalët e tyre, të sillen me respekt ndaj njëri-tjetrit, t’i binden prindërve dhe të ndërtojnë një bashkësi të shëndetshme. E thënë me pak fjalë, Allahu i Madhëruar, dëshiron prej besimtarëve që ata të ndërtojnë një shoqëri që i bindet Atij, është besnike dhe e pastër nga gjynahet.

2- Takua

“et-Takua”, rrjedh prej rrënjës “ueka-jeki-uikajeten” dhe do të thotë: Të kesh frikë, të ruash diçka, të mbrosh, të kujdesesh për diçka, të ruash veten, të jesh i kujdesshëm, të mbrohesh prej gjërave që të dëmtojnë, etj. Fjala takua, përmban kuptimet si, të kesh frikë prej Allahut, të bësh kujdes ndaj hallallit dhe haramit, të sigurosh mbrojtje ndaj diçkaje të rrezikshme, etj. Ndërsa kuptimi terminologjik i fjalës takua, është, “të ruash veten prej gjërave që bëhen shkak për hyrjen në gjynahe”.

Termi “takua”, është një prej termave kryesor të Kuranit. Allahu i Madhëruar, kërkon që njeriu, e në mënyrë të veçantë besimtari, t’i rregullojë të gjitha veprat e tij në lidhje me këtë botë dhe botën tjetër, në bazë të kriterëve të “takua-s”. Për shkak të rëndësisë që ka, forma paskajore e këtij termi, “el-uikaje”, së bashku me format e tjera të saj, përdoret 258 herë në Kuran. Ky fakt, tregon qartë rëndësinë e

madhe që ka termi “takua” në përbërjen semantike/kuptimore të Kuranit.

Fjala “ittika”, do të thotë, të kesh frikë prej Allahut dhe të ruhesh prej haramit dhe gjërave të dyshimta. Kjo gjendje quhet “takua”, ndërsa personi që ka këtë cilësi, quhet “muttaki”. Një njeri që është “muttaki”, do të thotë se është një njeri i besueshëm dhe prej tij nuk vjen asnjë e keqe. Në pikëpamjen Islame, njerëzit janë të barabartë me njëri-tjetrin dhe superioriteti mund të jetë vetëm në “takua”.

Muttaki, është ai që ka respekt të thellë për Allahun. Ata që ndajnë respekt për Allahun, kanë respekt edhe për robërit e Tij dhe për të drejtat e tyre. Për këtë arsye, Kurani kërkon një sistem shoqëror ku mbizotëron takua. Dhe kjo është e mundur vetëm nëse besimtarët ndihmohen ndërmjet njëri-tjetrit në çështjen takuas. Largimi prej haramëve, plotësimi i farzeve, mbizotërimi i drejtësisë, ruajtja e të drejtave vëllazërore, shërbimet e bamirësisë, ruajtja prej gjynaheve, ndihmesa mes njeri-tjetrit në kryerjen e adhurimeve, etj., janë nga detyrat më të rëndësishme që Kurani ua ngarkon besimtarëve. Pa u plotësuar këto rregulla të rëndësishme, duket e pamundur të ndërtohet një shoqëri e virtytshme dhe një personalitet “muttaki”. Shoqëria Islame dhe Qytetërimi Islam i cili është themeluar mbi këtë shoqëri, është ndërtuar dhe ka marrë formë mbi themelet e takuas.

Në lidhje me termin e “takuas”, është bërë edhe një përkufizim që përfshin kuptimin e kryerjes së detyrave fetare dhe morale dhe ruajtjen prej sjelljeve dhe qëndrimeve të cilat konsiderohen të rrezikshme nga feja dhe morali. Nëse e mendojmë kuptimin e ajetit duke u nisur nga kjo, bëhet e qartë se ndihmesa e besimtarëve ndërmjet njëri-tjetrit në luftën kundër të këqijave në shoqëri dhe në parandalimin e tentativave që prishin rregullin shoqëror, ka një rëndësi shumë të madhe. Termi “takua”, që shpreh kapjen pas urdhrave të Allahut dhe largimin në mënyrë rigoroz nga ndalesat e Tij, përbëjnë themelin e drejtësisë, durimit, vetëmohimit, mjaftueshmërisë, mëshirës, shkurtimisht të të gjitha virtyteve.

Nëse do të marrim parasysh domosdoshmërinë e drejtësisë në sistemin e jetës shoqërore, del në pah se “takua-ja”, tashmë nuk përbën vetëm një virtyt individual, por në të njëjtën kohë është edhe një domosdoshmëri e sistemit shoqëror. Nisur nga kjo, takuaja është një parim i rëndësishëm i cili vë rregull në jetën e individit dhe të familjes së tij.

3- Ithm

Fjala “ithm”, e cila përfshin kuptimet, gjynah, krim, faj, etj., rrjedh prej rrënjës “ethime-jethimu”, ndërsa shumësi i saj është “atham”. Ky është emri

i veprave që vonojnë ose ngadalësojnë sevapin. “Ithm”, është veprimi i diçkaje që nuk është hallall. Ithm është quajtur kumari, alkooli dhe gënjeshtria. Kjo fjalë është pranuar si antonimi i fjalës “birr”. Nëse fjala “birr” shpreh veprimin që kënaq shpirtin (qetëson ndërgjegjen dhe të jep gëzim), fjala “ithm”, shpreh diçka që të ther zemrën. Ithm-i është diçka që edhe logjikisht, edhe ligjërisht është e detyrueshme t’i qëndrosh larg. Ithm, është gjynahu që e bën njeriu të meritojë dënim. Me të, mund të shprehen vetëm gjërat që janë haram.

Midis fjalës “ithm” dhe “dhemb” ka disa dallime. “Dhemb”, është gjynahu që bëhet me dije ose padije, ndërsa “ithm”, është gjynahu që bëhet me dije, me dashje dhe që meriton dënim.

Siç mund të kuptohet nga të gjitha këto shpjegime, Allahu i Madhëruar, ka kërkuar që besimtarët të mos ndihmohen ndërmjet vete në kryerjen e veprimeve që sheriat i konsideron gjynahe, të largohen prej haramëve si, alkooli, kumari dhe gënjeshtria dhe të mos e mbështesin kryerjen dhe përhapjen e këtyre. Gjynahu është një veprim që prish shoqëritë dhe eliminon paqen dhe qetësinë. Gjynahu është pengesa më e madhe në ndërtimin e një shoqërie të pajisur me virtyte morale, të drejtë dhe të ndërgjegjshme. Gjynahet janë ato që shkatërrojnë qytetërimet dhe bëhen shkak të ardhjes së fatkeqësive nga qielli dhe nga toka.

4- Uduan

Termi “uduan”, rrjedh nga rrënja “ada” dhe ka kuptimet; armiqësi, të mbash qëndrim armiqësor, të bësh zullum, të sulmosh, të kalosh kufijtë, etj.

Nisur nga këto kuptime, është e qartë se Allahu i Madhëruar në suren Maide, ajeti 2, kërkon prej besimtarëve të mos ushqejnë armiqësi ndaj njëri-tjetrit dhe të mos e ndihmojnë njëri-tjetrin në armiqësi, zullum, në moszbatimin e drejtësisë dhe të tjera veprime të ngjashme. Me pak fjalë, në ajetin e mësipërm, Allahu i Madhëruar kërkon prej besimtarëve të jetojnë si vëllezër, të ndërtojnë një shoqëri të virtytshme, të sigurojnë mbizotërimin e moralit të bukur dhe drejtësisë dhe të mos e ndihmojnë njëri-tjetrin në armiqësi dhe gjynahe.

Është shumë e qartë se myslimanët e kanë të domosdoshme ta ndihmojnë njëri-tjetrin në fushën ekonomike dhe shoqërore. Ajeti i mësipërm e shpreh në mënyrë shumë të qartë se besimtarët duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në fushën shpirtërore, në kryerjen e adhurimeve, në ruajtjen prej gjynaheve dhe qëndrimin larg prej tyre. Në mënyrë të veçantë, theksohet domosdoshmëria e këtyre rregullave në ndërtimin e një shoqërie islame.

Allahu e di më mirë!

Krugëtimi shpirtëror

— Hasan Tahsin Karaman —



Në përgjithësi, njerëzit synojnë të jenë profesionistë. Në cilëndo fushë goftë, synimi është ndërtimi i një personaliteti të pajisur me aftësitë dhe dijen më të përsosur. Ndonjëherë, specializimi në një fushë, i merr vite njeriut, e madje ai e shpenzon të gjithë jetën e tij në këtë drejtim.

Shoqëritë njerëzore i ndërtojnë qytetërimet e tyre mbi supet e njerëzve cilësorë që kanë edukuar. Njeriu e jep rezultatin e përpjekjeve të edukimit në fund të dhjetëra viteve pune të lodhshme. Ndonjëherë, ky proces zgjat edhe më shumë. Investimi në një fryt që do të formohet vite e vite më vonë, në përgjithësi i turbullon synimet e mendësive që bëjnë llogari të cekëta. Njeriu, i cili për nga natyra e krijimit është “i nxituar”, dëshiron gjithmonë qëllimet e afërta.

Në këtë mënyrë, edhe “fetaria”, e thënë ndryshe, “zbatimi praktik i besimit”, nuk mund ta shpëtojë veten nga cilësia e “nxitimit”, sepse zbatuesi i saj është njeriu.

Allahu është një genie që nuk përkufizohet me hapësirë. Për këtë arsye, është e pamundur t’i afroresh apo t’i largohesh atij goftë edhe një hap. Entuziazmi i të rinjve të cilët dëshirojnë që gjithçka të bëhet e të mbarojë menjëherë, përplasat dhe copëtohet në procesin e durimit që zgjat një jetë të tërë. Krijuesi nuk dëshiron prej njeriut shkelqime të përnjëhershme dhe akumulime të çrregullta të ngjeshura në një kohë shumë të shkurtër, por një “pjekuri shpirtërore” të purifikuar në enën e durimit.

Rruga në të cilën do të ecet dhe distanca që do të përshkohet fillon me dëshminë islame dhe mbaron në frymën e fundit, duke qenë i kënaqur prej Allahut dhe Ai i kënaqur prej teje. Në këtë rrugë, e cila është e rrethuar me mijëra banditë, as nuk mund të ndalesh, e as nuk mund të kthehesh pas. Rruga e fesë është një “proces durimi”, në të cilën përparohet pa ndaluar, pa prituri dhe në bazë të fuqisë së njeriut...

“Profesionalizmi” shihet si synim dhe është i lavdëruar në çdo çështje. Por kur bëhet fjalë për çështjen e fesë, profesionalizmi kërkon një trajtim të veçantë. Momenti kur vendosni t’i jepni formë jetës suaj në bazë të besimit, është shumë i rëndësishëm. Që prej atij momenti, në çdo drejtim dhe në çdo çështje do të shihni prej dritares së besimit tuaj. Dijet që sapo keni mësuar, zënë vend në zemrën tuaj, të cilën nuk e mban vendi prej entuziazmit, si argumente që nuk mund të refuzohen. Gjendja që keni arritur, bën që në kujtesën tuaj të ringjallen me keqardhje të thellë ato që keni përjetuar në të shkuarën. Në zemrën tuaj, në fillim shfaqet një ndjenjë keqardhjeje për ata që ju kalojnë pranë të zhytur në indiferencë, e më pas zemrën e kaplon një zemërim i lehtë...

Ju nuk i diskutoni të vërtetat që keni gjetur dhe askush nuk mund t’ju pengojë prej përjetimit të atyre që keni mësuar. Namazet e natës për të cilat zgjohesh me emocione, bisedat fetare të cilat mezi i pret,

mbledhjet mes miqsh, ngurrimet që shfaqen nga frika se mos bën ndonjë gabim dhe vesveset që të vijnë duke të pëshpëritur “a e kam bërë mirë vallë?”, janë vetëm disa prej veprimeve që fillojnë të bëhen të zakonshme...

Besimi ju kaplon jetën si një re dhe ju lëshon shiun e mëshirës dhe begatisë së fillimit. Mirëpo, sprovat e vështira të jetës së përjetshme sapo kanë filluar. Në fillim, mungesa e mirëkuptimit dhe shurdhëria e pakuptimtë ju zbeh shpresat. Gjatë ditës hasni në njerëz që shpikën lloj-lloj arsyesimesh të paqena për t’ju penguar nga adhurimet. Ka prej tyre që fillojnë të të japin mend, duke thënë, “je ende i ri, është ende herët për ty”, ose nga ata që bëjnë sikur dinë gjithçka, e të thonë, “e rëndësishme është pastërtia e zemrës”.

Një pengesë tjetër, shfaqet para jush si armiqësi pa emër e pa shkak, mungesë mirëkuptimi dhe respekti... Ngarkesa që bartnit në fillim të udhës ishte e lehtë, por me zgjatjen e udhës ajo fillon e rëndohet. Mbi të gjitha, në horizont nuk duket asgjë në emër të një rezultati.

Zakonet e vjetra dhe shokët e qejfit që presin me padurim që të kthehesh përsëri midis tyre, ju shkelin syrin përçark duke u përpjekur t’ju joshin. Koha zgjatet, pesha bëhet më e rëndë dhe pengesat tërheqin njëra-tjetrën.

Pikërisht në këtë pikë, para jush dalin dy rrugë. E para, është t’i drejtoheni “profesionalizmit të fesë”, të cilën e filluat me një entuziazëm prej amatori. Ky proces fillon duke u mjaftuar me pak, duke mos e tepruar dhe duke hequr dorë prej disa gjërave. Ndërkohë që dje punonit me vullnet të fortë, sot keni filluar të hetoni edhe autoritetin e një burimi.

Sunetet e namazit të ikindisë, fillojnë të mos falen më për shkak se janë në statusin “gajri mukeed”. Tashmë keni filluar të ktheheni në një “besimtar më të hapur dhe më të relaksuar”. Festat fetare dhe Ramazanët ju japin mundësinë t’ju ktheheni përsëri kohës kur ishit më të angazhuar me jetën fetare. Mirëpo, këto janë çaste që vijnë e shkojnë si flakë kashte. Gjithçka që po përjetohet është një lloj gjendjeje ku brenda vetes është pranuar shekullarizmi me justifikimin e “mos harresës së pjesës që ke në këtë botë”, edhe pse laicizmin nuk e sheh me sy të mirë në aspektin e drejtimit të shtetit dhe të ligjeve. Por, nëse e analizojmë me kujdes Historinë e Profetëve, do të vërejmë se asnjë i Dërguari i Allahut nuk ka nxjerrë justifikime dhe nuk ka ndjekur rrugë të ndryshme në bazë të logjikës së vet. Po ashtu, shohim se si Junusi

(a.s.), i cili braktisi vendin e detyrës, Musai (a.s.), i cili u përçez në një grindje në periferi të Egjiptit dhe Nuhu (a.s.), i cili u mundua të mbronte djalën e tij mohues për shkak të dhimbjes, në momentin e fundit i janë kthyer pendimit, janë dorëzuar tek Allahu dhe fjalën e Tij e kanë mbajtur gjithmonë në plan të parë.

Ndërsa rruga e dytë, është ajo e Bilalit (r.a.), Hubejbit (r.a.), Ammarit (r.a.), etj., të cilët vazhduan ta jetonin fenë me të njëjtin entuziazëm si në ditën e parë... është një mënyrë jetese si ajo e kalifit Omer (r.a.), i cili për ta kontrolluar veten në çështjen e hipokrizisë, e thirri mënjane Hudhejfe Jemanin (r.a.) dhe i tha: “O Hudhejfe pa shikomë njëherë! Çfarë mendon për ato që bëj unë?”...

Padysim se arritja e një pjekurie e cila ka sukses



duke shtuar e jo duke pakësuar, duke u thelluar e jo duke bërë dinakëri dhe duke u rigjeneruar përditë e jo duke u vjetërsuar, është gjëja më e vështirë. E megjithatë, mermerët, të cilët gdhenden me vështirësi edhe nga mjeshtërit më të mirë, me çekiç e dalta të mprehta, gdhenden në mënyrë të mahnitshme prej pikave të ujit me përpjekjen e tyre shekullore dhe me butësinë e durimit të tyre. Pikërisht kjo është ajo që duhet të bëjmë!.. Të vazhdojmë rrugën tonë pa e prishur pastërtinë tonë të ditës së parë, pa ngecur në shkaqet dhe në përfundimet, pa u degjeneruar dhe pa u tjetërsuar... T’i dorëzohemi Krijuesit të qiejve e të tokës, Rrahmanit, Rrahimit, Vedudit, Gafurit, pa kushte dhe pa llogari, duke ruajtur të njëjtën freski si në momentin e parë dhe me një durim të pafund...

1. - Vepra që Profeti (a.s.), edhe i ka vepruar, edhe nuk i ka vepruar. Bërja e këtyre veprave ka sevap, ndërsa lënia nuk ka pasoja.

"Kush është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet singërisht Allahut, duke qenë bamirës dhe zbatues i fesë së pastër të Ibrahimit, të cilin Allahu e ka marrë për mik të ngushtë?"

(Nisa, 125)

Allahu, së pari, na tregon nëpërmjet këtij ajeti se feja e vetme autentike e pastër është feja islame dhe se besimtari më i mirë në këtë fe është ai që i dorëzohet me singëritet të plotë Allahut duke e besuar si krijuesin dhe gjykatësin e çdo gjëje në këtë botë dhe në botën tjetër dhe duke qenë vepërmirë e i singërtë në çdo veprim që kryen. Ky ajet i bën thirrje në përgjithësi gjithë njerëzimit dhe në veçanti muslimanëve që të mos mjaftohen vetëm me besimin teorik por ti dorëzohen plotësisht Allahut, të ndjekin si sistem jete rrugën e Ibrahimit që Allahu e ka vlerësuar si mikun e Tij në Kuran dhe këtë besim ta shoqërojnë me vepra duke ndërre mbikqyrjen dhe prezencën e Allahut në çdo moment. Allahu duke iu drejtuar njerëzëve me një pyetje retorike pohon se besimtar i mirë është ai që beson Allahun dhe vepron sipas normave të vendosura prej Tij duke qenë i singërtë edhe në besim edhe në vepra. Që një vepër të jetë e vlefshme tek Allahu duhet të plotësojë dy kushte: e para të jetë sipas normave të vendosura nga Allahu Teala ose i Dërguari i Tij dhe e dyta të jetë e singërtë duke iu dedikuar vetëm Allahut. Nëse vepra humb njërin nga këto kushte bëhet e pavlefshme, kur personi nuk plotëson kushtin e singëritetit quhet hipokrit kurse kur nuk plotëson kushtin e saktësisë konsiderohet i devijuar prandaj Allahu e ka cilësuar se zbatuesi i vepërës

duhet të jetë ndjekës i fesë së pastër të Ibrahimit (a.s.) të cilin Allahu e ka marrë për mik të Tijin. Kur besimtari i plotëson të dyja kushtet arrin gradën e "ihsanit" që do të thotë ta adhurosh Allahun si kur e shikon edhe nëse ti nuk e shikon atë të jesh i bindur se Ai të shiko ty.

Për besimtarët e pastër kushti më i vështirë mbetet singëriteti. Singëriteti është që çdo vepër që të bësh ta bësh vetëm për hir të Allahut dhe ta mbashë zemrën larg syfaqësisë, përfitimeve dhe interesave personale. Pejgamberi (a.s.) në një hadith thotë: *"Kush përfiton dituri jo për hirë të Allahut por për të arritur disa qëllime në këtë botë nuk do ta ndjejë aromën e xhenetit në Ditën e Gjykimit."* (Ebu Davudi) Të gjitha veprat vlersohen sipas singëritetit një vepër e vogël dhe e pa rëndësishme në dukje nëpërmjet singëritetit arrin gradat më të larta tek Allahu dhe e kundra. Singëriteti është në rolin e shpirtit për veprat, veprat nuk mund të bëjnë dot pa singëritetin. Allahu i ka urdhëruar të gjithë pejgamberët dhe popujt e tyre për që ta adhurojnë Allahun me singëritet dhe sipas mënyrës që i është komunikuar pejgamberëve: ***"E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singërtë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë."*** (Bejine, 5)

Sipas një transmetimi nga Ebu Hurejra (r.a.) Pejgamberi (a.s.) ka thënë:
"Allahu nuk shikon në formën trupore dhe fizionominë tuaj por shikon në zemrat tuaja."

Rreth transmetuesit:

Ky hadith transmetohet nga sahabiu i nderuar Abdurrahman ibn Sahr i njohur me emrin Ebu Hurejra. Ebu Hurejra e pranoi islamit në vitin e shtatë pas emigrimit të myslimanëve në Medine. Ebu Hurejra qëndronte gjithmonë pranë Profetit (a.s.) duke treguar një zell të madh për të mësuar thëniet e Tij. Është sahabiu që ka transmetuar më shumë hadithe plot 5374 hadithe profetike. Nga këto 609 gjinden edhe koleksionin e Buhariut edhe të Muslimit. Ka ndërruar jetë në moshën 78 vjeçare në Medine.

Njerëzit në përgjithësi janë të predispozuar t'i vlerësojnë njerëzit nga pamja e jashtme. Në përgjithësi njerëzit që janë të bukur, të pasur, të pushtetshëm dhe të famshëm janë më të vlerësuar në mesin e gjithë njerëzve të tjerë kurse të varfrit dhe njerëzit jo të bukur nuk i vlerësojnë. Në fakt këto

janë kritere vlerësuese për njerëzit që janë larg botës shpirtërore. Kurse Allahu Teala i vlerëson njerëzit nga veprat dhe sjelljet që burojnë nga zemrat e tyre. Kriteri kryesor dhe i vetëm për vlerësimin e njeriut është bukuria dhe pasuria shpirtërore dhe jo bukuria dhe pasuria materiale. Dhe më e rëndësishmja është kur kjo bukuria dhe pasuria shpirtërore pasqyrohet me sjellje të mira dhe ibadet të singertë. Kryerja e veprave të mirë dhe të singerta janë cilësitë e vërteta të cilat nxjerrin në pah vlerën e vërtetë të njeriut dhe e lartësojnë atë tek Allahu Teala. Duke përforcuar hadithin e mësipërm Allahu Teala thotë në Kuran: ***"As pasuria juaj, as fëmijët tuaj nuk do t'ju afrojnë më shumë te Ne, por vetëm ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira (e meritojnë këtë). Ata do të kenë shpërblim të shumëfishtë për atë që kanë bërë dhe do të jenë të sigurt në banesat e larta (në Xhenet)."*** (Sebe, 37)

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Allahu i vlerëson ibadetet dhe veprat e tjera të mira sipas qëllimit dhe singëritetit.
2. Ajo që ka vlerë dhe rëndësi tek njeriu është pasuria dhe bukuria shpirtërore.
3. Ajo që i bën të pranueshme e të vlefshme veprat është zemra. Prandaj i duhet dhënë rëndësi duke e pastruar dhe ruajtur nga ndjenjat e këqija si zilia, urrejtja etj.

Një Hadith



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- PJESA XIII -

B) SHENJAT E MËDHË

Një ditë, disa prej sahabëve po bisedonin në lidhje me një çështje. I Dërguari i Allahut, (a.s.), i pyeti se për çfarë po bisedonin dhe ata i thanë se po bisedonin në lidhje me “çështjen e Kiametit”. Për këtë arsye, Profeti (a.s.) tha:

“Pa u shfaqur dhjetë shenja, nuk do të ndodhë Kiameti:

Duhani (tymi), Dexhalli, Dabbetu’l-Ard (kafsha), lindja e diellit nga perëndimi, zbritja e Isait (a.s.), Jexhuxhët dhe Mexhuxhët, fundosja e tokës në perëndim dhe në gadishullin Arabik dhe zjarri që do të fillojë prej Jemenit e do vazhdojë deri në vendin ku do ringjallen njerëzit.” (Muslim, Fiten, 39-40; Ebu Daud, Melahim, 11; Ibn-i Maxhe, Fiten, 28.)

Dijetarët Islamë këto ndodhi i kanë përkufizuar si shenjat e mëdhë të Kiametit. Edhe pse në këtë hadith fisnik janë përmendur njëherësh dhjetë shenja të Kiametit, në lidhje me çdonjërin prej këtyre shenjave ka hadithe të ndryshme.

Informacionet në lidhje me Kiametin bëjnë pjesë në fushën e gajbit/të fshehtës. Dhe në lidhje me gajbin mund të mësojmë vetëm aq sa na kanë informuar Allahu i Madhëruar dhe i Dërguari i Tij, (a.s.). Nisur nga rëndësia e gajbit, në Kuran flitet në gjashtëdhjetë vende lidhur me këtë çështje. Në këto ajete bëhet e ditur se gajbin/të fshehtën e di vetëm Allahu i Madhëruar. Por në këtë çështje ka vetëm një përjashtim, i cili tregohet kështu në Kuranin Fisnik:

“Vetëm Ai e di të padukshmen dhe nuk ia zbulon atë askujt, përveç të dërguarve që ka zgjedhur...” (Xhinn, 26-27.)

Allahu i Madhëruar ia ka bërë të ditura edhe Profetit tonë (a.s.) informacionet në lidhje me Kiametin, Ahiretin, Xhenetin, Xhehenemin dhe shumë çështje të tjera. Ndërsa ai e ka lajmëruar ummetin e tij në lidhje me çka ka parë si të përshtatshme. Padyshim se gjithçka që i Dërguari i Allahut, (a.s.), i ka bërë të ditur ummetit të tij, lidhet me çka ka dëshiruar Allahu i Madhëruar. Në fakt, i Dërguari i Allahut,

(a.s.), ka qenë në dijeni të të vërtetave hyjnore që i tejkalojnë kufijtë e kuptimit njerëzor, e që mund të kuptohen vetëm në sajë të dritës profetike. Përveç të vërtetave të cilat i kishte për detyrë t’i kumtonte, disa informacione të tjera të veçanta ai nuk ia ka transmetuar ummetit të tij. Lidhur me këtë fakt, ai shprehet kështu në një hadith:

“Unë shoh atë që ju nuk e shihni dhe dëgjoj atë që ju nuk e dëgjoni. Qielli po kërcet! Kërcitja e tij është reale, sepse atje nuk ka as sa katër gishta vend bosh, ku të mos gjendet një melek që e ka vënë kokën në sexhde për Allahun! Për Zotin, sikur t’i dinit ato që di unë, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë, nuk do të preokupoheshit me bashkëshortet tuaja, do të dilnit nëpër rrugë dhe do t’i kërkonit ndihmë Allahut me zë të lartë...” (Tirmidhi, Zuhd, 9/2312; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 19.)

Shkaku që njeriut nuk i janë dhënë disa informacione në lidhje me vdekjen, varrin, Kiametin dhe Ahiretin, të cilat janë përtej kufijve të mendjes njerëzore, është që të mos çrregullohet sistemi i jetës njerëzore, gjë e cila është një tregues më vete i mëshirës së Allahut të Madhëruar. Nëse njeriut do t’i ishin dhënë informacione që e kapërcejnë kufirin e mendjes së tij, ai nuk do të mund t’i përballonte dot dhe do të çmendej. Ndërsa informacionet profetike dhe hyjnore që i janë dhënë njeriut në lidhje me vdekjen dhe çka përtej saj, nuk janë për të çrregulluar sistemin e jetës, por përkundrazi për ta rregulluar atë.

Njeriu është i padrejtë e i paditur dhe shpesh herë në vend që të rendë pas të vërtetave që i bëjnë dobi, vrapon pas gjërave që kur t’i mësojë do ta dëmtojnë atë. Mirëpo mosdijenja e disa çështjeve është një mëshirë hyjnore për njeriun.

Për shembull, nëse një njeri do të mësonte se pas një viti do të vdiste, atij do t’i kthehej përmbys ekuilibri i mendjes dhe i shpirtit, nuk do ta shijonte më jetën dhe në vend që të vdesë vetëm njëherë, ai do të vdiste me mijëra herë. E në fakt, njeriu i cili nuk e di se do të vdesë pas tre ditësh, bën një jetë



më të qetë dhe më të lumtur.

Fakti që përfundimi i tij dhe udhëtimi i tmerrshëm që e pret - vdekja, varri, ringjallja, llogaria, ura e Siratit, etj., janë të panjohur, bëhet shkak i një emocioni dhe shqetësimi të madh. Nëse njeriu do të meditojë me gjithë shpirt vetëm në këtë çështje, ai nuk do të hante, nuk do pinte dhe nuk do të bënte jetë normale nga të qarat dhe përgjërimet.

Në sajë të mëshirës së Allahut të Madhëruar, ne e vazhdojmë jetën tonë me pak shkujdesje dhe harresë. Kjo do të thotë se, një sasi e caktuar shkujdesjeje, konsiderohet si mirësi për rregullin e jetës njerëzore. Por nëse kjo shkujdesje i kalon kufijtë, atëherë bëhet e papranueshme. Pra, nëse bëhet jetojmë duke harruar vdekjen, llogarinë në botën tjetër dhe ndëshkimin, fundi do të jetë një katastrofë dhe dështim i përvetshëm.

Për këtë arsye, feja jonë na mëson të zotërojmë një devotshmëri që do të na sigurojë ekuilibrin shpirtëror, në sajë të të cilit do të jetojmë midis "frikës" dhe "shpresës", pra me frikën e ndëshkimit nga Allahu dhe me shpresën e arritjes së mëshirës së Tij në botën tjetër.

1. DUHAN-I / TYMI

Duhan-i është një nga shenjat e mëdha të Kiametit, prej së cilës ka marrë emrin edhe një sure e Kuranit Fisnik. Në fakt ka pasur disa kundërshtime lidhur me faktin se Duhan-i/Tymi, për të cilin ka folur i Dërguari i Allahut si një shenjë e Kiametit, është apo jo i njëjti me Duhan-in për të cilin bëhet fjalë në këtë sure të Kuranit:

"Andaj ti prite atë (ditë), kur qielli do të lëshojë tym të qartë, që do t'i mbulojë njerëzit, (e do t'u thuhet): «Ky është dënim i dhembshëm!» (Mohuesit do të thonë): «O Zoti ynë, lirona prej dënimit! Ne tashmë besojmë!» E si mund të përfitojnë ata nga këshilla, ndërkohë që më parë atyre u pat ardhur një i Dërguar me shpjegime të qarta" (Duhan, 10-13.)

Mendimi i parë:

Sipas mendimit të Abdullah ibn Mes'udit (r.a.) dhe shumicës, kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), pa se idhujtarët e Mekës i shtuan torturat ndaj myslimanëve, ai iu lut Allahut të Madhëruar që t'i ndëshkojë ata me uri dhe Allahu ia pranoi lutjen. Për rrjedhojë banorët e Mekës pësuan një zi të madhe buke. Idhujtarët e Mekës, të cilët u detyruan të hanin cofëtina dhe kocka nga kjo uri, nuk po shikonin më nga sytë dhe përreth tyre shihnin vetëm tym. Për këtë arsye, ata shkuan tek i Dërguari i Allahut, (a.s.), dhe i kërkuan që ai t'i lutej Allahut për t'i shpëtuar nga kjo fatkeqësi, duke i premtuar se nëse do të përfundonte uria, ata do t'i besonin atij.

Mirëpo idhujtarët e pagdhendur, me t'u lehtësuar prej vështirësive në sajë të lutjes së Profetit (a.s.), filluan përsëri t'i torturonin dhe ofendonin myslimanët. Sipas Abdullah ibn Mes'udit (r.a.), kuptimi i Duhan-it/Tymit, që përmendet në Kuran, është tymi që idhujtarët shikonin përreth tyre për shkak të urisë së madhe.

Ibn-i Mes'udi (r.a.) ka thënë:

Fisi i Kurejshëve u vonua të hyjë në Islam. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut, (a.s.), bëri një lutje kundër tyre dhe ata i kaploi zia e bukës, aq sa atë vit u këputën fare, hëngrën cofëtina e brejtën kocka. Ebu Sufjani erdhi tek i Dërguari i Allahut, (a.s.), dhe tha:

"O Muhammed! Ndër ato (mësimet) që ke sjellë ti, bëjnë pjesë edhe (kujdesi për) të afërmit. Mirëpo njerëzit e tu po shkatërrohen. Lutju Allahut tashmë!"

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ose Ibn-i Mes'udi (r.a.), lexuan ajetin:

*"Andaj ti prite atë (ditë), kur qielli do të lëshojë tym të qartë!.."*¹

Më vonë, Kurejshët iu kthyen përsëri mohimit të

*Duhani (tymi), Dexhalli,
Dabbetu'l-Ard (kafsha),
lindja e diellit nga
perëndimi, zbritja e Isait
(a.s.), Jexhuxhët dhe
Mexhuxhët, fundosja e
tokës në perëndim dhe në
gadishullin Arabik dhe
zjarri që do të fillojë prej
Jemenit e do vazhdojë deri
në vendin ku do ringjallen
njerëzit."*

1. -Duhan, 10.



tyre. Por ndëshkimi i kthimit të tyre, bëhet i ditur në këtë urdhër të Allahut të Madhëruar:

“Ditën, kur do t’i mbërthejmë ata me forcën më të madhe, Ne do të hakmerremi.” (Duhan, 16.)

Kjo hakmarrje u realizua ditën e Bedrit.

Një prej transmetuesve të këtij hadithi, Mansuri, shton këtë pjesë:

“I Dërguari i Allahut u lut dhe atyre iu dha shi. Ata u begatuan me shi të bollshëm shtatë ditë e shtatë net. Mirëpo kësaj here njerëzit u ankuan për shiun e shumtë. Prandaj Profeti (a.s.) u lut duke thënë: *«O Allah! Bëje shiun të bjerë përreth nesh, jo mbi ne!»* Pas kësaj retë mbi ta u hapën menjëherë dhe shiu filloi të bjerë mbi zonat përreth.”²

Këtu duhet bërë kujdes edhe në faktin se Profeti ynë (a.s.), i cili u dërgua si mëshirë për botët, nuk është lutur kurrë kundër idhujtarëve për shkak të padrejtësive që i bënin vetë atij, por për shkak se ata e përgënjeshtrojnë Islamin dhe tregoheshin kryeneçë ndaj Allahut. Prandaj edhe më pas ai lutej që fatkeqësia që binte mbi ta të merrte fund, me shpresën se ata do të nderoheshin me Islam. Pra i gjithë shqetësimi dhe dëshira e Profetit tonë (a.s.) ishte shpëtimi i përjetshëm i njerëzimit.

Mendimi i dytë:

Sipas disa sahabëve si Abdullah ibn-i Abbas dhe Abdullah ibn-i Omer (r.anhuma), ky “duhan” është “tymi” që do të mbulojë botën para Kiametit. Këtë mendim e kanë përvetësuar edhe disa mufesirë si Ibn-i Kethiri, etj.

Nisur nga kjo, në kohën kur të afrohet Kiameti, nga qielli do të zbresë një tym i cili do të mbulojë gjithë botën dhe do të vazhdojë për dyzetë ditë. Për pasojë, toka do të nxehet jashtë mase. Besimtarët do të ndikohen shumë pak nga ky tym, sikur t’i kapë një rrufë e lehtë, ndërsa mohuesit dhe hipokritët do të tronditen shumë e do të bëhen si të dehur.³

2. DEXHALLI

“Dexhall” do të thotë gënjeshtar, hileqar, dikush që e përzien të vërtetën me gënjeshtër, të mirë me të keqen, mashtrues, etj. Lidhur me Dexhallin në Kuran nuk gjendet ndonjë informacion. Por nga hadithet e Profetit tonë (a.s.) mësojmë se ai është një mashtrues e gënjeshtar i madh që do të shfaqet në kohën afër Kiametit dhe në sajë të disa aftësive dhe mundësive që i ka dhënë Allahu, dhe do të bëjë disa gjëra të jashtëzakonshme. Në këtë mënyrë, ai do t’i devijojë disa njerëz nga e vërteta.

Neuwas ibn-i Sem’an (r.a.) tregon:

Një mëngjes, i Dërguari i Allahut, (a.s.), foli gjatë e gjerë në lidhje me Dexhallin. Në fund u lodh dhe e uli zërin. Më pas filloi të flasë përsëri me zë të lartë. Duke u nisur nga mënyra se si e tregonte, ne kujtuam se Dexhalli kishte ardhur deri tek hurmat përreth Medinës. Kur shkua përsëri tek Profeti (a.s.), ai e kuptoi hidhërimin tonë dhe pyeti:

“Si është puna?”

Ndërsa ne i thamë:

“O i Dërguar i Allahut! Në mëngjes folët për Dexhallin. Por për shkak se ju flisnit herë me zë të lartë, e herë me zë të ulët, ne pandehëm se Dexhalli ka ardhur deri tek hurmat.”

I Dërguari i Allahut (a.s.) sqaroi:

“Frikësohem për ju në lidhje me Dexhallin, më tepër se prej çdo gjëje. Nëse Dexhalli del kur jam ende në mesin tuaj, unë do t’ia prish lojën dhe do t’ia shkatërroj argumentet (e rreme). Nëse ai del pasi të jem larguar prej mesit tuaj, atëherë gjithsecili duhet ta ruajë veten prej tij. Në fakt, Allahu i Madhëruar do t’i ruajë besimtarët prej tij.

Dexhalli do të ketë flokë kaçurrela, njërin sy të verbuar dhe do t’i ngajë Abduluzza ibn Katanit (i cili ka vdekur në kohën e injorancës). O robër të Allahut, ruajeni besimin tuaj dhe rezistoni!” Ne pyetëm:

“O i Dërguar i Allahut! Sa kohë do të qëndrojë Dexhalli në tokë?”

Ai tha:

“Dyzet ditë! Një ditë do të jetë sa një vit, një ditë tjetër sa një muaj, një ditë tjetër sa një javë, ndërsa

2. Buhari, Istiska, 13, Tefsir, 30, 44/2. Shih. Muslim, Munafikin, 39, 40; Ahmed, I, 431, 441.

3. shih. Metin Yurdagur, “Duhan”, Diyanet Islam Ansiklopedisi, IX, 547.



ditët e tjera sa ditët që i dini edhe ju.”

Ne pyetëm përsëri:

“O i Dërguar i Allahut! A do të mjaftojnë namazet e një dite, kur ajo të jetë sa një vit?”

“Jo, ju do t’i llogaritni dhe do t’i caktoni namazet sipas asaj dite!” -tha ai.

“O i Dërguar i Allahut! Sa do të jetë shpejtësia e tij në tokë?”-pyetëm ne përsëri.

Ndërsa Profeti (a.s.) u përgjigj:

“Ai kalon pranë njerëzve si reja që e shtyn era. Ai u thotë njerëzve se është zot, duke kërkuar që ata t’i besojnë, e ata i besojnë. Ai e urdhëron qiellin të lëshojë shi dhe ai lëshon shi. E urdhëron tokën të mbijë bimë, e ajo mbin bar e livadhe. Ndërsa kafshët, që njerëzit i kanë lëshuar të kullotin, kthehen më të pashme, më të shëndosha e me më shumë qumësht.

Pastaj shkon tek disa njerëz të tjerë dhe i fton t’i besojnë atij. Mirëpo ata nuk i besojnë dhe ia refuzojnë kërkesën. Ai largohet prej tyre. Por në mëngjes, uji i tyre shterohet, livadhet dhe bari thahen e kafshët iu ngordhin.

Dexhalli shkon tek disa rrënoja dhe thotë: «Nxirri në shesh thesaret e tua!». Pastaj thesaret e rrënojave shkojnë pas Dexhallit si bletët pas mbretëreshës së tyre.

Më pas Dexhalli thërret një djalosh trim dhe e ndan atë më dysh me shpatë. Pjesët e trupit të tij bien njëra në një anë, e njëra në anë tjetër. Pastaj e thërret atë dhe djaloshi kthehet tek ai me fytyrë të qeshur.

Ndërkohë që Dexhalli vazhdon me këto punë, Allahu i Madhëruar dërgon Mesihun, birin e Merjemes (a.s.).

Mesihu do të zbresë pranë minares së bardhë në lindje të Damaskut, i veshur me dy rroba me ngjyra dhe i mbështetur me duar mbi krahët e dy melekëve. Kur Mesihu e ul kokën poshtë me fytyrën që i shkëlqen, nga flokët e tij pikojnë djersë, e kur e ngre kokën prej tij rrjedhin pika të ndritshme si perla. Mohuesit që ndjejnë aromën e frymës së tij vdesin menjëherë. E fryma e tij arrin menjëherë aty ku ai sheh.

Mesihu i vihet pas Dexhallit, e kap dhe e vret atë në Babulud (në afërsi të Kudsit/Jerusalem). Më pas Isai (a.s.) shkon tek disa njerëz, të cilët Allahu i Madhëruar i ka ruajtur prej të keqes së Dexhallit, dhe duke ua ledhatuar fytyrat u thotë atyre se fitnja e Dexhallit mori fund dhe se ata i presin grada të larta në Xhenet...” (Muslim, Fiten, 110.)⁴

Padyshim se fitneja e Dexhallit do të jetë më e madhja që biri i njeriut do të shohë mbi tokë. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), shprehet:

“Prej kur është krijuar Ademi (a.s.) e deri në ditën kur do të bëhet Kiameti, nuk do të ketë asnjë fitne më të madhe se Dexhalli.” (Muslim, Fiten, 126.)⁵

Për këtë arsye, të gjithë profetët u kanë folur popujve të tyre dhe i kanë paralajmëruar ata në lidhje me këtë fitne.⁶ Po kështu edhe Profeti ynë (a.s.) ka kërkuar strehim tek Allahut prej fitnes së Dexhallit. Ai na ka porositur edhe ne që të bëjmë të njëjtën gjë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), na ka lajmëruar se para daljes së Dexhallit të vërtetë, prej ummetit të tij “do të dalin rreth tridhjetë dexhallë të rremë”, të cilët do ta prezantojnë veten e tyre si profetë, duke u thënë njerëzve: “Unë jam i dërguari i Allahut!”⁷ Dhe me të vërtetë që, gjatë gjithë historisë kanë dalë shumë mashtrues me cilësi të tilla, të cilët Allahu i Madhëruar i ka shkatërruar. Padyshim se edhe Dexhalli i vërtetë do të pësojë të njëjtin përfundim.

Rib’ij ibn Hirash (r.a.) transmeton:

Së bashku me Ebu Mes’ud el-Ensariun (r.a) shkuaam tek Hudhejfete ibn Jemani (r.a.). Ebu Mes’udi i tha atij:

“Më trego çfarë ke dëgjuar prej të Dërguarit të Allahut, (a.s.), për Dexhallin?”

Hudhejfete (r.a.) tha:

“Dexhalli do të dalë me të vërtetë dhe me vete do të ketë ujë dhe zjarr. Sa i përket asaj që (disa nga) njerëzit e shohin si ujë, në të vërtetë ai është zjarr

4. shih. Tirmidhi, Fiten, 59; Ibn-i Maxhe, Fiten, 33.

5. shih. Ahmed ibn-i Hanbel, Musned, IV, 19-21.

6. shih. Tirmidhi, Zuhd, 3; Ibn-i Maxhe, Fiten, 33.

7. shih. Buhari, Fiten, 25; Muslim, Fiten, 84.

që digjet. E sa i përket asaj që njerëzit e shohin si zjarr, në të vërtetë ai është ujë i ftohtë e i pijshëm. Kush nga ju e arrin (Dexhallin), le të qëndrojë në anën e atij që njerëzit e shohin si zjarr, sepse ai do të jetë ujë i ëmbël, i ftohtë, e i pijshëm.” (Buhari, Enbija, 50, Fiten, 26; Muslim, Fiten, 105, 108.)

Sipas një transmetimi që përmendet në Sahihun e Muslimit, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Unë e di shumë mirë se çfarë ka me vete Dexhalli. Ai ka dy lumenj. Njëri duket i bardhë si ujë, e tjetri si zjarr që digjet. Nëse dikush e arrin Dexhallin, le të shkojë tek lumi që i ngjan zjarrit e të mbyllë sytë. Më pas të ulë kokën e të pijë prej tij, sepse ai është ujë i ftohtë.”

Ndërsa në transmetime të tjera thuhet se: *“Dexhalli do të ketë me vete dy gjëra që ngajjnë me Xhenetin dhe Xhehenemin. Çka quan Xhenet, në të vërtetë është zjarr, pra Xhehenem.”* (shih. Muslim, Fiten, 109.)

Allahu i Madhëruar, i Cili zjarrin si një mal të Nemrudit e ktheu në kopsht trëndafilash për Ibrahimin (a.s.), do ta kthejë në ujë të freskët e të pijshëm edhe zjarrin e rremë të Dexhallit mashtroes, për njerëzit me besim të fortë që nuk mashtrohen prej tij. Pra zjarri i tij nuk do t'i dëmtojë aspak besimtarët e vërtetë.

Padyshim se Dexhalli është një sprovë shumë e madhe, të cilit i janë dhënë mundësi të jashtëzakonshme për të sprovuar njerëzit, me qëllim që të dallohet qartë besimtari i vërtetë nga ai i rremë. Nisur nga kjo, besimtarët e vërtetë duhet ta përgënjeshtrojnë Dexhallin dhe nuk duhet të kenë frikë prej zjarrit që ai sjell me vete, sepse në të vërtetë ai nuk është zjarr por mëshirë, nuk është Xhehenem, por Xhenet.⁸

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Nuk do të mbetet asnjë vend pa u shkelur nga Dexhalli, përveç Mekës dhe Medinës. Melekët do të rreshtohen në të gjitha rrugët e Mekës dhe Medinës dhe do t'i mbrojnë këto dy qytete. Dexhalli do të zbresë në një vend ranor e të shkrete. Më pas, Medina do të lëkundet tre herë dhe Allahu i Madhëruar do të nxjerrë jashtë saj mohuesit dhe hipokritët.” (Muslim, Fiten, 126.)⁹

Këtu lajmërohem se Dexhalli do të shkelë të gjitha vendet dhe zonat e banuara në tokë, përveç

Mekës dhe Medinës. Të gjithë njerëzit do të kalojnë një sprovë shumë të madhe. Allahu i Madhëruar do ta mbrojë prej Dexhallit zonën e haremit, pra dy qytetet e shenjta, Mekën dhe Medinën, si dhe myslimanët e singertë që nuk do t'i braktisin këto dy qytete.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“70 mijë persona me tajlasan,¹⁰ prej hebrenjve të Isfahanit, do t'i shkojnë pas Dexhallit.” (Muslim, Fiten, 124.)

Midis atyre, që e besojnë dhe e vlerësojnë Dexhallin, janë edhe hebrenjtë. Ashtu siç do të shkelë në çdo vend të botës, Dexhalli do të shkojë edhe në Isfahan. Aty do të mbështetet prej 70 mijë personave me tajlasan, të cilët do të jenë hebrenj.

Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte në mes të një grupi, ndër të cilët gjendej edhe Ummu Sherik. Duke folur në lidhje me Dexhallin, mes të tjerash tha:

“Njerëzit do të ikin prej Dexhallit e do të strehohen në male.” Mirëpo, fakti që edhe luftëtarët trima të Islamit nuk do t'i bëjnë ballë Dexhallit e do të ikin prej tij, e hidhëroi thellësisht Ummu Sheriken. Për këtë arsye, ajo pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! Ku do të jenë arabët atë ditë?”

Profeti (a.s.) tha:

“Ata do të jenë shumë pak atë ditë.”

Me këtë ai deshi të thotë se ata nuk do ta përballojnë dot Dexhallin, prandaj do të ikin me qëllim që të shpëtojnë prej fitnes dhe së keqes së tij. (Muslim, Fiten, 125.)¹¹

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Nxitoni në punë të mira pa ardhur këto shtatë gjëra. Apo mos vallë po prisni:

1. Varfërinë që të bën të harrosh (adhurimin dhe kufijtë e hallallit e haramit),
2. Pasurinë që të tërbon,
3. Sëmundjen që të shkatërro,
4. Pleqërinë që të dobëson mendjen e të bën të flasësh përçart,
5. Vdekjen që të vjen papritur,
6. Fitnen më të keqe që pritët të vijë, Dexhallin,
7. Dhe Kiametin

E Kiameti është katastrofa më e jashtëzakonshme dhe më e dhimbshme.” (Tirmidhi, Zuhd, 3/2306.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kur të shfaqet Dexhalli, një prej besimtarëve do të shkojë drejt vendit ku ndodhet ai. Mirëpo, njerëzit e armatosur të Dexhallit do t'i dalin para dhe do

8. Këtu duhet të theksojmë se ashtu siç është Kiameti një ndodhi e jashtëzakonshme për të gjithë botën, është e natyrshme që edhe shenjat që e paralajmërojnë atë të kenë aspektet e tyre të jashtëzakonshme. Për rrjedhojë, nuk duhet të habitemi nga fakti se në kohën pranë Kiametit do të shfaqen disa fenomene që janë jashtë imagjinatës dhe botëkuptimit tonë. Për shembull, sot shihet qartë se shkenca dhe teknologjia kanë arritur gjëra që para 40 apo 50 vitesh as që mund të mendoheshin. Kështu, edhe shenjat e Kiametit për të cilat lajmërohem në Kuran dhe hadithe, do të realizohen kur të vijë koha e caktuar, sepse për Allahun e Madhëruar nuk ekziston asnjë vështirësi.

9. shih. Buhari, Fedailu'l-Medine, 9, 26, 27, Teuhid, 31; Ibn-i Maxhe, Fiten, 33.

10. Tajlasan: Pjesa e shallit që rrethohet si çallmë pas kokës dhe që varet pas si bisht

11. Shih. Tirmidhi, Menakib, 69; Ibn-i Maxhe, Fiten, 33.

ta pyesin:

«Ku kërkon të shkosh?»

«Tek ai personi që ka dalë (rishtazi)!» -thotë besimtari.

Njerëzit e Dexhallit thonë:

«A nuk i beson ti zotit tonë?»

«Zoti ynë nuk ka ndonjë anë të fshehtë, që ne ta braktisim. Atë e t'i besojmë diku tjetri.» -thotë besimtari.

Pastaj disa prej njerëzve të Dexhallit do të urdhërojnë:

«Vriteni!»

Ndërsa një pjesë tjetër prej tyre do të thonë:

«A nuk ua ka ndaluar zoti jua vrasjen pa dijeninë e tij!»

Më pas do ta marrin besimtarin dhe do ta çojnë tek Dexhalli. Kur besimtari do shohë Dexhallin, do thërrasë besimtarët e tjerë:

«O besimtarë! Ky person është Dexhalli për të cilin ka folur i Dërguari i Allahut, (a.s.)!» Atëherë, Dexhalli do t'iu drejtohet njerëzve të vet e do t'iu thotë:

«Rriheni mirë këtë njeri!»

Sapo ata ta kapin për ta rrahur, Dexhalli do t'iu thotë:

«Kapeni dhe çajani kokën!»

Pasi e rrahin fort duke e goditur në shpinë e në bark, Dexhalli do ta pyes:

«A nuk më beson mua?»

«Ti je Mesihu i rremë!» -do t'iu thotë besimtari.¹²

Më pas, me urdhrin e Dexhallit ata do e presin besimtarin më dysh me sharrë nga koka tek këmbët. Pasi Dexhalli do kalojë përmes trupit të besimtarit, të ndarë në dy pjesë, do të urdhërojë:

«Ngrihu në këmbë!»

12. Ashtu siç njihet Isai (a.s.), si Mesihu, ashtu edhe Dexhallit i thonë Mesih (Mesihu'd-Dexhah). Fjala Mesih ka kuptimin "të fshih" dhe rrjedh prej fjalës "mes'h". Fakti që Dexhalli përmendet me këtë emër, është për shkak se mirësia do të fshihet e do të merret prej tij, ose për shkak se një anë e fytyrës së tij bashkë me syrin është e rrafshët (si e fshirë). (shih. Buhari, Ta'bir, 11, 33.) Thuhet se Dexhalli përmendet si Mesih, edhe për shkak se ai udhëton shumë dhe fshin çdo distancë. Ndërsa Isai (a.s.), quhet Mesih për shkak se ai i shëron njerëzit e sëmurë duke i fërkuar (fshirë) me dorën e tij të bekuar. Pra, sa kuptimplotë është fakti se Allahu do ta fshijë një Mesih me një Mesih tjetër. Kurani shprehet qartë se të gjitha besimet e kota dhe besëtytnitë, përfshi këtu edhe Dexhallin, do të eliminohen e do zduken: "Por Ne e godasim të pavërtetën, me të vërtetën, e cila e shkatërron atë dhe ajo zduket!.." (Enbija, 18.)

E ai do të drejtohet dhe do të ngrihet. Dexhalli do ta pyes përsëri:

«A më beson?»

Besimtari do të thotë:

«Mendimi im në lidhje me ty vetëm se u përforcua!».

Më pas do të kthehet nga populli dhe do të thotë:

«O njerëz! Pas meje, ai nuk do të mund të vrasë dhe të ringjallë më askënd!»

Dexhalli do të tentojë ta therë personin në fjalë. Mirëpo Allahu i Madhëruar do ta shndërrojë në bakër besimatrën, prej fytyrës deri në klavikul. Për këtë arsye Dexhalli do ta ketë të pamundur therjen.

Pas kësaj, Dexhalli do ta kapë atë nga duart e këmbët dhe do ta hedhë diku. Njerëzit do të mendojnë se ai e hodhi në Xhehenem, por ai është hedhur në Xhenet."

I Dërguari i Allahut, (a.s.), shtoi:

"Ja pra, për Zotin e botëve, ky besimtar është shehidi/dëshmori më i rëndësishëm ndër të gjithë njerëzit!" (Muslim, Fiten, 113.)¹³

Ka mendime se ky besimtar që e njihte mirë Dexhallin, hilet dhe mashtrimet e tij, mund të ketë qenë Hidri. Fakti që ky besimtar thotë: "Zoti ynë nuk ka ndonjë anë të fshehtë, që ne ta lëmë Atë, e t'i besojmë diku tjetri.", tregon se besimtarët e njohin Allahun e Madhëruar me të gjitha cilësitë e Tij, nuk dyshojnë kurrë në lidhje me ekzistencën, njëshmërinë dhe fuqinë e Tij dhe besojnë në mënyrë absolute se Ai është i përsosur dhe pa të meta.

Ngjarja tregon qartë se sa e rëndësishme është që zemrat të mbushen me frymëzimin e njohjes së Allahut, për t'i bërë ballë fitneve dhe rreziqeve shpirtërore. Edhe guximi i besimtarit, i cili qëndroi me trimëri përballë Dexhallit me besimin dhe diturinë e tij, tregon se sa e dobishme dhe e nevojshme është për një besimtar marrja e njohurive të Kuranit dhe Sunnetit në lidhje me fitnet e fundkohës dhe Kiametin. Njëkohësisht, ky hadith fënisht na bën të ditur se fitnja e Dexhallit do të marrë fund shumë shpejt pas daljes së tij. Prandaj detyra e besimtarëve, që do të sprovohen me këtë fitne, është kapja fort pas besimit dhe rezistenca përballë Dexhallit me guximin e besimit, pa u kapluar nga dobësia dhe frika.

13. shih. Buhari, Fiten, 27.



EL-MUKIT

KRIJUESI I FRUNIZIMIT PËR ÇDO KRIJESË

— Ilir Hoxha —

Në fjalor, emri Mukit ka dy kuptime: Mbrojtës që ushqen dhe i Gjithëpushtetshëm... Ragib el-Isfahani preferon më tepër kuptimin “mbrojtës që ushqen”, sepse sipas tij, t’i japësh diku ushqimin me të cilin do të vazhdojë jetën, do të thotë ta ruash dhe ta mbash gjallë atë. Po ashtu, mbrojtja dhe ushqyerja padyshim që arrihen me fuqi. Pra, nëse e shohim nga ky këndvështrim, vërejmë se marrëdhënia e këtyre kuptimeve është e qartë. Në ajetin 85 të sures Nisa, i cili është vendi i vetëm ku përmendet ky emër, urdhërohet: **“Kush ndërmjetëson për një çështje të mirë, do të ketë pjesë në shpërblimin e saj, kurse kush ndërmjetëson për një çështje të keqe, do të ketë pjesë në ndëshkimin e saj. Allahu është i Gjithëpushtetshëm.”**

Edhe pse shumica e komentuesve të Kur’anit e kanë interpretuar emrin Mukit në kuptimin i Gjithëpushtetshëm, Elmallëllë, i cili ka marrë për bazë formën në të cilën ka ardhur ajeti, shprehet se, “Allahu është i Gjithëpushtetshëm për gjithçka dhe kujdeset ashtu siç duhet për çdo gjë”. Më pas ai tërheq vëmendjen në lidhjen që kanë me njëra-tjetrën dy kuptimet, duke thënë se, “Allahu i jep pjesë të mirit prej të mirës dhe të keqit prej së keqes që është bërë për shkak të tyre në masën e merituar”. Pra, kush hap rrugën e një të mire, i jep po aq mirësi, e kush hap rrugën e një të keqeje, i jep po aq të këqija.

Dijetarët që i kanë studiuar Emrat e Bukur të

Allahut, duket u mbështetur në këto kuptime dhe të tjera të ngjashme, janë të mendimit se ky emër më tepër nënkupton “furnizimin me ushqimin e nevojshëm të shpirtit dhe trupit”. Ndërsa në disa hadithe, emri Mukit është përdorur në kuptimin, “Ai që furnizon dhe ushqen”. Bazuar në këto hadithe, emri Mukit ka kuptimin e Rezzak-ut (Furnizuesit). Mirëpo, ne e dimë se ndër Emrat e Bukur të Allahut nuk gjendet asnjë emër me kuptim të njëjtë me një emër tjetër. Duke u nisur nga kjo, dijetarët kanë thënë se përkundër gjithëpërfshirësisë së emrit Rezzak, emri Mukit është më specifik. Sipas tyre, ndërkohë që emri Rezzak përkufizon plotësimin e të gjitha nevojave materiale, qofshin këto ushqimore apo jo, emri Mukit na bën të ditur se Zoti ynë na furnizon me nevojat materiale dhe shpirtërore.

Zoti i Botëve e ka krijuar rregullin e gjithësisë në mënyrë që t’i shërbejë vazhdimësisë së jetës dhe po ashtu ka krijuar edhe furnizimin në sasi të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të çdo krijese derisa të ketë jetë: **“Ai krijoi në Tokë male të palëvizshme që ngrihen lart, e bekoj atë dhe përcaktoi në të furnizimin (për banorët) e saj me masë për katër ditë; ky është shpjegimi për të gjithë ata që pyesin.”** (Fussilet, 10.) Fuqia që ka krijuar gjithësinë, ka ndërtuar një sistem të atillë, saqë çdo krijesë, që prej mikroorganizmat e deri tek trupat më të mëdhenj qiellorë, janë të lidhur dhe mbështesin ekzistencën e njëri-tjetrit. Për sa kohë që ky sistem nuk prishet

nga ndonjë ndërhyrje të jashtme, çdo krijesë është përcaktuar të jetë furnizimi i një tjetre dhe asnjë prej tyre nuk është krijuar kot.


Njeriut i është dhënë aftësia për të përballuar çdo nevojë. Po ashtu janë krijuar edhe të gjitha elementet me të cilat njeriu do të plotësojë këto nevoja. Madje, sikur të mos mjaftonin këto, gjithësia është zbuluar me finesë dhe elegancë të pasqorë duke pasur parasysh edhe shijet shpirtërore të njeriut. Çdo fazë e përfundimit të ushqimeve që do të jenë furnizimi i trupave tanë, është krijuar në mënyrë që t'i japë njeriut kënaqësi shpirtërore, duke i dhënë atij mundësinë edhe të arrijë mirësitë, por edhe të ndjejë kënaqësi prej tyre. Dhe pikërisht në këtë pikë, komentuesi i Emrave të Bukur të Allahut, Ali Osman Tatlisu, thotë: *"Allahu ka krijuar shkaqet e jetesës për njeriun dhe të gjithë i ka bërë përgjegjës të kapen pas një shkaku për të siguruar jetesën. Mirëpo, është kusht që këto shkaqe të jenë brenda rregullave të hallallit. Shkaqet nuk e krijojnë dhe nuk e ndajnë furnizimin. Allahu është Ai që edhe e krijon edhe e ndan furnizimin. Shkaqet nuk janë gjë tjetër veçse mënyra. Nëse shkaqet do t'i jepnin furnizimin njeriut, mendja, që është shkaku më i fuqishëm për të arritur fitime, do t'i bënte të mençurit njerëzit më të pasur, ndërsa më pak të mençurit, më të varfër. Mirëpo, në fakt ka shumë njerëz jo fort të mençur që gëzojnë pasuri të mëdha dhe shumë njerëz të mençur që janë të privuar prej mirësive."* Për rrjedhojë, njeriu që e arrin njëherë këtë lloj botëkuptimi, shpëton nga paniku dhe shqetësimi në lidhje me rizikun.

Sipas imam Kushejrit, ky emër tregon se Allahu i Madhëruar nuk mjaftohet vetëm me krijimin e çdo gjëje, por edhe me krijimin e ushqimeve për të cilat ato kanë nevojë. Po sipas tij, ushqimi i njerëzve dhe gjallesave të tjera, është materiali, ushqim i melekeve është bindja dhe madhërimi i Zotit, ndërsa ushqimi i shpirtit është dija dhe të kuptuarit e objekteve dhe ndodhive. Njeriu që shqetësohet vetëm për ushqimin dhe pijen, e nuk interesohet aspak për

natyrën e krijesave të tjera, nuk arrin ta vlerësojë urtësinë që ndodhet pas gjithçkaje, gjë e cila do të thotë se ai nuk e kërkon ushqimin e shpirtit, por e lë atë të uritur e të etur. Dija dhe urtësia e pasuron dhe e bën me krahë shpirtin. Ndërsa privimi prej tyre e dobëson dhe e verbon atë.

Lidhur me këtë temë, një nga pikat të cilës mistikët i japin shumë rëndësi, është edhe ndikimi i ushqimeve tek karakteri ynë. Sipas tyre, është kusht që kafshata dhe veshmbathja të jenë hallall, sepse me kafshatë haram nuk mund të ndriçohet shpirti, ndërsa me veshje haram nuk mund të arrihet kënaqësi në adhurime. Që ndjenjat, mendimet dhe sjelljet të jenë të pastra, është kusht që edhe ushqimi të jetë i pastër, qoftë në aspektin material, qoftë edhe në atë shpirtëror. Kur'ani Fisnik i jep shumë rëndësi kësaj teme dhe thekson fort se, përveçse duhet të jetë hallall, kafshata duhet të jetë edhe e pastër. (shih. Bekare, 168, 172; Maide, 88; Araf, 160; Enfal, 69; Nahl, 114; Isra, 70; TaHa, 81.) Nisur nga kjo, ata që nuk kujdesen siç duhet për shëndetin e njerëzve dhe kushtet e higjienës gjatë prodhimit të ushqimeve, veprojnë në kundërshtim me Kur'anin Fisnik. Pra, ai që përpiqet të sigurojë furnizimin e familjes së tij, duhet të bëjë kujdes që ai të jetë hallall, ndërsa ata që e përgatisin, duhet të bëjnë kujdes që të jetë i pastër dhe brenda kushteve të higjienës.

Njerëzit tek të cilët manifestohet morali i emrit hyjnor el-Mukit, janë persona të cilët bëhen shkak që furnizimi i Allahut të arrijë tek të tjerët. Këta njerëz që kanë nderin të jenë krijesa tek të cilët manifestohen emrat Rezak dhe Mukit të Allahut, kur e marrin dikë në punë, i japin atij një pagesë të mjaftueshme që ai të sigurojë jetesën e familjes së tij. Nëse në një shoqëri njerëzit nuk arrijnë ta sigurojnë jetesën e tyre edhe pse punojnë, do të thotë se sistemi mizor i krijuar nga njeriu në atë vend, e ka prishur sistemin që ka krijuar Allahu. E në fakt, uria nuk lind prej pamjaftueshmërisë së mirësive, por prej pangopësisë së njerëzve.



Çelësi i suksesit VËLLAZËRIA ISLAME

— Doç. dr. Mustafa Karabaxhak —

Një nga urdhrat bazë të Islamit është që myslimanët ta shohin njëri-tjetrin si vëllezër dhe të bëjnë atë që kërkon vëllazëria. ***“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër!..”***¹ Pra, besimtarët nuk janë gjë tjetër përveçse vëllezër dhe për rrjedhojë, duhet të sillen si vëllezër me njëri-tjetrin. Ndërsa Profeti (a.s.), ka thënë: “Nuk do të keni besuar (plotësisht), pa dëshiruar për vëllain tuaj atë që dëshironi për veten!”² Po ashtu, në një hadith tjetër Profeti (a.s.), shprehet: “Betohem në Allahun që e ka në dorë jetën time se, nëse nuk besoni, nuk do të hyni në Xhenet dhe pa e dashur njëri-tjetrin nuk do të besoni.”³

Allahu i madhëruar e përcakton në këtë mënyrë qëndrimin e myslimanëve ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj mohuesve të fesë: ***“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre...”***⁴ Ndërsa Rasulullahu (a.s.), qëndrimin e besimtarëve ndaj njëri-tjetrit, e përshkruan në këtë mënyrë: “Besimtarët në dashuri, në mëshirë dhe në dhembshuri ndaj njëri-tjetrit, janë si shembulli i trupit, i cili kur i shqetësohet një prej organeve, edhe organet e tjera ndjejnë shqetësim dhe temperaturë.”⁵

Nuk duhet të ndahesh kurrë prej xhematit

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit,

ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj!..”⁶

Profeti ynë (a.s.), personin që ndahet prej xhematit, e ka konsideruar sikur të ketë dalë prej Islamit: “Kush ndahet një pëllëmbë prej xhematit islam, është sikur ta ketë hequr e ta ketë hedhur veshjen islame.”⁷ “Kush ndahet qoftë edhe një pëllëmbë prej xhematit, është ndarë prej Islamit.”⁸ “Kush ndahet prej xhematit dhe nuk pranon të bindet, ai do të takohet me Allahun pa pasur asnjë vlerë tek Ai.”⁹

NDIHMA E ALLAHUT ËSHTË NË XHEMAT

Është e domosdoshme të ruhesh prej çdo veprimi që do ta shkatërronte unitetin dhe bashkimin. Dihet se herë pas here, në mënyrë të veçantë të rinjtë, bëhen pjesë e grupeve dhe rrymave të gabuara. Me qëllim që të rinjtë të mos anojnë nga grupet dhe rrymat e gabuara, është e domosdoshme që atyre t’u jepet një edukim i mirë fetar. Në këtë pikë, një detyrë e rëndësishme bie mbi prindërit. Nëse i shohim të rinjtë e mashtruar, vërejmë se atyre u mungon një edukim i mirëfillt fetar. Madje, disa nuk ia kanë fare haberin fesë. E disa të tjerë nuk dinë më tepër se disa gjëra që i kanë mësuar përmendsh.

Një gjë është e vërtetë, se pa i njohur mirë dijet në lidhje me Kuranin, nuk mund ta kuptosh atë siç duhet. Botëkuptimi i fesë tek njerëzit e tillë, i ngjan përshkrimit të elefantit në errësirë. U morën disa të verbër dhe iu kërkua të përshkruanin elefantin duke e prekur. Ai që e prekte elefantin nga këmbët,

e përngjante me shtyllat, ai që e prekte nga veshët, thoshte se i ngjan gjetheve të palmës dhe ai që e prekte prej feçke, thoshte se i ngjan zorrës. Në të vërtetë, asgjë nuk mund të përshkruhet e plotë, nëse njeh vetëm një pjesë të saj.

Për rrjedhojë, këta të mjerë me mendje të cekët që e kuptojnë Islamin vetëm për të vrarë, nuk arrijnë ta kuptojnë kurrë se sa e çmuar është t'i shpëtosh jetën një njeriu: ***“Prandaj Ne i urdhëruam bijtë e Izraelit se kush vret ndokënd, që s'ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve...”***¹⁰

Këtyre njerëzve që nuk kanë mundësi të lexojnë qoftë edhe një libër që tregon jetën e Profetit (a.s.), duhet t'u kujtojmë edhe faktin historik se: Gjatë luftërave që u zhvilluan nga shteti islam, i cili u zgjerua me tre milion metër katrorë vetëm dhjetë vite pas vdekjes së Profetit (a.s.), numri i myslimanëve të rënë në luftë, ishte rreth 150, ndërsa numri i të vrarëve në radhët e armikut, nuk i kalonte 250.¹¹

U duhet kujtuar edhe se Resulullahu (a.s.), shkonte për ngushëllim kur vdiste ndonjë jomysliman, i gostiste ata dhe e pranonte gostitjen e tyre, sillej me respekt ndaj tyre dhe madje kur në rrugë kalonte ndonjë kortezh mortor, ai ngrihej në këmbë dhe, kur e pyesnin për shkakun e kësaj, ai përgjigjej: “A nuk është edhe ai njeri?!”

Nëse shohim sot botën islame, vërejmë se aty rrjedh vetëm gjak e lot dhe padrejtësitë s'kanë të sosur. Numri i myslimanëve që vdesin sot në një ditë të vetme, është shumë më tepër se numri i myslimanëve që vdiqën në të gjitha luftërat gjatë jetës së Profetit (a.s.). Kjo, sepse ndërmjet luftërave të Profetit (a.s.) dhe luftërave të sotme nuk ka asgjë të përbashkët veç emrit dhe mbi të gjitha sot luftojnë vëllezërit e fesë me njëri-tjetrin. Edhe ai që vritet, edhe ai që vret janë njerëz të mjerë e të mashtuar që besojnë të njëjtat vlera. Sipas të dhënave zyrtare, në luftërat që janë zhvilluar midis viteve 1979-2010, janë vrarë 11 milion myslimanë dhe janë gjymtuar rreth 60 milionë të tjerë. Ndërmjet viteve 1990-2009, në botën islame janë vrarë 34.906 punonjës shteti, 127.000 biznesmenë dhe 2.411 lider.

Shumica e këtyre vrasjeve ka ndodhur prej dorës së vëllezërve të fesë. Edhe i vrari pretendon se ka vdekur në emër të Allahut, edhe vrasësi pretendon se ka vrarë në emër të Allahut. Mirëpo, Profeti ynë (a.s.), ka thënë: “Nëse dy myslimanë ngrenë shpatat kundër njëri-tjetrit, edhe i vrari, edhe vrasësi janë në Xhehenem.”¹² Ndërsa Allahu i Madhëruar, urdhëron: ***“...Mos t'ju nxisë urrejtja ndaj disa njerëzve, që ju penguan të vizitoni Qabenë, pra, kursesi të mos ju nxisë që t'i sulmoni! Ndihmoheni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi!”***¹³

Megjithëse besimtarët në të katër anët e botës

luten për bashkimin e myslimanëve dhe ndalimin e gjakut, ende nuk është gjetur një zgjidhje, sepse lutjet po bëhen vetëm me gojë dhe nuk po vihen në jetë. Mbi të gjitha, çdo mysliman i bie çanakut më vete dhe të gjithë po garojnë me njëri-tjetrin në smirë, intolerancë, zili, mendjemadhësi dhe përçmim.

Njëherë, Profeti ynë (a.s.), tha: “Umetit tim do t'i ngjiten sëmundjet e umeteve (të mëhershme)”. Kur sahabët e pyetën: “Cilat do të jenë sëmundjet e umetit?”, ai u përgjigj: “Teprimi, lazdrimi, mburrja dhe garimi me njëri-tjetrin në lidhje me këtë botë, largimi ndaj njëri-tjetrit dhe smira. Kështu që do të shfaqen padrejtësitë dhe anarkia.”¹⁴ Mirëpo, Allahu ndihmon grupet që janë të bashkuar. “Dora e Allahut, është mbi xhematin.”¹⁵ “Në xhemat ka mëshirë, në ndarje ka dënim.”¹⁶

Një nga veprimet më të rëndësishme që e prish bashkimin dhe unitetin midis myslimanëve, është klanizmi si në aspektin individual, ashtu edhe në atë shoqëror.

ELEMENTI MË I RËNDËSISHËM QË E PRISH VËLLAZËRINË ISLAME, ËSHTË KLANIZMI

Një nga ndikuesit më të rëndësishëm që e prish bashkimin dhe unitetin mes myslimanëve, është klanizmi ose tribalizmi. Klanizëm, do të thotë të mbrosh klanin apo fisin tënd qoftë edhe në padrejtësi, të mburresh me prejardhjen, të pretendosh epërsinë e racës tënde, t'i urresh dhe t'i përçmosh ata që nuk janë prej fisit apo klanit tënd.

“Kush ushqen ndjenja klanizmi, nuk është prej nesh; edhe ai që lufton për shkak të klanizmit nuk është prej nesh; po ashtu edhe ata që vdesin për hir të klanizmit nuk janë prej nesh.”¹⁷

Ajo që duhet të bëhet, është t'u japim fëmijëve tanë një edukim të mirë fetar, të rishikojmë vëllazërinë islame nën dritën e Kuranit dhe Sunetit, të zbatojmë urdhrat e këtyre burimeve kryesore të Islamit dhe të mos kaplohem nga ndjenjat e kota të klanizmit.

Referencat: 1) Huxhurat, 10. 2) Buhari, Iman, 7; Tirmidhi, Sifetu'l-Kijame, 59. 3) Ebu Daud, Edeb, 130,131; Tirmidhi, Menakib, 28. 4) Fet'h, 29. 5) Buhari, Edeb, 27; Muslim, Birr, 66-67. 6) Al-i Imran, 103. 7) Ebu Daud, Sunnet, 26; Tirmidhi, Edeb, 78. 8) Bezzar, Musned, VII, 334, hadithi nr: 2933; Nesai, Sunenu'l-kubrà, III, 428, hadithi nr: 3649. 9) Ahmed b. Hanbel, Musned, V, 387, 406. 10) Maide, 32. 11) shih. Hamidullah, Muhamed, Lufrat e Profetit (a.s.), fq. 12-13. 12) Buhari, Iman, 22, Rikak, 31, Fiten, 10; Muslim, Fiten, 14. 13) Maide, 2. 14) Hakim, Mustedrek, IV, 282, hadithi nr: 7390. 15) Tirmidhi, Fiten, 7; Sujuti, Xhamiu's-sagîr, II, 205. 16) Kuzai Musnedu'sh-Shihab, I, 43, hadithi nr: 15; Sujuti, Xhamiu's-sagîr, I, 145. 17) Ebu Daud, Edeb, 111.

NDJENJA E PËRGJEGJËSISË

— Nuredin Jëlldëz —

Është një e vërtetë e qartë se në lidhje me njerëzinë tonë, nuk mund të marrim përgjegjësi me aq sa ndikohemi nga lajmet në çështjet me burim prej fesë sonë. Po ashtu, as peshë ekonomike apo barra politike që është mbi ne nuk mund ta përcaktojnë përqindjen e përgjegjësisë sonë. Pjesa jonë e përgjegjësisë, nuk mund t'u lihet as kuadrove politikë ndaj të cilëve anon zemra jonë.

Jemi njerëz dhe për shkak se jemi njerëz, jetojmë si myslimanë. Për sa kohë që të qenit njeri dhe të jetuarit si mysliman të jetë karakteri ynë thelbësor, edhe kriteri ynë i vlerësimit, duhet të jetë humanizmi dhe myslimanizmi. Përgjegjësia dhe shqetësimi ynë ndaj të gjitha zbatimeve negative mbi njerëzimin dhe të ardhmen e njerëzimit, duhet të jetë sa njerëzia jonë. Po ashtu, nëse shqetësimet tona në lidhje me të gjitha zbatimet negative mbi myslimanizmin, me projektet që e kanë bërë të pashpresë të sotmen dhe të ardhmen, me zjarret dhe vërshimet, nuk janë aq sa myslimanizmi ynë, ne nuk mund të pretendojmë për një myslimanizëm të mbushur përbrenda. Nëse shqetësimi ynë buron prej myslimanizmit tonë, atëherë edhe përqindjen e shqetësimit tonë, do ta përcaktojë përqindja e

myslimanizmit tonë. Kështu, ne kemi përgjegjësi, aq sa ndjejmë edhe shqetësim.

Mbase midis këtyre rreshtave duhet të ngucim edhe një të vërtetë tjetër. Edhe pse ajo është e rëndë aq sa na djeg shpirtin, ajo e vërtetë është se fjalët e bukura në lidhje me përgjegjësinë tonë, nuk do të kenë aspak dobi kur të vijë puna për llogaritjen e përgjegjësisë sonë reale tek Allahu i Madhëruar. Fjalët dhe qëndrimet tona, të cilat nuk e kapërcejnë cilësinë e një teksti letrar dhe që qëndrojnë veç në letër kur bie fjala për të sotmen dhe të ardhmen e umetit, nuk do të jenë aspak në cilësinë e një paraje të pranueshme në ditën e gjykimit.

Pasuria, dija, kultura, rëndësia, fuqia e fjalës, kapacitetit fizik, familja, statusi shoqëror etj., përbëjnë personalitetin tonë të formuar prej identitetit islam. Për rrjedhojë, edhe gjatë dhënies së llogarisë do të përballemi me këto. Periudha në të cilën je-



tojmë, duhet të ketë një dallim midis periudhës së Mekës dhe periudhës së Medinës. Nëse në besim e konsiderojmë veten në periudhën e Mekës, atëherë në praktikë, si mund të bëjmë sikur e po jetojmë Islamin pas çlirimit të Mekës?

Fushat e përgjegjësisë sonë fillojnë me egon tonë, gjë që është një e vërtetë e pakundërshtueshme. Padyshim se në radhë të parë jemi përgjegjës për veten tonë. Më pas vijnë pjesëtarët e familjes sonë. Pas kësaj, vjen umeti ynë dhe vlerat e tij, në mes të të cilit qëndrojmë si një pikë në qendër të rrethit. Ne jemi përgjegjës për çdo gjë të umetit tonë, që prej një fëmije që luan mbi tokën e tij, e deri tek një satelit që është vendosur në qiellin e tij. Kjo përqindje përgjegjësie, mund të jetë e ndryshme tek të gjithë.

Në fillim, kapaciteti i pretendimit tonë për besim, do të përcaktojë se për çfarë dhe sa përgjegjës do të jemi. Më pas, do të përcaktojmë fushën e llogarisë në bazë të mirësive që na ka falur Allahu i Madhëruar. Nuk duhet harruar se, edhe profesioni ynë do të ketë ndikimin e vet. Nuk mund të mendojmë se imami i një xhamie dhe myslimanët që falen në atë xhami, nuk do të llogariten në lidhje me cilësinë e namazit që falet në atë xhami. Duhet të llogaritim edhe cilësinë e namazit brenda xhamisë, por edhe mungesën e atyre që janë jashtë xhamisë dhe nuk marrin pjesë në namaz. Të falësh namaz në një xhami, do të thotë të njihesh si frekuentuesi i asaj

xhamie dhe të interesohesh me shtimin e numrit të atyre me të cilët do të ndahet ajo xhami. Një mysliman i ngarkuar me detyrën e imamit të xhamisë, ka përgjegjësi të shkallës së parë. Për rrjedhojë, edhe të gjithë ata që falin namaz në atë xhami, ndajnë midis vete përgjegjësinë në shkallët e tjera vijuese. Ndërkohë që ndjejmë diçka të bukur kur ndajmë sevapin e faljes së namazit me xhemat në një xhami, nuk mund të mos e ndjejmë edhe shqetësimin për ata të cilët janë të privuar me vite të tëra prej atyre sevapeve.

Një shembull tjetër, mund të jepet edhe në lidhje me Ramazanin dhe iftarin. Kur japim një iftar në Ramazan, si rezultat i kuptimit të gjendjes së të varfërve, padyshim se është e domosdoshme dhe e begatë të ndajmë edhe ushqime dhe sadaka. Mirëpo, kjo nuk është e mjaftueshme nga aspekti i përgjegjësisë. Nëse kuptimi i gjendjes së të varfërve prej iftarit të Ramazanit do të kishte një cilësi letrare, atëherë, si myslimanë kemi edhe përgjegjësinë e zhvillimit të projekteve për ta larguar plotësisht gjendjen e varfërisë prej umetit islam. Po, ne nuk mund të presim që çdo mysliman të zhvillojë një projekt të tillë dhe ta praktikojë. Duke filluar që prej atyre të cilët merren me politikë, liderët e shoqërive civile Islame, shkrimtarët, dijetarët, të pasurit, autoritetet dhe ata që kanë parë qoftë edhe një mirësi prej mirësive të Allahut, janë të detyruar të mendojnë se sa përqindje përgjegjësie kanë dhe të bëjnë atë që duhet bërë.

Kjo, do të thotë të jesh umet. Për këtë jemi umet.

Ashtu siç qëndrojmë në saf gjatë namazit, jemi të detyruar që edhe jetën ta jetojmë me rregullin e safit. Nuk mund të mjaftohemi me sadaka që do të justifikojnë përgjegjësinë tonë. Nuk mund të rrimë duke dhënë sadaka në vend që të gjejmë zgjidhje dhe të zhvillojmë projekte për të larguar varfërinë. Asnjë meny iftari, sado pjesëmarrës të ketë, nuk mund të ndikojë dhe të përhapet më tepër se sa një projekt që do të zhdukë urinë dhe mjerimin e umetit.

Këtë thotë e vërteta. Gjendja e umetit na e kujton këtë përgjegjësi që prej shumë vitesh, madje që prej shekujsh.

Ne mund të jemi një person i një umetit të madh dhe pjesa jonë mund të jetë një në një miliardë. Por sado i madh të jetë numri, përsëri emri ynë gjendet në listën e përgjegjësve.





Kurani udhëzuesi hyjnor

— Duran Ekizer —

Kurani Fisnik e shpreh me një metodë mjaft të shkëlqyer dhe gjuhë të prerë se ai vetë është udhërrëfyes në udhëzim për njerëzimin: **“Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira...”** (Isra, 9) **“Elif Lâm Ra. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t’i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë...”** (Ibrahim, 1-2) Edhe në ajetet e tjera të ngjashme me këto, me fjalën “errësira” është synuar shirku dhe kufri. Ndërsa me fjalën “dritë” është synuar siratu’l-mustekim / rruga e drejtë, domethënë, rruga e vetme që Allahu Teala ia ka zbritur njerëzimit, Islami.

Përsëri Kurani Fisnik, i cili na tregon se stili i jetës dhe forma e të lexuarit që ka vendosur Islami, i cili në disa ajete përsëri shprehet në formën “siratu’l-mustekim”, me të njëjtën shprehje të bukur na njofton se Islami është përngjarë edhe me një rrugë. Sepse kuptimi leksikor i fjalës “sirat” është “rrugë e gjerë”. Islami, në ajetin/lutjen: **“Na udhëzo në rrugën e drejtë!”** - të cilën e themi disa herë në ditë dhe për të cilën i lutemi e i përgjero kemi Zotit (xh.xh.), që të na udhëzojë, i është përngjarë “rrugës”. Për këtë arsye, nuk është përmendur vetë Islami, por është përmendur fjala “sirat” që është gjëja me të cilin është përngjarë Islami. Në këtë mënyrë, gjerësia dhe përfshirja e gjithanshme që gjenden në këtë fjalë, pra, theksimi i këtyre cilësive të Islamit, janë bërë në një formë letrare. Nëse kalojmë përtej këtyre shpjegimeve gjuhësore dhe përpqemi

për ta kuptuar këtë ajet, mund të nxjerrim këtë të vërtetë nën dritën e të dhënave që u shprehën pak më parë: Islami është një sistem hyjnor që mund të flasë në çdo fushë të jetës, që mund të vendosë një metodë dhe mënyrë jetese në të gjitha fushat që kanë lidhjen me njeriun dhe që i përfshin të gjitha kohërat e vendet. Në këtë sistem gjendet edhe ana materiale, edhe ana shpirtërore. Ndërmjet këtyre të dyjave nuk ka ndonjë ndarje, përkundrazi, ka një përshkrim të ekzistencës që mund të njihet dhe perceptohet me udhëzimin e Zotit të Madhëruar, i Cili është krijuesi i materiales dhe shpirtërores. Kuptimi leksikor i fjalës “mustekim” që përdoret pranë fjalës “sirat” në këtë ajet, është i – e drejtë. Kjo fjalë është mbimri i fjalës “sirat”. Sepse çdo rrugë nuk është e drejtë. Për këtë arsye, ka vetëm një rrugë të drejtë. Përdorimi i fjalës “mustekim”, shpreh se kjo rrugë gjithmonë është e drejtë dhe se absolutisht nuk ka devijime në të. Domethënë, kjo është rruga e vetme që të shpie te synimi.

Kurani Fisnik shprehet se të gjitha rrugët përveç “siratu’l-mustekimit” nuk të shpien te udhëzimi, sepse, shkenca e historisë na ka treguar se, të gjitha llojet e sistemeve të tjera që njeriu i ka formuar duke e lënë në plan të dytë Allahun Teala, e kanë zvarritur njerëzimin drejt shkatërrimeve. E vërteta e hidhur në planin e pasmë të këtij realiteti lidhet me faktin se njerëzimi e ka bërë veten zot. Pastaj ka nxjerrë idhujt dhe lidhja

e tyre me to është bërë një sistem besimi. Nuk është mjaftuar me kaq, por është përpjekur për t'ua imponuar të gjithëve pranimin e atyre idhujve. Për këtë arsye, Allahu Teala thotë duke i kundërshtuar të gjitha këto: **“Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t’ju shmangin nga rruga e Tij...”** (En'am, 153)

Historia e njerëzimit mund të themi se është historia e lidhjes së njeriut me Zotin e tij dhe historia që tregon të vërtetën nëse njeriu e ka mbajtur apo jo këtë lidhje me Atë. Kjo e vërtetë, pra, lufta ndërmjet të vërtetës dhe të pavërtetës, gjithmonë ka qenë e pranishme në historinë e njerëzimit. Pra, udhëtarët e rrugës së drejtë janë ata që e përkujtojnë Allahun Teala në çdo fushë të jetës së tyre dhe që e sistemojnë materialen e shpirtëroren sipas fesë që ka sjellë Ai. Ndërsa pasuesit e rrugës së humbur janë ata që zgjedhin një rrugë në kundërshtim me këta të parët dhe që nxjerrin një sistem jete sipas epsheve dhe dëshirave të tyre duke e refuzuar Allahun Teala. Kjo luftë e cila ka filluar që nga njeriu i parë dhe ka arritur deri në ditët e sotme, në çdo periudhë është shfaqur në kushte dhe rrethana të ndryshme. Shembujt për këtë janë shprehur në shumë ajete të Kuranit Fisnik. Për shembull, këtë e dëshmojmë edhe në luftën ndërmjet Ademit (a.s.) dhe shejtanit, sepse shejtani doli kundër urdhrorit të Allahut Teala. Pastaj e vuri veten e tij në qendër, e harroi Krijuesin e tij, hyri në një kauzë epërsie dhe shfaqti injorancën për të nxjerrë veten në pah: **“Ai u përgjigj: “Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta”.** (A'raf, 12) Sipas tij, kjo ishte diçka e drejtë dhe ai i besoi asaj që pandehte se ishte e drejtë. Ai e formoi këtë besim dhe si rezultat e kundërshtoi urdhrin e Krijuesit të tij. Për këtë arsye, zbriti në gradën e një krijese të mallkuar dhe u nxor nga mëshira hyjnore.


Pas kësaj shohim Nuhun (a.s.). Lufta që bëri Nuhu (a.s.), i vetëm me njerëzit e prishur që e kishin vënë shirkun në bazën e sistemit të jetës së tyre. Kjo luftë përmendet shpesh në Kuranin Fisnik dhe prej saj na jepen shembuj, në mënyrë që të udhëzohemi.

Ndërsa në ditët e sotme po shikojmë shfaqjen e ndryshme të të njëjtit realitet. Bota sot, në sajë të teknologjisë së komunikimit, është bërë si një fshat i vogël. Ndërsa faktorët që e formojnë jetën dhe e caktojnë rendin tonë të ditës, për fat të keq, janë në kundërshtim me Islamin. Sot, në dorën e të gjithëve, gjenden telefona që e kanë kaluar të qenët mjet komunikimi dhe janë bërë droga

moderne duke e preokupuar njeriun me gjëra të pavlera. Veçanërisht rinia (duke i përjashtuar ata që i përdorin në punë të dobishme), për shkak të disa rrjeteve sociale e çon dëm kohën në një botë virtuale. Për këtë arsye, ka thurur një mur të madh ndërmjet vetes dhe Krijuesit që ia ka falë kohën. Madje, edhe në muajin e Ramazanit tashmë po përjetohen shumë devijime në emër të dukjes dhe brendësia e vlerave që e bëjnë njeriun njeri po zbrazet nga dita në ditë. Përshpirtja e ka humbur vlerën dhe dukja ka dalë në plan të parë. Edhe te klasat fetare, opinionet në kundërshtim me Islamin pothuajse kanë fituar një rëndësi si ajo e besimit.


Fëmijët tanë nëpër shkolla, pra, në periudhën e jetës së tyre më produktive dhe kritike, po përpiqen me mish e me thua për të mësuar sa më shumë, në mënyrë që të kenë një pozitë më të kënaqshme nga aspekti material në jetën e tyre të ardhshme. Brezat që po gjenden në këtë garë po shkojnë nga një provim në tjetrin dhe si rezultat i kësaj po i konsiderojnë shokët si rivalë të tyre. Kjo gjendje mund të tolerohet deri në një pikë. Por sidoqoftë, në këtë çështje duhet të përdoren këto shprehje: “O nëna dhe baballarë myslimanë! A i japim rëndësi zhvillimit të përshpirtjes së fëmijëve tanë siç i japim rëndësi zhvillimit të tyre në shkencat pozitive? A e shfaqim të njëjtin interesim ndaj fëmijëve tanë, në mënyrë që ata të fitojnë vetëdijen e namazit siç e shfaqim për pikët që do të marrin në filan provim? Po të kishim në dorë një mjet që mat përshpirtjen, vallë, sa pikë do të merrnim ne në fillim dhe pastaj fëmijët tanë? Si do të jetë përgjigja jonë kur Allahu Teala të na marrë në llogari për sa i përket çështjes së detyrës si prindër? Për shembull, sa pikë mund të marrin fëmijët tanë në mësimet si drejtësia, ndershmëria, altruizmi, lëmosha, dhikri, marrja e vetes në llogari etj.?”

Këtë të vërtetë nuk duhet ta harrojmë asnjëherë: E vërteta është një dhe poseduesi i kësaj të vërtetë është Allahu Teala, i Cili e ka quajtur veten el-Hakk. Islami, të cilin e ka zbritur Ai dhe i cili është tërësia e urdhrave hyjnorë që është shpjeguar në Sunetin e të Dërguarit të Tij, është rruga e vetme e shpëtimit për ne. Asnjëherë nuk është e mjaftueshme që të kemi emër mysliman. Islami kërkon prej nesh që ta sistemojmë jetën tonë sipas rregullave që ka vendosur Allahu Teala. Jeta jonë është besimi ynë. Besimi ynë është shpëtimi ynë. Allahu (xh.xh.), na dhëntë të gjithëve vetëdijen e besimit! Amin!..



Islami është një sistem hyjnor që mund të flasë në çdo fushë të jetës, që mund të vendosë një metodë dhe mënyrë jetese në të gjitha fushat që kanë lidhjen me njeriun dhe që i përfshin të gjitha kohërat e vendet. Në këtë sistem gjendet edhe ana materiale, edhe ana shpirtërore.

“Besoj se ajo që ne mbërrijmë të bëhemi në jetë varet nga ajo që etërit tanë na kanë mësuar në çaste të çuditshme, kur në të vërtetë nuk dukej sikur po na mësonin. Ne jemi formuar pikërisht nga copëza të tilla dijeje”



SHEUQET MUKA DHE “ROMANI” EPISTOLAR I JETËS SË TIJ

— Gëzim Puka —

Pjesëmarrja në promovimin e librit “Sheuqet Muka – shkodrani”, organizuar disa javë më parë në Bibliotekën “Marin Barleti” të Shkodrës, më grishi të shkruaj diçka për disa motive ndjesore që lidhen me regjistrin stilistik të gjuhës së këtij libri, e sigurisht edhe me autorin Sheuqet Muka, i cili ka një lidhje të qenësishme me paraardhësit e mi.

Duke dashur t’i qëndroj besnik “zanatit” tim, domethënë interpretimit të tekstit dhe letrarësisë së tij, e gjej me vend të shprehem se ky libër është një roman epistolar, që pasqyron atë anë të jetës pak

të njohur të Sheuqet Mukës, këtij njeriu të mendjes dhe të zemrës, që me aq përvujtni i përballoi sfidat e jetës për të mos u tjetërsuar.

Unë e kuptoj se tek ky libër është vepruar me një strategji autoriale për t’i mbledhur ato letra dhe për të dokumentuar një personalitet siç ishte ai, por thellë-thellë mendoj se ashtu pa dashur është ndërtuar një roman epistolar, që stilistikisht ngjan si një tekst mungesor, që flet me shumë ndjeshmëri edhe me gjërat e pathëna. Ky është një kontribut është dhënë për këtë lloj shkrimor. Libri përpiqet

të shndërrohet në një ditar intim, ndërsa marrësi i mesazhit, domethënë lexuesi, kthehet në një entitet konvencional. Ndaj teksti ngjan më shumë me një monolog të protagonistit, që zbulohet dhe flet rreth vetes.

Sheuqeti tregon në këto letra ngjarjet dhe ndjenjat e tij duke pasur përpara një të ardhme të panjohur dhe të frikshme në kontekstin e diktaturës, por ajo që të befason është qetësia në përballimin e fatit, që unë pa e zmadhuar do e konsideroja, porë me syrin e sotëm, si heroike. Në sytë e lexuesit që jeton momentin e personazhit ndodh ky madhërim, sepse personazhi nuk e vajton fatin e tij. Befasohesh me fjalitë: *“Jam shumë mirë me shëndet...”*. Kjo i jep dramaticitet të menjëhershëm letrave të tij, prandaj theksova se më duket shumë e gjetur që hartuesit e librit e kanë rrokur idenë se kjo është forma më e spikatur për të mbërritur me plot ndjenjë tek lexuesi i sotëm.

Arsyeja e dytë është thellësisht personale. Në artikujt e përfshirë në libër dëshmohet edhe miqësia e zjarrtë që kishte Sheuqet Muka me personalitete të kohës që veprojnë në fushën e arsimit dhe të edukimit të brezave, ku ndër të tjera theksohet edhe miqësia që kishte me gjyshin tim, Hafiz Halil Puka. Dëshmohet një miqësi e vërtetë sipas parimeve të njerëzve të sakrificës ku shfaqet solidariteti në situata të vështira dhe rrezikohet jeta për shpëtimin e mikut.

Po citoj çfarë shkruan prof. Vehbi Hoti në artikullin e përfshirë brenda këtij libri: *“Është tregues shumë domethënës fakti që atë e ruajtën dhe e fshehën për dy vjet me radhë mu në qendër të qytetit më dhjetëra familje. Treguan një akt të lartë guximi familjet e Hamit Gjylbegut, Hafiz Halil Pukës, Dan Lllazanit, Tahir Isufit, Ismail Hotit, Zija Mukës, etj., të cilët vunë kokën e vet në rrezik për njeriun që aq shumë e donin dhe e nderonin”*.

Edhe kjo dëshmi na e jep një mesazh ne pasardhësve të këtyre figurave se sakrifica dhe dija e

tyre shkonte përtej predikimeve dhe mësimave të qëllimshme. Mbartja dhe kalimtarësia e diturisë së tyre dukej tek gjërat e vogla, në çastet që në vetvete duken si të pakuptimta, por që nuk janë të tilla.

Citoj nga letra 33 e datës 01.04.1957: *“Siç e dini tashma edhe ju vetë, un ç’prej një kohe tejet të gjatë, jetoj në një atmosferë vetmije, larg gjinit të pastër familjar prej të cilit s’m’asht ba kurrë që të ndahem e të largohem për qejf makar qoftë edhe për një minutë, kuer ishe i lirë ashtu siç ju kam fatbardhësisht juvet sod. Përveç erës së lirisë, s’ka erë ma të ambël e të shijshme se ajo e rrethit të familjes, së cilës s’i përngjet asnjë kënaqësi e shije tjetër në këtë botë,*

sado e vlefshme e e çmueshme që ajo të jetë. Sikur t’ishe para kësaj dileme: a don të jesh i pari i dheut, a të jetosh pranë familjes, un pa një pa dy do të hiqshe dorë prej së parës e do të zgjedhshe qindrimin tem në prehnin e familjes, ku njeriu lindë e rritet, zinë e fërgohet”.

Këto letra sot zbresin tek ne me dëshirën e zjarrtë për t’u shpallur, për të komunikuar. Ato qëllojnë në shenjë edhe në rrethanat e kohës sonë, e cila ngjan e mbushur me mllefë dhe egoizma provinciale, kur ne bijtë e tyre e kemi humbur paksa orientimin në rrugëtimin e vështirë drejt ndershmërisë.

Për të përfunduar uroj të bashkëndajmë mesazhin e këtij libri, duke e shoqëruar me një thënie të urtë të një prej dijetarëve më në zë të kohës sonë, Umberto Ekos, kur shkruante: *“Besoj se*

*ajo që ne mbërrimë të bëhemi në jetë varet nga ajo që etërit tanë na kanë mësuar në çaste të çuditshme, kur në të vërtetë nuk dukej sikur po na mësonin. Ne jemi formuar pikërisht nga copëza të tilla dijeje”*¹.

Unë kështu e kuptova këtë letrarësinë e këtij libri me letra, që u promovua në bibliotekën e qytetit tonë.

1. Umberto Eco: “Credo che ciò che diventiamo dipende da quello che i nostri padri ci insegnano in momenti strani, quando in realtà non stanno cercando di insegnarci. Noi siamo formati da questi piccoli frammenti di saggezza”.



Sjellja E MYSLIMANIT

— Ferit Piku —

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin famëlartë **“Pa-sha njeriun dhe atë që e krijoi, atë që ia mësoi njeriut veset e mira dhe veset e liga. Ka shpëtuar ai njeri që ka pastruar veten e tij, ka humbur dhe ka dështuar ai njeri që ka poshtëruar veten e tij”**. (Shems: 6-10).

Jetojmë në ato ditë, kur njerëzit shpenzojnë para, në ato ditë kur kryhen konkurse bukurie, në ato ditë ku shpenzohen me miliona pse jo dhe me miliarda dollarë për rrobat e njerëzve. Njerëzit shpenzojnë, harxhojnë për të rregulluar pamjen e tyre të jashme dhe shumë pak shpenzojnë për të rregulluar moralin dhe sjelljen e tyre, me pak fjalë të brendshmen e tyre.

Njeriu shpenzon, ndoshta edhe abuzon për të rregulluar formën e tij të jashme, të cilën nuk e ka në dorë. Zoti nuk do t'i pyesë njerëzit, se përse njëri është i bardhë e tjetri i zi, pse dikush është më i bukur e tjetri më i shëmtuar, sepse vetë i ka krijuar dhe pyetja për këto gjëra është pa vlerë.

Zoti do t'i pyesë njerëzit, për atë që gjendet në zemrat e tyre, për moralet dhe sjelljet e tyre. Vetëm shikoni se sa shpenzohet për moralet e njerëzve? Sa harxhojmë në konkurse, për t'u mësuar fëmijëve tanë edukatën, për t'u mësuar sjelljen? Shumë pak, ndoshta aspak. Gjithcka shpenzohet për të rregulluar të jashtmen tonë.

E ndjejmë të nevojshme të flasim për moralin dhe sjelljen, sepse ato e kanë zanafillën e tyre qysh me krijimin e njeriut të parë, Ademit (a.s). Kur Ademi (a.s) bëri një gabim, ai tregoi natyrën e tij të dobët,

por tregoi edhe moralin e tij. Pasi bëri gabimin, Ademi (a.s) tha: **“O Zot, ne i bëmë padrejtësi vetes tonë. Në qoftë se Ti nuk na mëshiron, në qoftë se ti nuk na fal do të jemi të humbur”**. (A'raf: 23). Kjo është natyra e njeriut të mirë, kjo është thjeshtësia, kjo është modestia, ky është morali i mirë.

Nga ana tjetër edhe shejtani bëri një gabim. Po çfarë bëri ai pas gabimit?! Ai tha: **“Unë jam më i mirë se njeriu, pse u dashka t'i përulëm njeriut? Unë jam krijuar prej zjarri, ai është krijuar prej balte”**. Kjo është mendjemadhësia, ky është morali i mendjemadhësisë e i kryeneçit. Që në fillimet e njerëzimit doli në pah morali i mirë dhe morali i keq.

Dikush mund të mendojë: **“Të flasësh për moralin, nuk është dhe aq e rëndësishme”**. Përkundrazi morali është pjesë e Islamit, është pjesë e besimit të çdo muslimani. Duhet ta dimë, se Allahu (xh.sh) i ka shpjeguar hollësisht cilësitë dhe emrat e Tij të bukur në Kuranin famëlartë. Pse vallë? Në mënyrë që besimtarët muslimanë të kenë një shembull, të marrin shembull tek Allahu (xh.sh), tek Zoti i gjithësisë. Për këtë arsye Allahu (xh.sh) ka folur për Vetën e tij dhe për cilësitë e Tij. Ato janë cilësitë absolute, janë cilësitë më të larta, prandaj besimtari musliman mund të marrë shembull te Krijuesi i tij, tek Allahu (xh.sh).

Allahu gjithashtu i zgjodhi profetët e Tij. Ata nuk ishin as më të fortët, as më të pasurit, por njerëzit me moralet më të larta, nga familjet më të pastra. Po pse vallë?! Në mënyrë që ata të jenë shembull për

fenë, të jenë shembull për mbarë njerëzimin, të jenë pishtarë ndriçues për çdo lloj njeriu, që dëshiron të ndriçohet në jetën e tij dhe në rrugën e tij.

Nga ana tjetër, Allahu (xh.sh) na i ka treguar me hollësi cilësitë e shejtanit të mallkuar. Pse vallë? Në mënyrë që besimtarët ta njohin armikun e tyre e të mos i ndjekin ato cilësi.

Ja pra Zoti i gjithësisë tregon për Veten e tij, Ai zgjedh njerëzit më të pastër, ai tregon për armiqet e besimtarëve, tregon për shejtanin dhe ithtarët e tij, që të mos merren si shembull.

Feja jonë nuk është vetëm fe rregullash, siç mund të reklamohet sot. Ajo është fe e besimit, është fe edhe e moralit. Feja jonë synon të rregullojë tre aspekte kryesore:

1- Aspekti i parë është **besimi i njeriut**. Feja ka për qëllim të kanalizojë besimin e njeriut. Çdo njeri është besimtar në natyrën e tij, por Islami erdhi për ta drejtuar këtë besim aty ku e pëlqen Allahu (xh.sh). Nuk është normale, që njeriu të adhurojë një njeri tjetër, gur e dru, lopë, dele e kafshë, por ai duhet të adhurojë Zotin e gjithësisë, Allahun (xh.sh), i Cili ka krijuar njeriun dhe gjithë universin. Ky është aspekti i parë.

2- Aspekti i dytë janë **marrëdhëniet mes njerëzve**. Feja erdhi për t'i rregulluar këto marrëdhënie.

3- Aspekti i tretë është **moraliteti i njeriut**. Feja erdhi për të rregulluar moralin e njeriut, të brendshmen e tij. Ja pra morali është një e treta e fesë islame. Gjithashtu duhet ta dimë, se morali i muslimanit nuk mund të shkëputet kurrë nga besimi i tij. Besimi i njeriut është pjesë e brendshme, është sekret mes tij dhe Allahut (xh.sh), ndërsa morali është ajo që duket.

Po të lexoni Kuranin famëlartë, do të habiteni se sa bukur i ka lidhur Allahu (xh.xh) besimin me moralin. Zoti thotë në Kuranin famëlartë: **“Kanë shpëtuar besimtarët”**. (Mu'minun: 1). Kush janë besimtarët o Zot? Allahu (xh.sh) na përgjigjet në Kuranin e Tij fisnik: **“Ata që kanë frikë Allahun në namazin e tyre, ata që falen me respekt dhe devotshmëri përpara Allahut”**. (Mu'minun: 2). Kjo është cilësia e parë e besimtarit, falja me respekt e devotshmëri.

Po pas namazit çfarë vjen? Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin fisnik: **“Janë ata që i kanë kthyer shpinën fjalëve të liga, fjalëve të kota”**. (Mu'minun: 3). Direkt pas namazit vjen, lënia e punës së kotë. Ktheji shpinën punëve të kota! Merru me dicka të hajrit!

Pastaj vazhdon Allahu (xh.xh): **“Janë ata që japin zekatin”**. (Mu'minun: 4). Besimtarët japin zekat nga pasuria e tyre. Pastaj Allahu (xh.sh) thotë: **“Janë ata që kanë ruajtur nderin e tyre”**. (Mu'minun: 6). Të ruash nderin është pjesë e moralit. Pastaj vazhdojnë ajetet kuranore, duke thënë: **“Ata që mbajnë amanetin”**. (Mu'minun: 7). Ta mbash amanetin e të mos e humbasësh atë, është tregues i moralit.

Kurani na tregon më tej: **“Ata që janë të kujdeshëm në namaze”**. (Mu'minun: 9). Janë ata që nuk e harrojnë namazin e tyre. Feja jonë ka bashkuar mes namazit, moralit, besimit dhe sjelljes. Ka ardhur koha që muslimanët ta kuptojnë, se ata nuk janë mbrapa thjesht me ekonomi, janë mbrapa edhe me morale. Ata duhet të jenë shumë më të fortë nga ana morale, duhet të kenë sjellje të forta, përndryshe do të shkojnë gjithmonë në rënie.

Çfarë e rregullon shoqërinë dhe çfarë e prish atë? Shoqërinë e prish morali i keq. Nga ana tjetër shoqërinë e forcon morali i mirë, i cili lidh familjet dhe njerëzit.

Ç'do të mendoje për një pallat, banorët e të cilit shohin njëri-tjetrin vëngër, mbajnë inat me njëri-tjetrin? Në atë pallat njeriu nuk guxon të lërë familjen e tij, nuk guxon të lërë pasurinë e tij, sepse ka frikë nga komshiu i tij.

Çfarë mund të themi për një kompani, punëtorët e së cilës kanë inat njëri-tjetrit, kanë smirë e zili ndaj njëri - tjetrit?! Nëse punon në një kompani të tillë, pret me padurim që të mbarojë orari i punës e të dalësh që aty një orë e më parë.

Ç'mendoni për një familje që po shkatërrohet, vetëm e vetëm se babai s'pyet për fëmijën e tij, as fëmija s'pyet për prindin e tij, as bashkëshorti për bashkëshorten e anasjelltas. Aty secili mundohet të bëjë qejfet e tij. Në këtë familje nuk ka moral dhe ajo për fat të keq do të shkatërrohet shumë shpejt, siç po ndodh me shumë familje në shoqërinë tonë.

E pra, kjo është shoqëria. Shoqëria është një pallat, një kompani, një familje. Po shkatërrohet shoqëria jonë, po shkatërrohen familjet tona dhe shkaktar i gjithë kësaj është morali i prishur, ai kancer që po futet në zemrat e njerëzve dhe po shkatërron mbarë njerëzimin. Pikërisht për këtë arsye na del për detyrë të kemi parasysh moralet tona.

Le ta pyesim veten “Ku jemi ne në lidhje me atë, që do Allahu (xh.xh)? Kush mund ta rregullojë moralin e njerëzve”? Kjo është **një pyetje** shumë e madhe. Po mundohen parti, po mundohen filozofë

*“Pasha
njeriun dhe atë
që e krijoi, atë që
ia mësoi njeriut veset
e mira dhe veset e liga. Ka
shpëtuar ai njeri që ka pastruar
veten e tij, ka humbur
dhe ka dështuar ai njeri
që ka poshtëruar
veten
e tij”.*

e sociologë për të rregulluar moralin e njerëzve. Po kush vallë e rregullon vërtet moralin e njerëzimit?

Kur do të vijë dita, që të jetojmë në një shoqëri e bashkësi të moralshme? Kur do të vijë ajo ditë, që të mos kemi më frikë për familjet tona, për pasuritë tona, të mos kemi frikë se mos na fusin duart nëpër xhepa e na vjedhin? Kur ka për të ardhur kjo ditë? Kush e rregullon moralin e njerëzimit? Mos vallë e rregullojnë ligjet që vendosin njerëzit? Ato ligje mund të rregullojnë vetëm anën e jashtme. Ato mund ta ndalojnë njeriun të mos bëjë keq, por ato nuk e nxisin njeriun të bëjë mirë. A mos vallë zhvillimi teknologjik do ta rregullojë moralin e shoqërisë sonë?

Po mundohemi të zhvillohemi, po çfarë po ndodh me moralet tona? Ata po shkatërrohen. Shikojeni vetë shoqërinë tonë, sesi po shkatërrohet. Shohim zhveshje të femrave nga të katër anët. Nënata tona, vajzat tona, motrat tona, po konkurojnë për t'u zhveshur sa më shumë. Mos vallë kjo është pjesë e moralit? A kjo do ta rregullojë shoqërinë tonë? A s'i keni parë televizionet në shtëpitë tuaja? A s'e keni parë se edhe në kuize edhe në konkurse, në plan të parë dalin dy vajza, dy figura gjysëm të zhveshura. Fëmijët i shikojnë, bashkëshortet i shikojnë, gjithë familja i shikon këto gjëra. Sot i bëhet reklamë zhveshjes, për ta bërë normal moralin e keq.

Po dëgjojmë dhe po habitemi për martesat mes llojit, burrë me burrë dhe grua me grua. Sot po kërcënohet rëndë institucioni i familjes, që është bërthama e një shoqërie të shëndoshë.

Moralin e rregullon vetëm Zoti i gjithësisë. Ai e di më së miri se çfarë ka krijuar, e di më së miri se çfarë do të veprojë njeriu. Themi pa frikë dhe mëdyshje, se ajo që rregullon tërësisht moralin, është feja e Allahut (xh.sh), Njeriu, duke dashur të rregullojë jetën e tij, shpeshherë pa dashje i bën dëm vetes së tij. Vetëm Allahu (xh.xh), Krijuesi i njeriut, mund të rregullojë jetën e njeriut.

Allahu (xh.sh), Zoti Ynë, Krijuesi i gjithë botëve, Ai i Mëshirshmi, i Buti, na mëson se na do shumë, na mëson moralet e mëdha dhe të vogla. Të mëson respektin ndaj prindërve, të mëson se si duhet të trokasësh në derën e prindit. Të mëson të mbash fa-refisin, të mëson se si duhet të shkosh për vizitë tek tjetri. Të mëson se si duhet të ecësh, se si duhet të ulesh. Të mëson edhe sesi duhet të futesh në banjo e si duhet të dalësh prej saj. Po pse vallë? Që të mos thotë besimtari se nuk kishte ku të merrte shembull. Ti e ke shembullin, por ndoshta nuk do të marrësh shembull. Kjo është feja e Allahut (xh.sh).

Po të studioni Islamin, do të shihni se ai nuk ka lënë gjë të vogël apo të madhe pa e shpjeguar, në mënyrë që njerëzit të kenë shembullin më të mirë. O vëllezër! Ka ardhur dita, kur njerëzit duhet të

masin besimin e tyre, të masin moralet e tyre. Na duket se jemi njerëz të moralshëm dhe inshallah të tillë jemi, sepse shikojmë dikë që është poshtë nesh. Por ta dini se nuk është ky parametri, me të cilin besimtari mat veten e tij. Besimtari duhet ta masë veten me gjëra shumë të thjeshta. A s'e ke dëgjuar se Allahu (xh.sh) për cilësinë e parë të robërve të vet tha: **"Robtë e Zotit janë ata që ecin butë, ecin thjesht në tokë"**. (Furkan: 63). A ecim ne thjeshtë në rrugë? A ecim thjesht me makinat tona, apo presim momentin për të xhiruar gomat e makinave tona? Ky është tregues i moralit të muslimanit.

A se ke dëgjuar fjalën, që Lukmani (a.s) i tha djalit të tij: **"Biri im, mos e ngri zërin më shumë se c'duhet, se zëri më i shëmtuar është zëri i gomarit"**. (Lukman: 19). A bërtasim ne në familjet tona? A i mbledhim mllefet, zemërimet, para nënës, para babait, para fëmijëve, para bashkëshortes dhe shfryjmë mbi ta me egërsi?! Kjo është pjesë e moralit të Islamit. A bërtasim ne në rrugë, a bërtasim në xhamitë tona, në vendet e kultit? Këtu matet morali i besimtarit musliman.

Profeti Muhamed (a.s) thotë: **"Të heqësh papas-tërtinë prej rruge është pjesë besimit"**¹.

Kush prej nesh denjon të dalë prej xhamie, të pastrojë rrugën, të pastrojë rrugën e shtëpisë së tij. I shikon njerëzit sesi e hedhin qesen me mbeturina nga kati i tretë, apo nga xhami i makinës. Ky është parametri, me të cilin besimtari e mat veten e tij, pra tek gjërat më të thjeshta. Ne s'e kemi pyetur veten, po keto janë tregues të besimit. Islami nuk kërkon mrekullira prej njerëzve. Ai kërkon prej nesh ta fillojmë me punë shumë të vogla. Po qe se e fillojmë me punë të vogla, Zoti (xh.xh) i rregullon punët e mëdha.

A kanë dëgjuar gratë dhe motrat tona, se Profeti Muhammed (a.s) ka thënë: **"O gra besimtare, kur të gatuan dicka, shtoni pak dhe jepini edhe komshiut tuaj"**. Çfarë bëjnë muslimanët sot? A e respektojnë komshiun apo e marrin atë nëpër gojë. Sot ka gra që banojnë në katin e tretë dhe nxjerrin për të terur rrobat e zeza, të cilat kullojnë mbi rrobat e bardha të komshiut të katit të dytë, duke i bërë pis ato. Ku është besimi këtu?! A nuk logjikoni?!

Ne duhet ta pyesim veten tonë për gjëra shumë të thjeshta. A ka besimtarë që me makinën e tyre zënë rrugën e makinave të tjera? A ka besimtarë, që vendosin të parkojnë makinën e tyre përpara derës së komshiut? Ja ky është morali i muslimanit.

Bota nuk dëgjon me veshë, ajo shikon me sy. Në qoftë se do të tregosh se kush është muslimani i vërtetë, tregoje me vepra dhe jo me llafe. Tregoje veten tënde, tregoji moralet e tua, se ato do të shi-

1. Buhariu dhe Muslimi

kojnë njerëzit, ndërsa atë që është mes teje dhe Allahut (xh.xh) nuk e di as unë, as njerëzimi, atë e di vetëm ti dhe Allahu (xh.sh).

E lusim Allahun (xh.sh) t'i zbukurojë moralet tona. Lusim Zotin e gjithësisë të na mundësojë ta kalojmë gjendjen e dobësisë tonë e t'i forcojmë moralet tona me lejen e Tij.

Lusim Allahu (xh.sh) të na dhurojë një shok të mirë, i cili na tregon për mangësitë tona. Lusim Allahu (xh.sh) të na bëjë të thjeshtë, ta dëgjojmë mangësinë dhe gabimin tonë edhe prej armikut. Armiku mund të të ndihmojë të njohësh veten tënde.

Profeti Muhamed (a.s) ka thënë: **“Jam dërguar për të plotësuar moralet e larta”**². Ta thoshte këtë fjalë një filozof mund të pranohej, ta thoshte një sociolog mund të pranohej, por e thotë profeti i Allahut (xh.xh), ai që ishte edhe president por ishte edhe shërbëtor, ai që e jetoi jetën si beqar por edhe si burrë i martuar, ai që jetoi në paqe dhe në luftë. Gjatë gjithë 23 viteve që jetoi si profet, ai tha: **“Unë kam ardhur vetëm për një qëllim, për të përsosur moralet e njerëzimit”**³.

Po të rregullohet morali, rregullohet jeta, rregullohen marrëdhëniet me Allahun (xh.xh). Ja ky është funksioni i Profetit (a.s), ky është edhe funksioni i Islamit.

Duhet të na vijë keq, që feja e Allahut (xh.sh) po reklamohet thjesht si fe rregullash të thata e pa asnjë kuptim. Mos vallë ky është thelbi i Islamit? A kjo është feja e Allahut (xh.sh)? Disa rregulla që ne bëjmë e të tjerët nuk kuptojnë se çfarë bëjmë ne? Ne falemi, ata habiten. Ne agjërojmë, ata habiten. A kjo është feja e Allahut? Jo pasha Zotin nuk është kjo feja e Allahut (xh.sh).

Po të studiosh Islamin, po të njohësh thelbin e tij, do ta shohësh se të gjitha adhurimet që bëjmë, falja e namazit, agjërimi, haxhi, zekati kanë një qëllim të vetëm: **“Të rregullojnë moralin e njeriut”**. Ky është qëllimi final, për të cilin ka ardhur feja e Allahut (xh.sh).

Allahu thotë në Kuranin famëlartë: **“Namazi ndal nga veprat e liga, nga fjalët e kota”**. (Ankebut: 45). Nëse namazi po të ndalon nga veprat e liga, atëherë dije se namazi po bën dobi në zemrën tënde.

Profeti Muhamed (a.s) thotë: **“Pasha Zotin, nuk ka vlerë agjërimi i atij njeriu që agjëron, mban barkun bosh, por nuk largohet nga gënjeshtria**

dhe thashethmet. Allahu (xh.sh) nuk ka nevojë për agjërimin e këtij personi”⁴. Agjërimi ka një qëllim: të rregullojë moralet dhe sjelljet e njerëzve.

Allahu (xh.xh) thotë: **“Merr nga pasuritë e tyre zekatin”**. (Teube: 103) Pse vallë të marrim zekatin? Për të pastruar zemrat e besimtarëve. Qëllimi i zekatit është të pastrojë zemrën e njeriut. Po ashtu Allahu (xh.xh) flet për haxhin: **“Kush e ka bërë nijet të shkojë në haxh, le ta dijë, se atje nuk ka fjalë të kota, nuk ka debate, nuk ka punë koti”**. (Bekare: 197) Atje ka pastrim zemrash e moralesh.

Kjo pra është feja jonë. Këto janë bazat e fesë tonë. Ata kanë një qëllim të vetëm, kanë një synim final, të rregullojnë marrëdhëniet e njeriut me njeriun, të rregullojnë moralet e njerëzve. Është e vërtetë, se të jesh i moralshëm në kohën tonë është shumë e vështirë, sepse në këtë kohë, kur ti mendon mirë, tjetri mendon keq për ty, ti mundohesh t'i japësh hakun tjetrit, tjetri mundohet të të hajë hakun tënd. Nëse nis të bësh llogari e parashikime, të duket e pamundur. Por besimtari i tejkalon parashikimet. Ai nuk është bir i dynjasë, por i ahiretit. Ai punon e jeton për xhenetin e Allahut (xh.xh).

Sot është e rëndë të jetosh me moral, por më e rëndë se kaq është morali në ditën e Gjykimit tek peshorja e besimtarit. Ne I besojmë fjalës së profetit (a.s), i cili ka thënë: **“Puna më e rëndë që vihet në peshoren e njeriut Ditën e Gjykimit, është morali i tij”**⁵.

E lusim Allahun (xh.sh) t'i pastrojë zemrat tona. Lusim Allahun (xh.xh), që ashtu siç ka zbukuruar fytyrat tona, të zbukurojë dhe moralet tona. O Zot, na udhëzo nga moralet e mira, sepse nuk ka kush na udhëzon drejt tyre përveç Teje. O Zot, largoji prej zemrave tona moralet e ulta, sepse askush përveç Teje nuk mund t'i largojë këto morale të ulta prej nesh. O Zot na fal ne, fali prindërit tanë, fali të gjithë njerëzit që e duan faljen tënde. O Zot fali gabimet tona, ata që duken dhe ata që nuk duken, gabimet e mëdha dhe gabimet e vogla. Ata që i dimë vetëm ne dhe Madhështia jote. O Zot na mëshiro dhe prindërit tanë, na mëshiro sa jemi gjallë, na mëshiro kur të vdesim, na mëshiro kur të dalim para Madhështisë tënde. O Zot, rëndoje peshoren tonë me morale të mira, rregulloji moralet e muslimanëve dhe shoqërinë ku jetojnë muslimanët.

Amin!..

2. **Hadith i vërtetë**. Buhariu në Edebul Mufred.

3. **Hadith i vërtetë**. Buhariu në Edebul Mufred.

4. Buhariu dhe Muslimi.

5. Tirmidhiu dhe Ibn Hibani.





Mos u mundo kot ZEMRËS NUK I VENDOS DOT KUSFIJ

— Fatma Hale Liman —

Gjatë një vizite në vendet e Lindjes, një grua e guximshme më bëri këtë pyetje:

“Një grua e martuar, a mund të dashurojë dikë tjetër?”

Njerëzve përreth nuk u pëlqeu shumë kjo pyetje, por megjithatë unë i dhashë përgjigje:

“Një dashuri që mbahet thellë në zemër dhe nuk del në sipërfaqe nuk përbën problem. Pra nuk duhet që të flitet në telefon, të mos bëhen takime të fshehta apo gjëra të tilla. Kjo ngjan me rastin kur njeriu ka një mendim të keq në tru, por nuk e realizon atë dhe kjo nuk quhet mëkat...”

Arsyeja se përse ishte bërë kjo pyetje ishte shumë e dhimbshme; vajza kishte qenë shumë e dashuruar me një djalë të ri, por familja kishte vendosur që ta jepte nuse tek një burrë i pasur që kishte dy gra... Vajza ishte vetëm gjashtëmbëdhjetë vjeçe... Mendoj se është e pamundur që ta kuptojmë plagën e saj të zemrës...

Në universitet kisha një shoqe... Gjyshen e saj e kishin martuar pavarësisht se ajo donte një tjetër; këtë nuk e dinte askush përveç nënës së saj. Ishte e çuditshme, por këtë vajzë e donte një djalë tjetër dhe familja kishte vendosur që t'ia jepte

atij. Dashuritë e atyre kohëve nuk ngjasojnë me dashuritë e sotme. Atëherë kishe mundësi që ta shikoje njeriun e zemrës një herë në muaj, ose në vit... Ai shikim ishte shpresë për vite të tëra... Dashuria e tyre ishte e atij lloji, nuk kishin folur asnjë fjalë por ishin dashuruar.

Në një hadith; Pejgamberi ynë i nderuar, të riut që nuk martohej dot me vajzën që e donte, i ka thënë:

“Sikur jo vetëm unë, por edhe Xhebraili, Israfil, Mikaili dhe melekët që mbajnë arshin të bënin dua; ti nuk do të mund të martohesh me askënd tjetër përveçse me atë që ta ka caktuar Allahu.”

Martesa është kader absolut dhe prandaj nuk ndryshon në asnjë mënyrë. Kjo gjë nuk është në dorë të robit. Njeriu martohet me atë që i ka caktuar Allahu. I riu që donte vajza, martohet dhe në mënyrë që ta shikojë çdo ditë njeriun e zemrës merr një shtëpi përballë shtëpisë së saj. Gjyshja e shoqes sime i bën të gjitha detyrat ndaj bashkëshortit të vet, por asnjëherë nuk ia shpreh dashurinë e vet atij. Koha kalon dhe ata bëhen me fëmijë... Gjyshja bëhet shoqe me fqinjën përballë, pavarësisht që është e dashuruar me të shoqin... Gjyshja

nuk e ngre kokën asnjëherë për ta shikuar në sy njeriun e zemrës, as nuk i thotë asnjë fjalë.

Histori të tilla nuk janë të rralla; njerëz të martuar me dikë e të dashuruar me dikë tjetër... Sigurisht që mund të pyesim veten në qoftë se veprime të tilla jenë të moralshme apo jo. Mësuesi i tefsirit na ka treguar se një periudhë kohe është ndaluar leximi i sures Jusuf nga gratë me frikën që mund t'i tradhtojnë burrat e tyre. Sigurisht që nuk ishte një ndalim i drejtë... Në ajetin 25 të sures Nisa thuhet:

“Cilido nga ju që nuk mund të martohet me gra të lira besimtare, për shkaqe të vështira materiale, le të martohet me një vajzë besimtare që gjendet nën pushtetin tuaj (robërshë) - e Allahu e di më së miri besimin tuaj -, se jeni nga njerëzit. Martohuni me to me lejen e pronarëve të tyre. Jepuni dhuratat si është e zakonshme për gra të ndershme e jo imorale të hapura apo të fshehta, që jetojnë me dashnor. Nëse ato, pasi të martohen, bëjnë kurvëri, dënimi i tyre është për gjysmë me dënimin e grave të lira (të pamartuara). Kjo është për ata nga ju, që kanë frikë se do të bëjnë gabim (kurvëri). Nëse përmbaheni, kjo është edhe më mirë! Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”

Pas një ligjërate që mbajta tek një rrethinë e qytetit, një grua erdhi dhe kërkoi që të kishte një bisedë private me mua. Ishte e martuar dhe kishte dy fëmijë. Pas martese kishte mësuar që i shoqi ishte detyruar nga prindërit për t'u martuar. Ai kur kishte qenë në gjimnaz ishte dashuruar me një shoqe të veten, por nuk e kishin lejuar të martohej me të. Pavarësisht se vajza kishte shkuar në një qytet tjetër ata nuk i kishin shkëputur lidhjet asnjëherë. Akoma flisnin në telefon me njëri-tjetrin. Gruaja ndihej shumë keq nga mungesa e interesit të burrit të vet dhe nga fakti që sa herë që ndodhte një zënkë sado e vogël ai i thoshte:

“Bëj ç'të duash, në qoftë se ke dëshirë mund të ndahemi.”

Gruaja përpiquej me të gjitha forcat për t'u sjellë sa më mirë me bashkëshortin, por nuk arrinte që ta bënte ta harronte gruan tjetër, sepse në ajetin 63 të sures Enfal Allahu ka thënë:

“...duke i bashkuar zemrat e tyre (si një zemër e vetme). Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në Tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu i bashkoi ato. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”

Rumiu, në Mesnevinë e tij ka thënë:

“Dashuria është një nga cilësitë e Allahut. Të dashurohesh dhe të pendohesh për këtë gjë është

e pamundur, sepse pendimi është një ujë i shkretë, kurse dashuria është një dragua. Pendimi është një cilësi e njerëzve, prandaj ajo është e pafuqishme ndaj dashurisë. Për njeriun e dashuruar, pendimi dhe durimi duken si gjëra të pamundura. Njeriu dashurohet me një krijesë të Krijuesit, por kjo është një dashuri kalimtare. Dashuria metaforike është e zbukuruar nga jashtë. Në dukje është e bukur dhe plot dritë, por brendësia është e mbushur me tym. Në momentin kur ik drita dhe mbet tymi kjo dashuri metaforike vyshket, zhduket.”

Bilali (r.a.), pasi pranoi Islamin tha i emocionuar:

“Allahu është një.” Teksa ai po qante nga kënaqësia që ndjente nga shqiptimi i këtyre fjalëve, një çifut po e godiste me tela me gjemba. Ebu Bekri, kur e shikoi atë vetëm, i tha:

“Allahu i di gjërat e fshehta, mbaje të fshehtë besimin tënd, mos e hidh veten në rrezik, por pendohu në sy të tjerëve!”

Bilali mund të pendohej (në sy të njerëzve), por nga emocioni i dashurisë e harroi pendimin dhe e shfaqti atë që ndjente. Këshilla nuk i bëri punë, ai u largua nga pendimi. Çifuti e bëri trupin e tij vrima-vrima. Bilali nuk u nënshtrua, sepse ai ishte i mbushur me dashuri. Pendimi dhe durimi janë të dobët para dashurisë.

Dashuria është cilësi e Allahut, nuk mund të jetë cilësi e robit. Nuk ka shpëtim nga dashuria, në qoftë se Zoti e ka caktuar diçka, a nuk kemi asnjë zgjidhje ne? Të gjitha këto fjalë nuk janë për të treguar dëshpërim, por për t'ju këshilluar që të keni kujdes dhe të mos shikoni gjëra të ndaluara. Robi është përgjegjës për gjërat që bën para se të bjerë në dashuri, sepse në momentin kur i afrohesh zjarrit është shumë e vështirë që të mbrohesh nga ai... Njeriu e ka për detyrë ta besojë këtë gjë dhe të mos qëndrojë me njerëz të gabuar. Mos harroni që jo çdo dashuri mbaron me martesë, prandaj më e mira është që ta mbajmë zemrën të pastër... Le të përpiqemi që të mos ulemi në mjedise ku gratë janë përzier me burrat, le të ruajmë sytë nga harami, mos të qëndrojmë vetëm me njerëz të gjinisë tjetër, le të kemi kujdes për të mos shfaqur sjellje apo veprime që tërheqin vëmendje, le të mudo-hemi të qëndrojmë larg problemeve të dashurisë dhe lidhjeve të dyshimta; të gjitha këto janë çështje prej të cilëve duhet të kemi kujdes.

Të martuar dhe beqarë, besimtarë apo jo; të gjithë i kanë qejf filmat romantikë dhe derdhin lot duke i shikuar, sepse Allahu e ka krijuar njeriun të tillë që të mahnitet nga dashuria dhe të preket



nga ajo. Çdo lloj dashurie është një sprovë për njeriun... Edhe dashuria për bashkëshortin... Dashuria për bashkëshortin duhet të jetë e një lloji që ta drejtojë njeriun drejt Krijuesit, sepse njeriu vihet në provë nga personi i zemrës. Dashuria duhet të jetë për Allahun.

Njeriu, në qoftë se është e mundur, duhet ta fshehë dashurinë edhe prej vetes. Ashtu siç nuk ha ëmbëlsira i sëmuri nga sheqeri dhe mban dietë, ashtu edhe njerëzit e dashuruar që kanë frikë se mos bëjnë gabime të mëdha duhet të ruhen nga njeriu i zemrës. A është e mundur kjo gjë? Kjo është një sprovë shumë e vështirë, sepse një njeri që futet në zemër është e vështirë të dalë prej saj. Mendojmë se i kemi harruar, por vjen një çast dhe na kujtohet çdo gjë. Ti provon me qindra mënyra për ta harruar, edhe pse gjuha jote thotë se ka kaluar, zemra e mohon këtë gjë. Nga këto ne kuptojmë që nuk mund të shpëtojmë nga një problem i tillë vetëm me ndihmën e Allahut (xh.sh.).

Rumi, në Mesnevinë e tij flet për lotët e mbushur me dhembje të një të riu. Ky djalë i ri kishte shkuar tek një dijetar dhe i kishte treguar shqetësimin e vet:

“Jam i lidhur me litar të padukshëm, nuk mund të lirohem dot nga ato, nuk shpëtoj dot nga kjo robëri. Një mijë herë betohem se nuk do të gaboj më, por nuk ia arrij që ta mbaj zotimin.”

I riu ka rënë pre e një dashurie të madhe; ai është i shkrutë, sepse e ka të pamundur të shpëtojë nga ky shqetësim. Ai nuk mund të dashurohet me dikë tjetër, por as të martohet me atë që do. Në të vërtetë, kjo është më e rënda e skllavërive ...

“Shkatërroji këto zinxhirë dhe më shpëto mua!” - i lutet me përgjërëm.

Lejla dhe Mexhnuni e shkruar nga Fuzuli, duhet të lexohet me shumë kujdes. Sa bukur ka shkruar

ky poet sufi. Sa vlera të mëdha shpirtërore fiton një njeri i dashuruar.

Nga të gjitha këto, kuptojmë që zemra e njeriut mund të jetë e mbushur me dashuri dhe në momentin që këtë nuk e kthen në veprim, nuk ka asnjë problem, sepse instinkti i zemrave është në dorën e Allahut. Zylejhaja u dashurua me Jusufin (a.s.), por ajo ishte e martuar dhe mëkati i saj filloi në çastin kur e shfaqti dëshirën e vet. Dijetari i tha djalit të ri që të lidhej fort pas Resulullahut (a.s.), sepse vetëm Pejgamberi ynë i nderuar mund ta shëronte, vetëm ai mund t'i dhuronte shpëtimin.

Nuk është e këndshme që një njeri i martuar të dashurohet me dikë tjetër, por nuk kemi pse t'i paragjykojmë këta njerëz. Më e mira e të gjithave është që të bëjmë dua dhe të kërkojmë ndihmën e Allahut. Paragjykimi dhe mbajtja me të madhe nuk do të sjellë asgjë të mirë përveç se do të na sjellë edhe ne para të njëjtit problem.

Ashtu siç merr sevape një njeri që agjëron gjatë Ramazanit vetëm për hir të dashurisë së Allahut, në të njëjtën mënyrë merr sevape shumë të mëdha edhe ai që është shumë i dashuruar, por mban agjërimin e të qëndruarit larg personit të dashuron. Një dashuri që të bën të vuash në heshtje e ngre njeriun shpirtërisht.

Dashuria është një ndjenjë shumë e fuqishme dhe nganjëherë e rrezikshme... Duhet të bëjmë shumë dua që Allahu të na ruajë nga takime apo biseda të rrezikshme në punë, lagje apo internet. Allahu na ruajtë nga dashuritë e rrezikshme dhe të papërshtatshme! Allahu mos na braktistë as për një moment të vetëm! Allahu i ndihmoftë edhe njerëzit që janë duke vuajtur nga dashuria dhe bëftë që të pendohen sa më shumë!

Nuk ka dashuri pa dëlirësi

— Aishe Gyndyz —

Po, dashuria e kishte bërë Zyjelhanë të ishte e Jusufit... Zylejhaja kishte gjetur tek Jusufi thesarin e bukurisë. Është e vërtetë që në fillim ajo e soditi nga dritarja e egos por më vonë u magjeps pas tij dhe filloj të shikonte me ëndje nga dritarja e shpirtit.

Nuk lejoj kënd që të flas keq për Zylejhanë dhe njerëzit që i ngjasojnë asaj... Më duket se edhe ne shikojmë nga dritarja e egos... Burrat ëndërrojnë për një Zylejha, e gratë për një Jusuf... Askush nuk ndjen nevojën për t'u bërë një Jusuf apo një Zylejha... Burrat qëndrojnë në ndalesën e dëlirësi por nuk lodhen që të pastrojnë shpirtin e vet ndoshta për faj të interesit që shfaqin Zylejhatë ose ndoshta për faj të egos se djallëzuar. Po gratë? A nuk shohin tek Zylejhaja asgjë tjetër veçse grisjen e këmishës së Jusufit? Zylejhaja kalon nga një këngë në tjetrën por pa u kuptuar ashtu siç duhet... Flet me një zë të dëshpëruar sepse nuk është bashkuar me njeriun e zemrës:

“- Ti nuk u bërë dot Zylejha!”

Zonjat janë të qeta...

“- Unë jam Zylejhaja, kështu është njeriu i dashuruar...”

Sa keq do të ndihej Zylejhaja po ta dinte për këmishët e grisura që justifikohen me imitimin e saj...

Pse shikohet dashuria nga ky këndvështrim? A mos vallë është propozimi i Hatixhes që u jep guxim grave? A nuk e dinë se ajo kur dëgjo ardhjen e një pejgamberi kishte thënë:

- Në qoftë se do të vij një njeri i tillë, unë do të martohem me të.

Ishte dashuruar me të pa e parë. Ajo çdo veprim e ka bërë me edukatë dhe moral të lartë.

Ajo që quhet dashuri mes dy njerëzve tashmë na shfaqet vetëm si guxim i tepërt, injorancë dhe rehati... Unë dua që dashuria të jetë e zbukuruar me pak turp; nuk jam dakord me shprehjen: “Çdo i dashuruar është pak i paedukatë.” Dashuria duket bukur tek ai që ka kujdes të jetë brenda rregulla të Islamit dhe të cilit i skuqen faqet dhe nuk i ngre dot sytë nga toka për të shikuar njeriun e zemrës...

Le të shikojmë pak jetën e Hasan Basriut, për të kuptuar se çfarë është dëlirësia...

Hasan Basriu në rininë e tij ka qenë një djalosh simpatik. Vishej me rrobat më të bukura dhe shëtiste në të gjitha vendet e Basras dhe argëtohej. Një nga ato ditë, teksa po ecte në rrugë shikoi një grua shumë të bukur. Hasan Basriu u vu në ndjekje të saj. Pasi ecën pak, grua ja u kthye dhe i tha:

- A nuk të vjen turp?

Hasan Basriu e pyeti:

- Prej kujt duhet të kem turp?

- Prej Allahut, i Cili i di shikimet e tua të rrezikshme dhe sekretet e zemrës tënde...

Hasan Basriu u dridh nga këto fjalë, shtrëngoi mjekrën e vet dhe tha:

“- Turp të kesh o nefs im. Ti me këtë mjekër re më poshtë se ajo grua!...”

Nuk ka dashuri pa dëlirësi dhe moral të lartë! Edhe në qoftë se ka, ajo dashuri nuk ka vlerë. Nuk e afron njeriun me Zotin. Ashtu siç nuk pasurohet njeriu nga thesari që shikon në ëndërr, ashtu nuk ngopet zemra me veprime të pamoralshme.

Ushqimet

MË TË MIRA PËR SHËNDETIN E SYVE

Njerëzit e lidhin shëndetin e syve me plakjen e paevitueshme.

Në të vërtetë, një regjim i shëndetshëm ushqimor mundet të pakësojë rrezikun e sëmundjeve të syve.

Një studim i vitit 2001 mbi sëmundjet e syve si pasojë e moshës, zbuloi se një sërë ushqyes si: zinku, bakri, vitamina C, vitamina E dhe beta karoteni, munden të përmirësojnë shëndetin e syve me 25%.

Studimi u përditësua edhe në vitin 2013 dhe arriti në konkluzionin se acidet yndyrore omega-3, beta karoteni, luteina dhe antioksidantë të tjerë janë thelbësorë për shëndetin e syve.

Në këtë artikull të do të mësoni për 10 ushqimet më të mira dhe të nevojshme për shëndetin e syve.

PESHKU

Shumë lloje peshqish janë burime të larmishme të acideve yndyrore omega-3. Megjithatë, peshqit më të pasur me këto acide yndyrore janë toni, salmoni, trofta, sardelet, skumbria

Shumë studime kanë zbuluar se vaji i peshkut është efikas kundër përtharjes së syve, sidomos asaj të shkaktuar nga të qëndruarit përpara kompjuterit.

ARRORËT DHE BISHTAJORET

Arrorët janë gjithashtu të pasur me acide yndyrore omega-3.

Sipas të dhënave të AgroWeb.org arrorët përmbajnë edhe shumë vitaminë E që mbron sytë nga dëmet e vazhdueshme prej moshës.

Konsumoni më shumë arra, shqeme, kikirikë dhe bishtajore si fasule, thjerrëza etj.

FARAT

Njësoj si arrorët dhe bishtajoret, edhe farat janë të pasura me omega-3 dhe një burim i shkëlqyer i vitaminës E.

Zgjidhni farat chia, farat e linit për të mirëmbajtur shëndetin e syve.

AGRUMET

Agrumet janë shumë të pasura me vitaminë C, një antioksidant i rekomanduar kundër sëmundjeve të syve.

Është e këshillueshme të konsumoni më shumë limonë, portokall, qitro për të marrë sa më shumë vitaminë C.

BARISHTET

Barishtet si spinaqi janë të pasura me shumë antioksidantë dhe vitaminë C.

Ato duhen konsumuar rregullisht.

KAROTAT

Karotat janë të pasura me beta karoten dhe vitaminë A e cila luan një rol thelbësor në shikimin tuaj.

PATATJA E ËMBËL

Ashtu si karotat edhe patatja e ëmbël përmban beta karoten por edhe vitaminë E.

PANXHARI

Panxhari është i pasur me zink, që luan një rol mirëmbajtës për shëndetin e syve.

Sipas të dhënave të AgroWeb.org zinku ndihmon në ruajtjen e shikimit pavarësisht moshës dhe parandalon formimin e perdes së syrit.

VEZËT

Vezët janë një burim i shkëlqyer antioksidantësh që mbrojnë shikimin.

Ato përmban zink, vitaminë C dhe E.

UJI

Uji është thelbësor për shëndetin e syve.

Duhet të pini shumë ujë që të parandaloni hidratin dhe përtharjen e syve.





Kura dy ditore

PËR PROBLEMET ME TRETJEN

Konstipacioni, plogështia dhe problemet me stomakun janë shenja paralajmëruese që sistemi tretës nuk po funksionon siç duhet.

Ky mos funksionim shkakton një barrë të rëndë në zorrën e trashë dhe rrit rrezikun e ekspozimit ndaj toksinave të dëmshme.

Për më tepër, ushqyerja e keqe, mungesa e aktivitetit fizik dhe problemet e shpeshta me tretjen rrisin rrezikun e problemeve të rënda me zorrën e trashë.

Speci djegës përmban sasi të mëdha të kapsaicinës, një substancë që frenon nepsin, rrit nivelet e energjisë, djeg yndyrnat, ul kolesterolin dhe qelizat kancerogjene.

Të gjitha këto veti janë të domosdoshme për shëndetin e sistemit tretës dhe shmangien e konstipacionit.

Në këtë artikull të do të mësoni se si të përdorni specin djegës në bashkëpunim me mjaltin dhe lëngun e limonit për të përshpejtuar tretjen.

PËRBËRËSIT

- 2 lugë gjelle me lëng limoni,
- 2 lugë gjelle me mjaltë,
- Një majë luge çaji me spec djegës të kuq,
- 300 ml ujë.

PËRGATITJA

Përziejini të gjithë përbërësit në një gotë.

Kura duhet bërë për 1 deri në 2 ditë. Ajo duhet pirë nga pak në 6-12 herë në ditë. Gjatë kësaj periudhe nuk duhet të konsumoni ushqime të forta apo të ëmbla. Ekspertët nuk rekomandojnë vazhdimin e kurës për më shumë se dy ditë rresht. Sipas tyre, trupi ka nevojë për vitamina, minerale dhe kalori dhe nuk mund të rezistojë gjatë pa to. Për më tepër, mungesa e ushqimit e dobëson sistemin imunitar. Na ana tjetër, pirja e vazhdueshme e lëngjeve nxjerr nga trupi edhe depozitat ekzistuese të vitaminave dhe mineraleve bashkë me bakteret e mira që e mbrojnë stomakun nga patogjenët. Kura funksionon duke e pastruar menjëherë sistemin tretës nga mbetjet e akumuluar ushqimore. Për më tepër, vitamina C, kripa, xhenxhefil, mollët, probiotikët dhe uthulla e mollës janë të domosdoshme për regjimin ushqimor. Ato janë shumë efikase në përshpejtimin e tretjes dhe përmirësimin e të gjithë sistemit duke e mbrojtur atë nga toksinat e dëmshme.



PSE JEMI TË VARUR NGA TELEFONI?

Përgjigja klasike për arsyen pse e keni kaq të vështirë të lini telefonin tuaj në shumicën e rasteve do të ishte: Sepse jeni të varur nga ai.

Ju jeni mësuar të shpërqendroheni, si për shkak të dizajnit të këtyre pajisjeve dhe aplikacioneve, dhe efektit të dopaminës sa herë që merrni telefonin.

Sidoqoftë, shkenca ofron një shpjegim alternativë. A është e mundur që pajisjet tona mobile të na tërhiqen, jo pse jemi të varur, por pasi jemi duke u përpjekur të shmangim zërin në kokën tonë?

Për të kuptuar pse ka kuptim kjo "hipotezë e ikjes nga mendimet tuaja", lexoni se çfarë thonë rezultatet e një studimi të fundit nga psikologu social Timothy Wilson në Universitetin e Virxhinias.

Ekipi i tij la një grup njerëzish në një dhomë, nga e cila ata larguan të gjitha gjërat që mund të merrnin vëmendjen: telefona, stilolapsa, letër, etj.

Subjektet më pas kaluan 15 minuta duke qëndruar

vetëm me mendimet e tyre.

Ekipi i Wilson zbuloi se shumica e njerëzve në grup e vlerësuan këtë përvojë si të mërzitshme ose një përvojë që nuk e shijuan aspak.

Shkencëtarët atëherë prezantuan një kthesë të vogël për të gjithë situatën. Ata përsëritën të njëjtin eksperiment, duke lënë një pajisje në tryezë në dhomë që lejonte subjektet të "peshkonin" veten me një goditje mini-elektrike.

Për 27 për qind të grave dhe 67 për qind të burrave, fakti që ata duhej të qëndronin vetëm në dhomë me mendimet e tyre ishte aq e padurueshme sa vendosën të "godasin" veten me rrymë. Një burrë thuhet se e përsëriti atë 190 herë.

Rezultati shqetësues i këtij studimi është se shumica e njerëzve më mirë do të lëndonin veten sesa të liheshin vetëm me mendimet e tyre.

MOTORI ELEKTRIK I VOLKSWAGEN MUND TË FUTET NË ÇANTË



Prodhuesi gjerman i veturave ka treguar për publikun kompaktësinë e motorit elektrik që drejton modelin e parë elektrik.

Në shtator, VW prezantoi anëtarin e parë të familjes EV të ID.3, të mundësuar nga një motor elektrik me 204 kuaj fuqi. Peshë e motorit të markës APP310, së bashku me kutinë e marsheve është vetëm 90 kg, kështu që mund të paktohet në një çantë sportive.

Motori elektrik APP310 është prodhuar në Gjermani dhe Kinë, dhe avantazhet e tij tashmë janë njohura nga disa kompani që janë angazhuar në restaurimin dhe elektrifikimin e gjeneratës së parë të fugonëve legjendarë të VW.

VW do të ketë premierën e një modeli të ri të konceptit nga fa-

milja ID në panairin e ardhshëm në Los Anxhelos, transmeton.

Bëhet fjalë për Space Vizzion me të cilin parajlmërohet një tjetër model elektrik, versioni serik i të cilit nuk do të presë gjatë.

Sidoqoftë, para tij do të paraqitet te klientët një version serik i crossoverit ID.4, i cili, ndryshe nga ID.3, do të jetë i disponueshëm edhe në Amerikën e Veriut.

KY APLIKACION E DI NËSE IPHONE JUAJ ËSHTË HAKUAR

Të gjesht një mjet sigurie i cili funksionon siç duhet në një iPhone është një lloj si të kërkosh gjilpërën në kashë. Apple e ka bërë thajse të pamundur për aplikacione të tilla të hyjnë në App Store me rregulla të cilat ndalojnë skanimin e aplikacioneve të tjera dhe të dhënave të tyre.

Ky aplikacion i ri është ajo që keni kërkuar. Nëse keni iOS 12 ose më shumë, iVerify mund tu tregojë nëse iPhone juaj është hakuar.

Ekziston një arsye e fortë se aplikacionet e anti-viruseve mungojnë në App Store sepse Apple nuk i lejon. Kompania ka ndërtuar një platformë e cila në bërthama ka sigurinë dhe në të vërtetë iOS rrallë herë pëson sulme si ato të Android.

Apple sigurohet se aplikacione ekzekutohen në një hapësirë të izoluar quajtur "sandbox" duke i

parandaluar të aksesojnë të dhënat e aplikacioneve të tjera apo të interferojnë me iOS.

Aplikacioni iVerify ka arritur të marrë aprovimin e Apple dhe tashmë është i disponueshëm në App Store. Ndryshe nga shumica e aplikacioneve të tjera të sigurisë, iVerify përmban një komponent skanimi i cili është i dobishëm. Nuk është një anti-virus por një skaner anti-hakimi. Aplikacioni skanon ato anomali dhe efekte të një hakimi të iPhone ose një jailbreak.

Nëse një anomali zbulohet, përdoruesi paralajmërohet dhe i ofrohet këshillë sesi të menaxhojë situatën. Por jo të gjithë janë të bindur se iVerify do të ketë sukses sepse disa zhvillues të aplikacioneve të sigurisë shprehën habi sesi aplikacioni në fjalë ka hyrë në App Store.



YOUTUBE SHUAN LLOGARITË JO FITIMPRURËSE?

Kushtet e reja të Shërbimit për platformën video të Google do të hyjnë në fuqi në 10 dhjetor. Javën e kaluar, YouTube filloi të dërgojë një dokument detyrues në adresat e postës elektronike të autorit.

Sidoqoftë, kjo tezë është një çështje potencialisht e diskutueshme ... Seksioni "Pezullimi dhe Ndërpërja e Llogarisë" të versionit të plotë të dokumentit thotë:

"YouTube mund të ndërpresë hyrjen tënde, ose Llogarinë tënde Google, për të hyrë në të gjithë ose një pjesë të Shërbimit nëse YouTube beson, në diskrecionin e vet, që ofrimi i Shërbimit për ju nuk është më i vlefshëm për tregti."

Interpretimi i njerëzve për këto fraza të përgjith-

shme të qëllimshme, mund të supozohet - nëse personi kompetent vlerëson se nuk ka ndonjë vlerë të veçantë financiare nga reklamimi me një autor të veçantë, ai do të mbetet pa llogari. Cili është justifikimi për këtë veprim do të dëgjohet nëse kompania i përgjigjet kësaj çështje. Ndoshta në mes është një tjetër copëzim kanalesh, ku ato më të vegjëll do të korrin, raporton Bota e Kompjuterit.

Ndryshe, Youtube shtrëngoi kriteret e saj të fitimit të parave në fillim të vitit të kaluar, për të cilat llogaria duhej të kishte një mijë abonentë, katër mijë orë të shikuara gjatë një viti.





“O ju që keni besuar!
Bindjuni Allahut
dhe të Dërguarit
kur ju thërret
drejt asaj që ju
jep jetë!..”

(Enfal, 24)